

VENDIM
Nr.797, datë 14.11.2007

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORIT DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT, PËR PERIUDHËN 2007-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50 të ligjit nr.9135, datë 11.9.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut, për periudhën 2007-2013, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Shëndetësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT
2007-2013

PJESA I
HYRJA

1. Hyrje

Bazuar në një kuadër ligjor solid (shih hyrjet dhe anekset e dokumenteve strategjike të sektorëve) dhe në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së, veçanërisht me Strategjinë e BE-së për Mbrojtjen e Konsumatorit 2007 – 2013, “Fuqizimin e Konsumatorëve, rritjen e mirëqenies së tyre, mbrojtjen efektive të tyre, Bruksel, 13.03.2007, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë zhvilluan përkatësisht strategjitë e sektorëve të tyre në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2007-2013 të cilat janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë dokument të përbashkët të strategjisë duke paraqitur vizionin, prioritetet strategjike dhe strukturën, duke paraqitur kërkesat për buxhetin dhe afatin kohor, duke orientuar procesin e monitorimit dhe të vlerësimit dhe duke iu referuar projekteve më të fundit dhe atyre në poqes.

1.1 Vizioni

Vizioni i Strategjisë Ndërsektoriale të mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut në Shqipëri për periudhën 2007–2013 është që konsumatorët shqiptarë të jenë individë më të mirë informuar dhe vetëpërcaktues dhe që zotërojnë vetëbesim në raport me tregun. Ata do të kenë një pozicion të mirë në vlerësimin e situatës së tregut që rrjedh nga mbikëqyrja bashkëkohore dhe transparenca e tregut. Ata gjithashtu do të zotërojnë një vetëbesim të fortë që rrjedh nga mbrojtja efektive e bazuar në një kuadër ligjor solid dhe në një bazë institucionale të mbikëqyrtur nga qeveria. Ky kuadër ligjor gjithnjë e më shumë do të harmonizohet me atë të BE-së, do të fuqizojë kapacitetet administrative në Shqipëri dhe do të nxisë aktivitetet e koordinuara ligjëbërëse. Konsumatorët Shqiptarë do të mbrohen në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet serioze të cilat ata s’mund t’i trajtojnë si individë.

Sektori i shitjes me pakicë dhe niveli i mbrojtjes së konsumatorëve do të përgatiten më mirë për integrimin Europian me implementimin e kësaj strategjie ndërsektoriale. Tregjet do të hapen gjithnjë e më shumë dhe do të garantohet lëvizja e lirë e mallrave. Kuadri strategjik do të përgatisë zinxhirin e furnizimit në Shqipëri për gjurmueshmërinë e plotë të të gjithë llojeve të mallrave. Sektorët, veçanërisht pjesa e lidhur me eksportet, por dhe ato me tregun e brendshëm, do të jenë plotësisht të përputhur me kuadrin ligjor të OBT-së.

1.2 Prioritetet strategjike dhe objektivat

Prioritetet strategjike të strategjisë ndërsektoriale janë:

1. Të fuqizojë konsumatorët Shqiptarë (zgjedhje reale e bazuar mbi një informacion të saktë, vetëvendosje e fortë, besim që rrjedh nga mbrojtja efektive).

2. Të mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve Shqiptarë në çështjet e sigurisë, zgjedhjes, cilësisë, çmimit, llojshmërisë, disponibilitetit etj.

3. Të ofrojë për konsumatorët Shqiptarë mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparencë të tregut.

4. Të mbrojnë konsumatorët Shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet të cilat ata nuk mund t'i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale.

1. Të fuqizojë konsumatorët Shqiptarë (zgjedhje reale e bazuar mbi një informacion të saktë, vetëvendosje e fortë, besim që rrjedh nga mbrojtja efektive).

Objekti i është të furnizojë konsumatorët me informacionin e përshtatshëm dhe të saktë mbi cilësinë e mallrave në shitjen me pakicë.

Informacioni dhe komunikimi i mjaftueshëm i mbështetur nga kuadri ligjor janë kyçi për të mbështetur vetëvendosjen e konsumatorëve në përzgjedhje. Ata duhet të vendosen në pozitën në të cilën ata të jenë në gjendje për të vlerësuar mallrat si dhe cilësitë përkatëse dhe çmimet respektive për këto mallra.

Konsumatorët gjithashtu duhet të kenë besim i cili rrjedh nga mbrojtja efektive dhe të jenë të aftë të vetëvendosin në lidhje me qëndrimin e tyre ndaj mallrave në treg. Duhet të konsolidohet një kuadër ligjor solid për të forcuar të drejtat e konsumatorëve. Ky kuadër do të jetë si rezultat i aktiviteteve të koordinuara të ligjbërjes nga të gjitha ministritë respektive dhe duhet të përmbajë veçoritë e trajtimit të risqeve, të kontrollit të mallrave të importuar, të obligimeve të operatorëve të biznesit (ndërgjegjësim më i mirë mbi përgjegjësinë e tyre shoqërore ndaj konsumatorëve), etiketimit dhe promovimit të mallrave, masat e kontrollit siç është sistemi i mbikëqyrjes së tregut dhe autorizimi i laboratorëve të kontrollit, menaxhimi i krizave dhe situatave të emergjencës. Ky kuadër duhet të mbrojnë nga kushte jo korrekte të kontratave dhe gjithashtu duhet të organizojë organizmat qeveritare për mbrojtjen e konsumatorëve.

2. Të mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve Shqiptarë në çështjet e sigurisë, zgjedhjes, cilësisë, çmimit, llojshmërisë, disponibilitetit etj.

Duhet të garantohet që rregullat e vendosur janë implementuar efektivisht, dukshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit, informimit, edukimit dhe dëmtshpërblimit. Parakushte për këtë janë: një kuadër ligjor i thjeshtë, evidentim i përmirësuar, konsultim më i mirë dhe përfaqësim më i mirë i interesave të konsumatorëve. Një parakusht tjetër për këtë është një konkurrencë e mjaftueshme në tregjet e mallrave ushqimore. Konsumatorët gjithashtu duhet të jenë të mbrojtur nga praktikat jo të ndershme kontraktuale. Sistemi i mbikëqyrjes së tregut që do të implementohet nga autoritetet kombëtare nën mbikëqyrjen e METE do të kontribuojë fuqishëm në mbrojtjen të konsumatorit.

3. Të ofrojë për konsumatorët Shqiptarë mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparencë të tregut.

Konsumatorët shqiptarë duhet të kenë transparencë bashkëkohore të tregut dhe mundësi reale zgjedhjeje; kjo do të thotë që ekziston një konkurrencë e mjaftueshme dhe partnere tregtarë e në veçanti tregtarët janë të detyruar të ofrojnë informacion rreth çmimeve dhe cilësive respektive.

Një sistem solid i mbikëqyrjes së tregut do të implementohet nga autoritetet kombëtare nën mbikëqyrjen e METE. Monitorimi dhe kontrolli do të jenë instrumente të rregullt të verifikimit të faktit nëse produktet dhe shërbimet që janë hedhur në treg janë në përputhje me legjislacionin respektiv aktual dhe gjithashtu mbështesin si masat parandaluese dhe ato korrigjuese ndaj produkteve ose shërbimeve që nuk janë në konformitet me të.

3. Të mbrojnë konsumatorët Shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet të cilat ata nuk mund t'i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale.

Një nivel i lartë mbrojtjeje ndaj të gjitha kërcënimeve në të gjitha llojet e tregjeve kudo në Shqipëri është thelbësore për besueshmërinë e konsumatorëve. Konsumatorët bëhen gjithnjë e më

tepër individë për të cilët si vlerësimet ashtu dhe gjykimet bëhen gjithnjë e më të vështira. Një strukturë organizative që përfshin standardet, pajisjet e matjes dhe instrumentet duhet të ofrohen qoftë si sisteme kontrolli ashtu edhe si procedura të menaxhimit të riskut dhe të informacionit. Sistemi i mbikëqyrjes së tregut do të kontribuojë fuqishëm në mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet (i) konfirmimit të bazës ligjore për aktivitetet e mbikëqyrjes, (ii) ngritjes së një kuadri adekuat institucional, (iii) dhënies së fuqisë së nevojshme autoriteteve respektive, dhe (iv) zhvillimit të procedurave të shkëmbimit të informacionit dhe të bashkëpunimit. OJF aktive duhet të ndihen të detyruara për të mbështetur konsumatorët në kuptimin e përfaqësuesit të konsumatorëve që kujdeset për të drejtat e tij respektive.

Prioritet i lartë duhet t'u jepet që të katër këtyre objektivave.

1.3 Struktura e strategjisë ndërsektoriale

Strategjia ndërsektoriale bazohet në tre strategji sektoriale të hartuara nga:


- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE);
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK);
- Ministria e Shëndetësisë (MSH).

Strategjitë sektoriale janë pjesë integrale e strategjisë ndërsektoriale.

Çështjet kryesore të Ministrive të angazhuara në këtë proces janë; produktet jo ushqimore (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE)), produktet ushqimore (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) dhe produktet farmaceutike (Ministria e Shëndetësisë).

Skema e mëposhtme tregon se Ministrinë respektive bashkërisht ndjekin prioritetet ndërsektoriale por kanë dhe objektivat e tyre specifike.

Objektivat e strategjisë së mbrojtjes së konsumatorit



2. Afati kohor dhe buxheti

Kjo strategji ndërsektoriale është e vlefshme për periudhën 2007 - 2013 njëloj si dhe strategjitë individuale. Burimet e nevojshme financiare janë kuotuar në dokumentat e strategjive sektoriale si dhe afatet e impleentimit dhe pergjegjësitë përkatëse.

3. Monitorimi dhe vlerësimi

Për vlerësimin e rezultateve të arritura të strategjive sektoriale duhet të ngrihet një sistem i monitorimit dhe i vlerësimit. Indikatorët e rezultateve të nivelit të lartë do të përcaktohen me qëllim për të ofruar mundësi për një monitorim dhe vlerësim sistematik.

3.1 Monitorimi

Institucionet administrative respektive ngarkohen me mbikqyrjen e cilësisë së implementimit të strategjisë mbi bazën e indikatorëve financiarë dhe atyre të impaktit. Për këto detyra duhet të zhvillohet sistemi i monitorimit. Raporte vjetore duhet të dërgohen në kryeministri dhe duhet të miratohen nga Ministri.

3.2 Vlerësimi

Vlerësimi duhet të jetë një proces i përhershëm gjatë gjithë horizontit kohor të strategjisë. Ekspertë të pavarur duhet të vlerësojnë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë, eficiencën dhe impaktin e strategjisë së implementuar. Duhet parashikuar rishikime afatmesme dhe Ex-post.

3.3 Indikatorët

Indikatorët duhet të jenë të lidhur ngushtë me politikat, veprimet dhe masat dhe të përfshijnë indikatorët e outputeve, të rezultateve dhe të impaktit. Indikatorët duhet të përcaktohen nga pikpamja sasiore në përputhje me pjesën e buxhetit të caktuar për sejcilën masë.

Përsa i përket çështjes së mbrojtjes së konsumatorëve duhen marrë në konsideratë indikatorët e mëposhtëm:

- Plotesimi i kuadrit perkates ligjor dhe institucional;
- Numri i fushatave, kurseve të trainimit, seminareve etj, dhe numri i pjesmarrësve;
- Numri i akseseve në informacionin online mbi mbrojtjen e konsumatorëve;
- % e kurrikulave të shkollave që trajtojnë çështjet e mbrojtjes së konsumatorit;
- Zhvillimi i indeksit të çmimit të konsumatorëve;
- Buxhetet / stafi i OJF-ve;
- Numri i ankesave të konsumatorëve;
- Pjesa e produkteve të eksportuara;
- Numri i pikave të informacionit;
- Numri i certifikatave të cilësisë në bizneset e përpunimit dhe të shitjes me pakicë;
- Pjesmarrja e firmave shqiptare në panairët ndërkombëtare.

Këto indikatorë duhet të përcaktohen sipas buxhetit të alokuar.

4. Kuadri ligjor ekzistues, projektet më të fundit dhe ato në vijim

Disa projekte me mbështetje ndërkombëtare kontribuojnë në zhvillimin dhe implementimin e kuadrit ligjor dhe të strategjive. Këto projekte janë përmendur në aneksin 3.

5. Referencat

Referencat perkatese jane pasqyruar ne aneksin 4, bashkengjitur strategjise.

6. Tabela e planit te veprimeve me kostot indikative

Tabelat e planit te veprimit se bashku me kostot indikative perkatese pasqyrohen ne Aneksin 5 te strategjise.

PJESA II

SIGURIA E PRODUKTEVE USHQIMORE

1. Hyrja, qëllimi, sfidat dhe parimet udhëzuese të zhvillimit të strategjisë

1.1 Hyrja

Konsumatorët dhe Siguria ushqimore janë çështje të lidhura ngushtë dhe tepër të ndjeshme.

Hapat e rëndësishëm që duhen ndërmarrë nga qeveria Shqiptare në kuadrin e reformave social – ekonomike në lidhje me fushat e rëndësishme të mbrojtjes së konsumatorit dhe të sigurisë ushqimore janë implementimi i ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve i vitit 2003 dhe ligjit të Ushqimit të vitit 2007.

Ligji shqiptar nr.9135, datë 11.9.2003 “Mbi mbrojtjen e konsumatorëve” ofron rregullime të qarta mbi:

- Sigurinë e mallrave dhe shërbimeve;
- Obligimeve të prodhuesve, tregtarëve dhe ofruesve të shërbimeve;
- Kushtet jokorrekte në kontratat;

- Tregëtia elektronike.

Ai organizon organizmat shtetërore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Ligji i ri shqiptar i ushqimit aktualisht ka hyrë në stadin final të diskutimit dhe pritët që së shpejti të miratohet nga parlamenti shqiptar. Ky ligj ofron kuadrin për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Temat kryesore që trajton ky ligj përfshijnë:

- Trajtimin e risqeve;
- Çështje të importit dhe të eksportit, veçanërisht kontrollin e ushqimit të importuar;
- Miratimin dhe rregjistrimin e ndërmarrjeve;
- Obligimet e operatorëve të bizneseve të ushqimit;
- Çështjen e produkteve të reja ushqimore dhe të ushqimit për blegtorinë;
- Etiketimin dhe promovimin e ushqimit;
- Kontrollin e ushqimit dhe autorizimin e laboratorëve të kontrollit;
- Menaxhimin e krizave dhe të situatave të emergjencës; dhe
- Organizon organizmat shtetërore për mbrojtjen e konsumatorëve.

Ky dokument i strategjisë përshkruan situatën aktuale të Sektorit Shqiptar të bujqësisë dhe të ushqimit, tregon anët e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (SWOT) e këtyre sektorëve dhe nga prioritetet dhe objektivat e tyre strategjike janë zhvilluar dhe politikat specifike përkatëse. Pohime mbi implementimin dhe aplikimin, alokimin e buxhetit gjatë tërë periudhës dhe politikat, mbi monitorimin dhe vlerësimin dhe së fundi paraqiten perspektivat.

1.2 Qëllimi

Kjo strategji për mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë ushqimore e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbulon objektivat, prioritetet dhe politikat që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë ushqimore.

Konsumator, sipas ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve të vitit 2003, është përcaktuar si një individ, i cili ble ose përdor mallra dhe shërbime për përmbushjen e nevojave të tij personale, për qëllime që nuk lidhen me tregëtinë, biznesin apo ushtrimin e profesionit të tij. Në kuptimin e këtij ligji edhe organizatat jo fitimprurëse (OJF) konsiderohen si konsumatorë.

Ushqim, sipas ligjit të Ushqimit të vitit 2007, është përcaktuar çdo mall, substancë ose produkt i përpunuar, pjesërisht i përpunuar ose i papërpunuar, që synohet të përdoret për konsum nga njerëzit.

Termi “ushqim” duhet gjithashtu të përfshijë pijet, çamçakëzat, shtesat ushqimore dhe çdo substancë tjetër që me dashje inkorporohet në ushqim gjatë procesit të prodhimit, përgatitjes apo trajtimit të tij.

Termi “ushqim” duhet gjithashtu të përfshijë ujin (ujin e pijshëm, ujin e përfshirë në ushqim, ujin e pakëtuar si ujë mineral tavoline dhe ujin e burimit).

Termi “ushqim” nuk duhet të përfshijë ushqimin për blegtorinë, kafshët e gjalla, dhe zogjtë, bimët dhe frutat para korrjes/vjeljes produktet mjeksore, produktet kozmetike, duhanin dhe produktet e tij, narkotikët ose substancat psikotrope, mbetjet që janë të rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

Siguria ushqimore është një pjesë thelbësore e politikës së mbrojtjes së konsumatorëve dhe temat e sigurisë ushqimore dhe të asaj të mbrojtjes së konsumatorëve janë të lidhura të lidhura ngushtë. Për shkak të niveleve të larta të ndjeshmërisë dhe rëndësisë për shëndetin human, këto tema kanë nevojë për një politikë dhe strategji të veçantë në përputhje me procedurat në BE dhe në politikën kombëtare.

1.3 Sfidat

Shqipëria përballët me sfidat që vijnë në realizimin e mbrojtjes së konsumatorëve në kuptimin e standardeve të sigurisë ushqimore:

- Tregjet ushqimore janë tregje shumë të mëdha të shitjes me pakicë;
- Nuk është arritur akoma një nivel i lartë i sigurisë ushqimore;
- Aktualisht nuk ka këshillim shkencor të pavarur në disa aspekte që lidhen me sigurinë ushqimore;
- Mungesë besimi nga ana e konsumatorëve;
- Komunikimi dhe dialogu me konsumatorët mbi sigurinë ushqimore dhe çështjet e shëndetit akoma nuk është konsoliduar;
- Duhet ngritur e bërë funksional networku me autoritetet kombëtare, OJF-të, institutet shkencore;

- Nivele të ulta të arsimit dhe të trainimit në kuptimin e temave të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore të stafit në të gjitha nivelet në këtë sektor si dhe konsumatorëve;
- Duhet ngritur sisteme kontrolli që garantojnë që standarde të pranueshme nga BE për sigurinë ushqimore janë arritur;
- Aktualisht nuk ka marrëveshje të qarta për përgjegjësi të qarta primare mbi prodhimin e ushqimit të sigurtë për industrinë, prodhuesit e lëndëve të para dhe furnitorët;
- Nuk është ngritur akoma sistemi i gjurmueshmërisë në të gjithë zinxhirin ushqimor;
- Në përputhje me ligjin e ushqimit të vitit 2007, akoma janë për t'u implementuar masa të shpejta dhe efektive të sigurta dhe të vlerësimit të riskut në lidhje me sigurinë e ushqimeve dhe të ushqimeve për blegtorinë;

- Shërbimet aktuale të kontrollit dhe të inspektimit nuk janë eficient aq sa duhet.

1.4 Parimet udhëzuese të zhvillimit të strategjisë

Hartimi i një strategjie duhet të marrë në konsideratë hapat e njëpasnjëshëm që vijnë:

- Grumbullimin e informacionit/analizën dhe përshkrimin e situatës aktuale;
- Bërjen e SWOT-it = anët e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet/përcakton barrierat dhe identifikon shkaqet / zhvillon dhe përzgjedh zgjidhjet e mundshme;
- Hartimin e draftit të strategjisë dhe konsultimin e saj të gjerë/përfshirjen e stakeholderave;
- Kryerjen e vlerësimit të impaktit potencial të strategjisë/vlerësimin paraprak;
- Modifikimin dhe publikimin e strategjisë;
- Implementimin e strategjisë (kufizimet buxhetore, prioritetet etj.);
- Rishikimin sipas nevojës / vlerësim afatmesëm dhe Ex post.

Si hap i parë paraqitet dhe vlerësohet informacioni dhe të dhënat disponibël me qëllim për të siguruar një bazë të qëndrueshme për një përshkrim bashkëkohor të situatës aktuale të sektorit të bujqësisë dhe të ushqimit.

Analiza e anëve të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT-i) garanton informacion të cilit mund t'i referohen objektivat dhe prioritetet dhe më tej politikat dhe masat.

Versionet draft të dokumentit të strategjisë duhet t'u komunikohen stakeholderave respective për t'i involvuar ata në një stad të hershëm, për të përfshirë komentet e ofruara nga këta të fundit dhe që çon në një pranueshmëri dhe adaptim më të gjërë.

Për vlerësimin e arritjeve të strategjisë së mbrojtjes së konsumatorëve dhe të sigurisë ushqimore duhet ngritur sistemi i monitorimit dhe të vlerësimit të strategjisë.

Në përputhje me rezultatet dhe rekomandimet e ofruara nga monitorimi dhe vlerësimi, strategjia modifikohet dhe publikohet.

Implementimi i politikave dhe masave kryhet në përputhje me prioritetet dhe kufizimet e buxhetit.

Monitorimi dhe vlerësimi duhet vërejtur si një proces i përhershëm që shoqëron strategjinë përgjatë gjithë periodes. Rishikime dhe përshtatje duhet të jetë i mundur në çdo kohë që kërkohet.

2. Vështrimi i përgjithshëm, situatë aktuale, dhe SWOT-i

2.1 Vështrimi i përgjithshëm, situatë aktuale në sektorin e bujqësisë dhe të industrisë të përpunimit të ushqimit

Toka bujqësore në Shqipëri perlllogaritet të zërë 24% të sipërfaqes totale të tokës, pyjet zenë 36%, kullotat dhe livadhet 15% dhe të tjerat 25%. Bujqësia dominohet nga ferma të vogla (mestarisht 1.2 ha), e fragmentuar në 3 der 4 parcela. Ky fragmentim është një barrierë e rëndësishme për zhvillimin afatgjatë të bujqësisë Shqiptare derisa të ekzistojë mundësia e kufizuar për të përshtatur teknologjitë bashkëkohore (Republika e Shqipërisë – MBUMK (2007): Vjetari Statistikor 2006).

Prodhimi i përgjithshëm bruto është rritur me rreth 3% në vit, në terma reale. Sidoqoftë, edhe me rritje më të madhe të ekonomisë në tërësi, pjesa e bujqësisë në PPB është ulur lehtësisht. Në zonat rurale, bujqësia perbën rreth 80 % të punësimit (sipas SEED, 2005), megjithëse shumica e punësimit në bujqësi është jo me kohë të plotë.

Blegtoria përlllogaritet të zërë 46% të totalit të vlerës së shtuar në bujqësi, drithrat 42%, dhe pemëtaria 12% (Republika e Shqipërisë – MBUMK (2007): Vjetari Statistikor 2006). Gjatë 6 vjetëve të fundit, pemëtaria ka treguar rritjen më të madhe (me rreth 9% në vit), me vreshtarinë me rritje veçanërisht të madhe. Pemët frutore dhe vreshtat kanë një potencial të madh për rritje të mëtejshme. Blegtoria është rritur me rreth 3,5% (Republika e Shqipërisë – MBUMK (2007): Vjetari Statistikor 2006). Më shumë se 60% e popullsisë janë të përfshirë në një fare mënyre në mbarëshkrimin e

blegtorisë (sipas SEED, 2005), shumica në një shkallë të ulët. Blegtoaria luan një rol të rëndësishëm në sistemet e fermave të vogla e me kohë të pjesshme të mbarështimit të blegtorisë, si dhe duke ofruar një funksion sigurie shoqërore të rëndësishëm. Shumica e blegtorisë mbahet për prodhim qumeshi, kryesisht për konsum vetjak. Prodhimi i qumështit vuan nga problem i nivelit të ulët të garantimit të cilësisë. Blegtoaria gjithashtu shërben si një mjet transporti dhe disa here kafshët përdoren si mjete pune për përgatitjen e tokës. Prodhimet bimore kryesore janë ushqimet e njoma për blegtorinë dhe drithrat dhe prodhimi ka treguar rritje të vogël në pesë vitet e fundit..

Agropërpunimi përllëgaritet të zerë rreth 40% të agro-industrisë (sipas SEED, 2005). Ai përbëhet nga ndërmarrje të vogla private, ish ndërmarrje shtetërore të privatizuara tashmë, (kryesisht aktive në miell / bukë, qumësht dhe pije), dhe inisiativa private me investime të reja. Shpërndarja territoriale e këtyre ndërmarrjeve tregon që kjo industri është më shume e zhvilluar në zonën perëndimore dhe veçanërisht në zonën qendrore dhe jug-perëndimore të vendit. Tashmë ka 2,053 ndërmarrje të ushqimit (nga të cilat 60% janë në sektorin e miellit dhe të bukës) duke punësuar rreth 10,000 njerëz (Republika e Shqipërisë – MBUMK (2007): Vjetari Statistikor 2006). Burimet njerëzore të ndërmarrjeve janë të kufizuara në numër: 90% e ndërmarrjeve kanë 1 – 5 të punësuar, 6% kanë 6 – 10 të punësuar, 2% kanë 11 – 20 të punësuar, dhe 2% kanë mbi 20 të punësuar (Republika e Shqipërisë – MBUMK (2007): Vjetari Statistikor 2006). Ndërmarrjet me përqindjen më të lartë janë ato që kanë më pak se 5 të punësuar, dhe ky është një indikator vlerësues për SME-të.

Përpunimi i ushqimeve është rritur shpejt, me rreth 10 % në vit dhe tani është i barabartë me mbi 20 % të vlerës së shtuar bujqësore (sipas SEED, 2005). Përpunimi i qumështit dhe i mishit kanë treguar rritje veçanërisht të fuqishme. Disa aktivitete të përpunimit bashkëkohor të përpunimit (psh perime të ngrira) po bëhen me lëndë të para të importuara.

Eksporti i produkteve ushqimore të përpunuara vazhdon të jetë një temë sfidë për industrinë. Eksportet e produkteve ushqimore të përpunuara kap vlerën e rreth 10 % të vlerës së importeve të produkteve ushqimore të përpunuara (sipas SEED, 2005).

Investimet në agrobiznes janë rritur shumë në vitet e fundit, si në teknologjinë e prodhimit ashtu dhe në ndërtesat. Një pjesë e madhe e rritjes është financuar nga një rritje e madhe e kreditimit nga sistemi bankar, i cili tani përllëgaritet sa gjysma e investimit total në agro-industri. Sidoqoftë, krahas këtyre përmirësimeve, ndërmarrjet e ushqimit akoma janë shumë të vogla. Shumë prej tyre nuk janë akoma të afta të përmbushin standardet e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore. Si rezultat, ato nuk janë të afta të eksportojnë në tregjet e BE-së.

Sipas SEED (2005) përqindja e ndërmarrjeve që kanë rinovuar teknologjinë është rritur vit pas viti: në 2003 rinovimi i teknologjisë së prodhimit ka ndodhur në 64 % të ndërmarrjeve.

Rinovimi i teknologjisë përgjithësisht është shoqëruar me rinovimin e produkteve: rreth 70 % e ndërmarrjeve kanë rinovuar produktet e tyre kryesore, ndërsa 13 % e tyre nuk e kanë bërë këtë gjë. Të punësuarit kanë ndjekur trainime të ndryshme; shumica në fushën e cilësisë dhe sigurisë ushqimore dhe në fushën e teknologjisë së prodhimit.

Përsa i përket **cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore** Shqipëria ka përgatitur / po përgatit një kuadër ligjor të kompletuar në përputhje me legjislacionin respektiv Europian. Rezulton që 59% e ndërmarrjeve të vëzhguara (SEED, 2005) ishin të informuara rreth këtyre direktivave. MBUMK luan një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e këtij lloji informacioni. Gjithashtu, sipas të njëjtit vëzhgim të SEED 2005, 94% e ndërmarrjeve e konsiderojnë tregun si një vend ku ata kanë një ekperiencë komunikimi me konsumatorët në lidhje me cilësinë dhe sigurinë e produkteve të tyre. Vetëm një përqindje shume e ulët e ndërmarrjeve (rreth 13%) dërgojnë ushqime në tregjet ndërkombëtare. 93% e ndërmarrjeve që u përfshinë në vërtetim mendojnë që teknologjia që ata përdorin përmbush kërkesat e cilësisë dhe të sigurisë së produktit. Sidoqoftë, 83% e ndërmarrjeve planifikojnë të rinovojnë teknologjinë e prodhimit në të ardhmen. Sipas mendimit të tyre 62% e ndërmarrjeve kanë teknologji shumë të kualifikuar dhe 30 % janë të kualifikimit të mesëm. Për më tepër, 75% e ndërmarrjeve planifikojnë të kryejnë trainime të brendshme në fushën e teknologjisë së prodhimit. Investimet e ndërmarrjeve në kushtet higjieno – sanitare janë rritur dukshëm në vitet e fundit (SEED 2005). Përsa i përket kontrollit të cilësisë 56% e ndërmarrjeve pohojnë që ato kanë ngritur laboratoret e kontrollit. Sidoqoftë vetëm 33% e ndërmarrjeve përdorin instrumenta matëse të kalibruara, 70 % e ndërmarrjeve tregojnë dëshirën e tyre për të investuar në përmirësimin e situatës në laboratorët e tyre. Niveli i kualifikimit të stafit të laboratoreve shkallëzohet në nivelin e mesëm. Megjithatë, 97% e të punësuarve të cilët punojnë në “pikat kyçe” kanë pagesa relativisht më të larta.

80% e ndërmarrjeve, dëshërojnë të investojnë në aktivitete trainuese të personelit të tyre në këtë fushë. Pjesa e ndërmarrjeve të cilat janë çertifikuar sipas sistemeve ISO 9001 ose HACCP aktualisht është shumë e ulët (SEED, 2005).

Shqipëria ka një deficit të madh **në tregtinë e produkteve bujqësore**, me eksporte më pak se 15% të importeve. Importi i produkteve bujqësore dhe ushqimore është rritur nga 34,856 milion Lek në vitin 2000 në sasinë e 53,190 milion Lek. Sidoqoftë eksportet e produkteve bujqësore dhe ushqimore janë rritur shpejt, nga 3,827 milion Lek në 7,154 milion Lek gjatë së njëjtës periudhë (Republika e Shqipërisë – MBUMK (2007): Vjetari Statistikor 2006). Pozicioni i dobët tregtar reflekton një numër problemesh specifike, duke përfshirë mungesën e organizimit të tregtarëve eksportues, një gjëndje e dobët e zinxhirit të tregut dhe probleme me kontrollin e cilësisë. Marrëveshjet e tregtisë së lirë (Brenda rajonit dhe me BE-në) inkurajojnë importet bujqësore, por gjithashtu ofrojnë mundësi për eksporte, veçanërisht për produkte si perimet, vajin e ullirit, peshkun dhe ato blegtorale.

Shqipëria duhet të bëhet konkurrese në sezonin e hershëm të frutave dhe perimeve, veçanërisht për tregun e BE-së, meqenëse kufizimet tregtare vazhdojnë të liberalizohen.

Qeveria Shqiptare synon përshtetimin e modernizimit dhe të ristrukturimit të bujqësisë dhe të agropërpunimit. Strategjia e zhvillimit rural (2007) parashikon që shumica e buxhetit për zhvillimin rural do të adresohet në modernizimin e objekteve dhe stallave për blegtorinë në ferma si në ndërmarrjet e industrisë përpunuese ushqimore. Grupi kryesor i synuar për mbështetje do të jenë fermerët e mesëm dhe të vegjël si dhe ndërmarrjet përpunuese të vogla dhe të mesme. Sektorët e qumështit dhe të mishit do të marrin prioritet. Qeveria ka shprehur qartë objektivin e saj për të forcuar përmirësimin teknologjik të fermave dhe të agropërpunimit në Shqipëri për të arritur standardet e BE-së.

Shqipëria, ashtu si shumë vende të tjera në rajon, lufton të përmbushë dhe të demonstrojë përputhshmërinë me kuadrin rregullator ndërkombëtar për sigurinë ushqimore dhe me kërkesat e marrëveshjes sanitare – fitosanitare (SPS) të OBT-së. Megjithëse anëtarësimi në OBT ka hapur mundësi të reja për të promovuar zhvillimin ekonomik nëpërmjet tregëtisë me produkte bujqësore dhe ushqimore të përpunuara, dobësitë e brendëshme në sistemin e kontrollit të ushqimit e kufizojnë seriozisht këtë potencial.

Kunkurenca në tregjet e brendëshme nga importet nga BE-ja u rrit më tej pasi aspektet e marrëveshjes së stabilizim asociimit të Shqipërisë me BE-në të lidhura me tregtinë, që u bënë efektive më 1 dhjetor 2006, përmbajnë një reduktim të taksave të importit.

Shqipëria ka potencialin të eksportoje molusqe dhe peshk drejt BE-së, por aktualisht është e ndaluar pasi nuk janë përmbushur akoma në thelbin e tyre standardet dhe kërkesat e kontrollit të cilësisë.

Kuadri institucional dhe rregullator për sigurinë ushqimore

Që nga fillimi i viteve '90, Shqipëria ka miratuar legjislacionin për kontrollin veterinar, sanitar dhe të higjienës në sektorin e ushqimit. Legjislacioni bazë është shoqëruar me legjislacionin sekondar (aktet nënligjore dhe rregulloret). Drafti më i ri i ligjit “Për Ushqimin” po pason procedurat për miratimin final nga parlamenti.

Shërbimi veterinar operon me kontrollin dhe eradikimin e sëmundjeve të kafshëve. MBUMK synon të vazhdojë të ofrojë shërbimin veterinar pasi sëmundjet paraqesin një rrezik për shëndetin e popullatës, megjithëse është e mundur që të kontraktohet dhe sektori privat për disa lloje shërbimesh, aty ku është e përshtatshme. MBUMK parashikon që shërbimi veterinar dhe ai i mbrojtjes së bimëve do të jenë institucionet më të rëndësishme për krijimin dhe implementimin e politikës kombëtare të sigurisë ushqimore (Strategjia e Zhvillimit Rural, 2007).

“Inspektorati shtetëror Sanitar pas miratimit të ligjit të ri është riorganizuar, duke u bërë strukturë vertikale, nga kryeinspektori i Republikës deri tek inspektorët shtetërorë sanitarë në çdo qark. Një nen i veçantë në ligj përcakton që personeli i inspektoratit sanitar shtetëror duhet të specializohet.” (Republika e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Kujdesit të Shëndetit Parësor, 2005).

Shumë tregtarë dhe dyqane të vegjël ofrojnë produkte të mbrojtjes së bimëve, megjithëse përdorimi i tyre në vënd është akoma i ulët. Shërbimi i mbrojtjes së bimëve është përgjegjës për funksionet rregullatore dhe të kontrollit, duke përfshirë karantinën e bimëve, rregjistrimin e pesticideve, liçensimin e shitjes, inspektimin e kushteve të njërive të shitjes dhe të magazinimit dhe diagnozën dhe

monitorimin e shperthimeve të infeksioneve dhe të sëmundjeve. Ministria e trajton ne menyre të mjaftueshme rregullimin por synon të përmirësojë implementimin, kryesisht nëpërmjet përmirësimit të informacionit për shitësit, fuqizimin e rregullimeve për magazinimin dhe ekspozimin ndaj ketyre lëndëve, testimin e produkteve të importuara apo të prodhuara në vënd dhe analizimit të produkteve bujqësore dhe të ujrave për përmbajtje pesticidesh dhe mbetje të tjera. Kjo gjë kërkon training, racionalizim dhe standardizim të laboratoreve dhe bashkëpunim me ekstensionin dhe kërkimin shkencor (Strategjia e Zhvillimit Rural, 2007)

2.2 Anët e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (SWOT)

Analiza SWOT siguron informacion të cilit mund t'i referohen objektivat dhe prioritetet dhe më vonë hartimi i politikave dhe i masave. Tabela 1 jep një vështrim të përgjithshëm dhe më tej çështjet janë trajtuar në detaje.

Tabela 1: Vështrim i përgjithshëm mbi anët e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (SWOT) në sektorin e ushqimit në Shqipëri

anët e forta	dobësitë
- Avantazhe krahasuese përse i perket disa komoditeteve. - Ligji i ri "Për Ushqimin" së shpejti do të jetë aktiv. - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të ngrihet sipas ligjit të ri. - Sistemi i informimit të shpejtë për ushqimin dhe ushqimin për blegtorinë sipas ligjit të ri (RASFF). - Adaptim i kuadrit ligjor të BE-së. - Teknologji bashkëkohore në sajë të investimeve në industri.	- Informacioni / arsimimi / ndërgjegjësimi i Konsumatorëve mbi të drejtat e tyre. - Roli dhe influenca e dobët e OJF-ve. - Kufizimet e buxhetit. - Aplikim i kufizuar i sistemeve të garantimit të cilësisë. - Menaxhim dhe komunikim i dobët i riskut. - Mungesë e arsimimit dhe trainimit të stafit (të gjitha nivelet). - Situatë e dobët përse i perket cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve. - Akoma në fuqi stadardi Shqiptar i vitit 1987. - Defiçite në tregtinë bujqësore - Pa përputhshmëri me rregulloret ndërkombëtare mbi ushqimin. - Etiketim jo i plotë në gjuhën shqipe. - Monitorim i dobët i produkteve të importuara në lidhje me sigurinë.
mundësitë	kërcënimet
- Rritje e ndërgjegjësimit përse i perket cilësisë dhe sigurisë në të gjitha nivelet. - Potenciali i inovacionit në industrinë ushqimore. - Implementim i ligjit bashkëkohor "Për Ushqimin" dhe përmirësim i mëtejshëm. - Rritje e influencës së Autoritetit të Ushqimit pas ngritjes. - Interesi për certifikime te stakeholderat. - Sistemet e garantimit të cilësisë si katalizatorë për trainimin e stafit. - Potenciale përmirësimi në laboratorët me trainimin e stafit. - Mbështetje e shtetit për OJF-të. - Projektet e BE-së dhe të tjerë në vijim. - Mbështetja ndërkombëtare. - Adoptimi i standardeve të BE-së për ushqimin. - Aksesit tek tregjet ndërkombëtare (përmirëson standardizimin). - Përpjekjet ndërsektoriale nga Ministrinë e linjës.	- Performanca e kufizuar ekonomike/fuqia e limituar e konsumatorëve. - Nivelet e ulta të arsimimit specifik të konsumatorëve. - Arsimimi dhe trainimi i pamjaftueshëm i stafit në të gjithë nivelet. - Oferta të qëndrueshme dhe adekuate të trainimeve (krahas projekteve). - Institucione të ndryshme te përfshira me mbivendosje të kompetencave. - Përfarim i pamjaftueshëm i dokumentave të BE-së në gjuhën shqipe. - Pranim i kufizuar i strategjive te reja nga palet e interesuara.

Anët e forta

Avantazhe krahasuese përsa i perket disa mallrave

Produktet bujqësore me avantazhe krahasuese në Shqipëri janë psh ullinjtë, frutat dhe perimet e hershme, bimët mjeksore dhe peshku. Pemët frutore dhe vreshtat kanë demonstruar shkallën më të lartë të rritjes në vitet e fundit dhe vazhdojnë dhe më tej të shfaqin potencial rritjeje. Sidoqoftë mosplotësimi i nevojave për shkak të prdhimit cilësor dhe / ose konkurueshmërisë së ulët është vërejtur veçanërisht tek mishi për qëllime përpunimi, tek qumështi dhe produktet e tij dhe në shumicën e drithrave. Prodhimi blegtoral realizohet në mënyrë të spikatur në ferma të madhësisë së vogël. Megjithatë ka rritje në vitet e fundit dhe në këtë sektor.

Ligji i ri “Për Ushqimin” së shpejti do të jetë aktiv

Ligji i ri “Për Ushqimin” ka shumë mundësi do të jetë efektiv në fund të vitit 2007 dhe do të sigurojë kuadrin për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit. Temat kryesore që trajton ky ligj janë;

- çështjet e importit dhe eksportit, veçanërisht kontrolli i ushqimeve të importuar,
- miratimi dhe rregjistrimi i ndërmarrjeve,
- obligimet e operatorëve të bizneseve,
- temat e novel food si dhe të ushqimit për blegtorinë,
- etiketimi dhe promovimi i ushqimeve,
- kontrollin e ushqimit dhe autorizimin e laboratorëve të kontrollit,
- vlerësimin dhe menaxhimin e riskut,
- menaxhimin e krizave dhe të situatave të emergjencës, dhe
- organizon organizmat shtetërore për mbrojtjen e konsumatorëve.

Edhe ligji nr.9135, datë 11.9.2003 “Mbi mbrojtjen e konsumatorëve” ofron rregullime të qarta mbi:

- sigurinë e mallrave dhe shërbimeve,
- obligimeve të prodhuesve, tregtarëve dhe ofruesve të shërbimeve,
- kushtet jo korrekte në kontratat,
- tregtinë elektronike, dhe
- organizon organizmat shtetërore për mbrojtjen e konsumatorëve.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të ngrihet në bazë të ligjit të ri

Një nga elementët kryesorë të ligjit “Për Ushqimin” është implementimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nën vartësinë e MBUMK-së. Organizmat e këtij autoriteti që do të menaxhohen nga bordi drejtues (me përfaqësues nga të gjitha ministrinë respektive të linjës) janë; drejtori dhe stafi i tij, një bord këshillimor (me përfaqësues nga të gjitha ministrinë respektive të linjës dhe nga organizata të tjera), komiteti shkencor dhe panelet shkencore si dhe inspektoratet dhe laboratorët respektive.

Ndërmjet detyrave të tjera të këtij autoriteti përfshihen edhe koordinimi i të gjitha llojeve të inspektorateve dhe kontributi në shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve. Në përputhje me anëtarët dhe strukturën e detyrave është e pritshme që do të zhvillohet një potencial për monitorim intensive të sektorit të ushqimit dhe keshilla të qarta për operatorët brenda këtij sektori.

Sistemi i informimit të shpejtë për ushqimin dhe ushqimin për blegtorinë në përputhje me ligjin e ri (RASFF)

Ky aspekt i ligjit të ri “Për Ushqimin” kur të implementohet do të sigurojë mundësi të gjurmimit të hershëm të risqeve ushqimore dhe për këtë arsye mund të trajtohet si një elementë më të fuqishëm në kuptimin e garantimit të sigurisë ushqimore.

Miratimi i rregulloreve të përshtatura të BE-së

Sipas marrëveshjes së stabilizim asociimit (SAA) Shqipëria është e detyruar të përshtasë rregulloret dhe direktivat e BE-së në kushtet shqiptare, duke filluar me Rregulloren No. 178/2002. Këto rregullore kanë vërtetuar të jenë të suksesshme në vendet anëtare të BE-së. Kjo është vërtetuar me anë të analizave të vlerësimit të impaktit. Një nevojë urgjente në kuptimin e diseminimit do të jetë përgatitja e sa më shumë të jetë e mundur e rregulloreve në gjuhën shqipe.

Teknologji bashkëkohore në sajë të investimeve në industri

Industria ushqimore në Shqipëri është e re dhe është ringritur në të vitet '90 pas përmbyesjes së sistemit socialist. Aktualisht investimet në këtë industri mundësojnë aplikimin e teknologjive bashkëkohore. Sidoqoftë ka një mungesë të stafit të mirë arsimuar dhe të mirë trainuar i cili lehtëson avantazhet e sistemeve të rinj. Pavarësisht nga investimet ndërmarrjet ushqimore në mesataren e tyre janë akoma të vogla krahasuar me ato jashtë vëndit dhe akoma të paafta për të përmbushur standardet e cilesisë dhe të sigurisë ushqimore gjë që kufizon sasitë e eksporteve të ushqimeve.

Anët e dobëta

Informacioni / arsimimi / ndërgjegjësimi i Konsumatorëve mbi të drejtat e tyre

Niveli i arsimit dhe informimit të konsumatorëve përsa i përket cilësisë dhe sigurisë ushqimore është akoma i ulët ashtu si edhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve përsa i përket të drejtave të tyre respektive. Arsyet kryesore për këtë situatë janë një shkallë e ulët e vetvendosjes së konsumatorëve dhe oferta të kufizuara të arsimit dhe trainimit respektiv. Nenet 8-11 dhe 12-15 të ligjit Shqiptar Nr. 9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve” evidenton pikat e dobëta dhe ofron një bazë solide për hartimin e politikave dhe masave respektive për të tejkaluar këtë mangësi. Ligji i ri “Për Ushqimin” ofron gjithashtu rregullime për një etiketim të qartë dhe promovim të mirë të ushqimeve të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e nivelit të informimit të konsumatorëve.

Roli dhe influenca e dobët e OJF-ve

Deri tani nuk ekzistojnë OJF të fokusuara në mënyrë të veçantë në çështjet e sigurisë ushqimore në Shqipëri. Kjo vjen veçanërisht për shkak të mungesës së ekspertizës specifike në këtë fushë. Megjithatë disa janë fokusuar në mbrojtjen e konsumatorëve në përgjithësi. OJF-të kryesore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri janë Shoqata Shqiptare e Konsumatorëve dhe Zyra e mbrojtjes së konsumatorëve Shqiptarë. Këto organizata dhe fokusi i tyre në çështjet e ushqimit janë në zhvillim e sipër. Ato kanë nevojë për mbështetje për të përshpejtuar këtë proces dhe që të bëhen fuqi rreguluese të forta në misionin e tyre për mbrojtjen e konsumatorëve. Nenet 52 dhe 53 të ligjit Shqiptar Nr. 9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve” mbështesin statusin dhe rëndësinë e shoqatave të tilla dhe përcaktojnë të drejtat e tyre.

Kufizimet e buxhetit

Buxheti për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në Shqipëri, për qëllimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve është i ulët në krahasim me nevojat. Ky buxhet nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur plotësisht politikën e nevojshme për përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Madje është edhe më e pamjaftueshme në lidhje me numrin në rritje të masave dhe të politikave të nevojshme të sygjera në këtë dokument strategjik.

Aplikim i kufizuar i sistemeve të garantimit të cilësisë

Sipas një vëzhgimi të SEED (2005) vetëm një pjesë shumë e vogël e ndërmarrjeve në këtë sektor i njeh sistemet e garantimit të cilësisë ndërsa madje një pjesë edhe më e vogël i aplikon këto sisteme. Vetëm 14% e sipërmarrjeve të pijeve dhe ushqimeve kanë certifikim të prodhimit, vetëm 6% janë të certifikuara në përputhje me sistemet e menaxhimit të cilësisë si janë ISO 9001 ose HACCP. Nga ana tjetër ekziston në thelb një interes për certifikimin dhe një dëshirë për implementimin e kurseve respektive të trainimit për stafin.

Menaxhim dhe komunikim i dobët i riskut

Menaxhimi dhe komunikimi i riskut janë pika të dobta në procedurat Shqiptare të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorëve. Pjesa V (nenet 30 – 31, 32 – 36, 37 – 38 and 39 – 43) të ligjit Shqiptar Nr. 9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve” rregullon raportin ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve ose ofruesve të shërbimeve. Në veçanti në lidhje me format kontraktuale, uljen e potencialit të risqeve dhe rritjen e komunikimit. Veç kësaj ligji i ri “Për ushqimin” do të sigurojë një bazë solide për një menaxhim bashkëkohor të riskut.

Mungesë e arsimit dhe trainimit të stafit (të gjitha nivelet)

Studimet (SEED, 2005) përshkruajnë një mungesë të arsimit dhe trainimit të stafit në të gjitha nivelet e sektorit të bujqësisë dhe ushqimit. Shkalla e ndërgjegjësimit është e ulët apo inekzistente në lidhje me garantimin e cilësisë si dhe mbi çështjet dhe sistemet e sigurisë ushqimore. Aktualisht vetëm një sasi e kufizuar informacioni në gjuhën Shqipe është disponibël. Projekteve, shtetit dhe OJF-ve iu kërkohet të ofrojnë kurse dhe materiale trainuese për të përmirësuar këtë situatë. Pra rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të vetë konsumatorëve i nxit stafet të përmirësojnë arsimimin e

tyre respektiv dhe nivelin e trainimit. Sipërmarrjet duhet të informohen mbi kurset respective të trainimit dhe duhet të sigurojnë nxitje për stafet e tyre që të ndjekin këto kurse.

Situatë e dobët përsa i përket cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve

Në Shqipëri konstatohet në përgjithësi një situatë e dobët përsa i përket cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Cilësia akoma e pamjaftueshme plotësisht e produkteve ushqimore, dobësitë në matjen e vlerave ushqyese dhe parametrat fiziko-kimikë nuk lejojnë akoma për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe dobësojnë marketingun. Paktim i papërshtatshëm apo inekzistent si dhe etiketi jo i besueshëm në gjuhën Shqiptare, veçanërisht për produktet e importit, besueshmëri e kufizuar në datën e skadencës së produkteve, mungesa e bar kodit dhe çmime që nuk përputhen me vlerën e produktit.

Problemet që vijnë mund të evidentohen përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor:

- Shumica e prodhimit primar nuk është në përputhje me praktikën më të mira të prodhimit (GAP).

- Përpunimi i ushqimeve në përgjithësi kryhet në kushte higjienike jo optimale (mungesë frigoriferësh, magazine të hapura – insektet, zogjtë etj) dhe me staf pamjaftueshmërisht të kualifikuar; kjo veçanërisht është e vërtetë për stafin e laboratorëve (të cilët janë të paisur relativisht mirë).

- Një pjesë e vogël por që po rritet në vitet e fundit e çertifikimit mund të evidentohet në sipërmarrjet përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor.

- Marketingu është i pamjaftueshëm.

- Kërkesat dhe kënaqësia e konsumatorëve merren në konsideratë vetëm në një shkallë të ulët.

Akoma në fuqi standardi Shqiptar i vitit 1987

Standardet Shqiptare në sektorin e ushqimit të vitit 1987 aplikohen akoma dhe nevojitet urgjentisht aktuaizimi i tyre meqenëse dhe rrethanat politike, kushtet ligjore dhe struktura e shtetit të bujqësisë dhe të ushqimit kanë ndryshuar dukshëm. Aktualisht ka zhvillime të reja në drejtim të kaudrit ligjor me ligjin shqiptar nr.9135, datë 11.9.2003 “Mbi mbrojtjen e konsumatorëve” dhe me ligjin e ri “Për ushqimin” i cili është akoma në formë drafti.

Defiçite në tregtinë bujqësore

Shqipëria paraqet një deficit të madh në tregtinë e produkteve bujqësore e ushqimore, me eksporte të përlogaritur në 15% të importeve. Megjithatë ka produkte që kanë avantazhe krahasuese siç janë frutat dhe perimet e hershme, vaji i ullirit dhe peshku. Pozita e dobët tregtare reflekton një numër problemesh specifike si mungesa e organizimit të tregtarëve që eksportojnë, kushte të dobëta të zinxhirit të tregut, problemet me kontrollin e cilësisë.

Pa përputhshmëri me rregulloret ndërkombëtare mbi ushqimin

Aktualisht ka diferenca ndërmjet standardeve Shqiptare dhe atyre ndërkombëtare. Megjithatë, meqenëse tregtia ndërkombëtare po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për produktet Shqiptare me avantazhe krahasuese, këto standard duhen harmonizuar. Kjo do të thotë që gjithnjë e më shumë standard ndërkombëtare duhet të aplikohen mbi produktet Shqiptare.

Etiketimi jo i plotë në gjuhën shqipe

Një nga problemet më madhore në garantimin e cilësisë dhe të sigurisë ushqimore është mungesa e informacionit për konsumatorët, veçanërisht informacioni i plotë në gjuhën Shqipe. Kjo është një pasojë e etiketimit dhe komunikimit të pamjaftueshëm me konsumatorët në gjuhën Shqipe, veçanërisht në rastin e produkteve të importuara. Sidoqoftë, mungesa e informacionit në gjuhën Shqipe nuk mund të konsiderohet si një tregues i cilësisë. Ligji i ri “Për Ushqimin” paraqet rregullime për etiketimin dhe promovimin adekuat të ushqimeve të cilat duhet të ndihmojnë për të përmirësuar nivelin e informimit të konsumatorëve.

Monitorimi i dobët i produkteve të importuara në lidhje me sigurinë

Autoriteti kombëtar i ushqimit nën juridiksionin e MBUMK-së pritet të shërbejë si një institucion potencial i monitorimit intensiv për sektorin e ushqimit dhe duhet të ofrojë këshillim për operatorët në këtë sektor.

Mundësitë

Rritje e ndërgjegjësimit përsa i përket cilësisë dhe sigurisë në të gjitha nivelet

Studimet e fundit (SEED, 2005) tregojnë që ka një rritje të ndërgjegjësimit të operatorëve Shqiptarë të bizneseve ushqimore përsa i përket çështjeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore. Kjo duket se vjen për shkak të përmirësimit në arsimimin dhe trainimin e stafeve. Nëse kjo temë vazhdon të përparojë në menaxhimin e përditshëm të sipërmarrjeve ushqimore është tepër e mundshme të japë

frute të dukshme.

Potenciali i rinovimit në industrinë ushqimore

Industria ushqimore Shqiptare është e re dhe përdor pak a shumë makineri të kohës. Megjithatë, nivelet e arsimimit dhe të trainimit të stafëve janë akoma pika të dobta. Pavarësisht nga investimet, ndërmarrjet e prodhimit të ushqimeve janë mesatarisht të vogla krahasuar me ato jashtë vëndit dhe nuk janë akoma të afta të përmbushin standardet e BE-së për sigurinë ushqimore, gjë që kufizon sasitë e eksporteve të ushqimeve por nga ana tjetër tregon potencial për inovim, veçanërisht në kuptimin e garantimit të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore.

Implementimi i ligjit bashkëkohor “Për ushqimin” dhe përmirësimi i mëtejshëm

Ligji i ri “Për ushqimin” ndoshta do të bëhet efektiv në fund të vitit 2007 dhe do të ofrojë kuadrin për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Çështjet kryesore që trajton ky ligj janë përmendur më lart.

Rritja e influencës së autoritetit të ushqimit pas ngritjes

Pas ngritjes së këtij autoriteti nën vartësinë e MBUMK-së, ai do të jetë një instrument për monitorimin intensiv të sektorit të ushqimit dhe do të ofrojë udhëzimet dhe rregullimet relevante për operatorët e këtij sektori. Ky organizëm duhet shfrytëzuar intensivisht me potencialin e tij dhe ai duhet të zgjerojë influencën e tij në institucionet shtetërore në çështjet që lidhen me kontrollin dhe inspektimin e ushqimeve. Ai do të etë gjithashtu një influence të madhe mbi OJF-të përsa i përket përmirësimit të punës së tyre për mbrojtjen e konsumatorëve.

Interesi të stakeholderat për certifikime

Studimet (SEED, 2005) tregojnë që në thaleb ekziston një interes i organeve menaxhuese të kësaj industrie për sitemet e garantimit të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore. Ata janë të interesuar edhe në ngritjen e sistemeve të trainimit në këto fusha.

Sistemet e garantimit të cilësisë si katalizatorë për trajnimin e stafit

Studimet më të fundit (SEED, 2005) tregojnë që rreth 90% e sipërmarrjeve në sektorin e ushqimit përgjithësisht kërkojnë certifikimin për cilësinë e produktit, 70% për sistemet e menaxhimit të cilësisë; 25% - 35% tregojnë gatishmëri për këto procedura. Kjo situatë duhet të përdoret intensivisht dhe implementimi i sistemeve respektive duhet të jetë katalizator për të tejkaluar pikat e dobëta të arsimimit dhe të trainimit të stafit.

Potenciale përmirësimi në laboratorët me trainimin e stafit

Gatishmëria e lartpërmendur e ndërmarrjeve për të aplikuar masat e garantimit të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore dhe laboratorët e mirëpaisur duhet të nxisin arsimimin dhe trainimin e stafëve. Suksesi i masave të tilla është provuar në projekte dhe masa të tilla duhet të bëhen pjesë e përhershme dhe me bazë të rregullt në ndërmarrjet ushqimore, të paktën kjo për aq kohë sa vlen kjo strategji.

Mbështetje e shtetit për OJF-të

OJF-të në Shqipëri duhet të mbështeten për të përshpejtuar procesin e fokusimit më të fortë në çështjet e ushqimit dhe që ato të bëhen forca të vërteta rregulluese në shërbim të mbrojtjes së konsumatorëve. Nenet 52 dhe 53 të ligjit Shqiptar Nr. 9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve” mbështesin statusin dhe rëndësinë e shoqatave të tilla dhe përcaktojnë të drejtat e tyre. Duhet vënë në dispozicion burime financiare për përmirësimin e mëtejshëm të punës dhe influences së institucioneve të tilla.

Projekti e BE-së dhe të tjerë në vijim

Ka shumë projekte disponibël që mbështesin përmirësimin e procesit në fushën e garantimit të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore. Megjithatë, për shkak të kohës së kufizuar të projekteve të tilla, masat duhen implementuar në atë formë që rezultatet të bëhen të qëndrueshme. Përfshirja intensive e stakeholderave locale në projektet do të ishte një masë e rëndësishme për të garantuar këtë qëndrueshmëri.

Mbështetja ndërkombëtare

Mbështetja ndërkombëtare ofrohet nga organiza si Banka Botërore, FAO, BE, dhe të tjerë dhe duhet të shfrytëzohet në mënyrë intensive. Megjithatë ashtu siç u përmend dhe më lart, kjo mbështetje duhet të shndërrohet në masa të cilat përmirësojnë në mënyrë të qëndrueshme këtë sektor në përpunje me garantimin e cilësisë dhe të sigurisë ushqimore duke përfshirë intensivisht stakeholderat locale në proceset dhe në projektet.

Adaptimi i standardeve të BE-së për ushqimin

Rregulloret e BE-së dhe standardet e ushqimit duhet të bëhen disponibël në gjuhën Shqipe në një

masë më të madhe. Kjo është një nga parakushtet më madhore për t'i transferuar këto standarde tek operatorët Shqiptarë të ushqimit dhe për t'i arsimuar dhe trainuar stafet e tyre në menyrë adekuate. Projektet mund të ndihmojnë për të nisur dhe pershpejtuar këtë proces. Megjithatë institucionet lokale duhet të përfshihen intensivisht në garantimin e qëndrueshmërisë të ketyre masave.

Akresi te tregjet ndërkombëtare (përmirëson standardizimin)

Mbështetja e rritjes së metejshme dhe përmirësimit të konkurrueshmërisë të operatorëve të biznesit të ushqimit dhe forcimi i arsimimit dhe trainimit të stafeve të tyre do të jenë dy parakushtet madhore për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të ushqimit dhe për këtë paraqesin potencial për të rritur depërtimin në tregjet ndërkombëtare. Masat respektive që duhet të merren në konsideratë janë pershkruar më lart dhe përfshijnë mbështetje për investime, përshtatje të sistemeve të garantimit të cilësisë dhe iniciativave të arsimimit dhe të trainimit.

Përpjekjet ndërsektorale nga Ministritë e linjës

Duhet të hartohet një strategji ndërsektorale nga tre Ministritë Shqiptare pjesmarrëse METE, MBUMK dhe MSH dhe të miratohet nga të gjitha ministritë e tjera të përfshira për të shmangur mbivendosjen e kompetencave dhe për të thjeshtuar përpjekjet për të siguruar ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorëve dhe për të garantuar një përdorim efektiv dhe të orientuar drejt të burimeve financiare të kufizuara.

Strategjia e Zhvillimit Rural 2007

Draft ii startegjisë të zhvillimit rural parashikon që pjesa më e madhe e buxhetit do të orientohet në modernizimin e ndërtesave dhe stallave të fermave dhe të ndërmarrjeve të industrisë ushqimore. Industria e qumështit dhe e mishit do të marrin prioritet.

Kërcënimet

Performanca e kufizuar ekonomike/fuqia e kufizuar e konsumatorëve

Performanca e kufizuar ekonomike / fuqia e kufizuar e konsumatorëve i shtyn ata të blejnë produkte me çmime të ulta çfarë shpesh çon në neglizhimin e temave të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore. Autoritetet duhet të garantojnë që në këtë segment të tregut të përmbushen standardet e sigurisë ushqimore. Prandaj duhen adresuar përpjekje respektive për të përmirësuar standardet e sigurisë ushqimore në segmente të tregut ku tregtohen mallra me çmime të ulta Brenda tregjeve respektive. Eksperiencat nga vënde të tjera tregojnë që kjo mund të realizohet me sukses.

Nivelet e ulta të arsimimit specifik të konsumatorëve

Përmirësimi i niveleve të arsimimit nuk mund të jetë një temë vetëm e momentit. Duhet një kohë e gjatë për të pershtatur këto nivele. Një nga masat më të rëndësishme për të kësaj mangësie është përfshirja në kurrikulat e shkollave dhe në programet edukuese të temave respektive dhe nxitja e bindjes së OJF-ve të ofrojnë informacion dhe trainim të përshtatshëm për konsumatorët “adultë”.

Arsimimi dhe trainimi i pamjaftueshëm i stafit në të gjithë nivelet

Meqenëse është detyrë e stafeve në të gjitha nivelet të marrin në dorë dhe të implementojnë pjesën më të madhe të masave dhe të politikave, nevojitet një arsimim dhe një trainim adekuat për anëtarët e ketyre stafeve. Megjithatë nevojitet kohë dhe oferta të mjaftueshme si në kuadrin e projekteve edhe të iniciativave të Shtetit dhe të OJF-ve për të ofruar kurse trainimi specifike për të përmirësuar situatën. Gjithashtu dhe rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve në vetvehte i shtyn këto stafe të përmirësojnë nivelin e arsimimit dhe trainimit specifik respektiv. Ndërmarrjet duhet të informohen mbi kurset respektive dhe duhet të ofrojnë nxitje për stafet e tyre që ata të ndjekin këto kurse.

Oferta të qëndrueshme e adekuate të trainimeve (krahas projekteve)

Deri tani pjesa më e madhe e arsimimit dhe e trainimit për stafet e të gjitha niveleve të sektorit të bujqësisë dhe të ushqimit iniciohen nga projekte dhe për këtë arsye janë disponibël vetëm për një periudhë kohore të kufizuar, sa është edhe kohëzgjatja e projekteve. Përgjegjësitë për këto lloj masash duhen marrë persipër nga institucione dhe shoqata e janë disponibël në menyrë permenente si psh departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (nenet 48 – 51 të ligjit Shqiptar Nr. 9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve”) dhe OJF-të (nenet 52 dhe 53) të ligjit Shqiptar Nr. 9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve”.

Institucione të ndryshme te përfshire me mbivendosje të kompetencave

Aktualisht mund të evidentohen mbivendosje të kompetencave për të përkjet çështjeve të sigurisë ushqimore dhe të mbrojtjes së konsumatorëve kryesisht në Ministritë si METE, MBUMK,

MSH. Kjo mbivendosje e kompetencave duhet të korrigojë dhe duhet hartuar dhe miratuar një strategji ndërsektoriale e thjeshtë nën lidhshypin e këtyre tre Ministrive respektive.

Përafrim i pamjaftueshëm i dokumentave të BE-së në gjuhën Shqipe

Disponibiliteti i të gjitha dokumentave të nevojshëm në lidhje me temat ligjore të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve, veçanërisht ato të ofruara nga BE, por edhe e të gjithë informacionit tjetër mbi sistemet e garantimit të cilësisë dhe të standardeve në gjuhën Shqipe, nevojitet për të garantuar nivele të larta të depërtimit të këtij informacioni respektiv dhe për të ofruar linja të qarta për insiativat për trainime.

Pranim i kufizuar i strategjive të reja nga palet e interesuara

Mungesa e disponibilitetit të informacionit specifik të strategjive inovative për stakeholderat mund të tejkalohet nëpërmjet ofrimit të një informacioni të tillë në të gjitha nivelet. Pra rritja e presionit nga ana e konsumatorëve, organizmave administrative dhe OJF-ve mbi stakeholderat mund t'a përshpejtojë procesin e akceptimit të strategjive inovative. Meqenëse këto vështirësi po përmirësohen vazhdimisht edhe ky nivel i akceptimit duhet të rritet.

3. Vizioni, prioritetet dhe objektivat strategjike

Bazuar në SWOT-in e përmendur më sipër, janë evidentuar vizioni, prioritetet dhe objektivat strategjike që vijnë:

3.1 Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie mbi Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Sigurinë Ushqimore për Shqipërinë 2007-2013 është që konsumatorët Shqiptarë të bëhen individë më mirë të informuar dhe me vetëvendosje dhe të kenë një sjellje më të sigurtë në treg përse i perket ushqimit. Ata do të kenë një aftësi më të mirë në vlerësimin e situatës në treg (përse i perket cilësisë, çmimeve etj.) që vjen si rrjedhojë e një transparence bashkëkohore të tregut. Ata gjithashtu do të kenë një besim më të madhe që rrjedh nga mbrojtja efektive dhe kontrolli i bazuar në një bazë ligjore dhe autoritete administrative të konsoliduara me përgjegjësi të qarta për politikat e kontrollit dhe të mbrojtjes së konsumatorëve. Ky kuadër ligjor dhe administrativ vazhdimisht do të përfrohet me atë të BE-së, do të rrisë kapacitetet administrative në Shqipëri dhe do të iniciojë aktivitete të koordinuara ligjëbërëse. Konsumatorët Shqiptarë të ushqimit do të mbrohen efektivisht nga risqet dhe kërcënimet serioze të cilat ata s'mund t'i përballojnë si individë. Sektori ushqimor i shitjes me pakicë dhe niveli i mbrojtjes së konsumatorëve do të bëhen më të përgatitur për procesin e integritetit në BE me implementimin e kësaj strategjie. Tregjet do të hapen më shumë dhe do të garantohet lëvizja e lire e mallrave. Kuadri strategjik do të përgatisë zinxhirin Shqiptar të ushqimit për gjurmueshmërinë e plotë të gjithë mallrave ushqimore dhe ushqimeve për blegtorinë dhe perbërësve të tyre respektivë. Sektorët, veçanërisht pjesa e eksportit të ushqimeve do të jetë plotësisht në përputhje me rregulloret e OBT-së dhe eksporti do të rritet dukshëm.

3.2 Prioritetet strategjike

Objektivat orientues strategjike të kësaj strategjie janë:

5. Fuqizimi i konsumatorëve Shqiptarë (zgjedhje reale bazuar në informacionin e kujdesshëm, transparenca e tregut, vetëvendosje e forte, besim që rrjedh nga mbrojtja efektive).

6. Mbrojtja e interesave ekonomike të konsumatorëve Shqiptarë në kutpimin e çmimit, zgjedhjes që i ofrohet, cilësisë, llojshmërisë, disponibilitetit dhe sigurisë.

7. Të mbrojnë konsumatorët Shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet të cilat ata nuk mund t'i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale.

5. Të fuqizojë konsumatorët Shqiptarë (zgjedhje reale e bazuar mbi një informacion të saktë, vetëvendosje e fortë, besim që rrjedh nga mbrojtja efektive).

Objektivi është të furnizojë konsumatorët me informacionin e përshtatshëm dhe të saktë mbi cilësinë e ushqimit dhe të ushqimit për blegtorinë.

Pra konsumatorët duhet të kenë transparencë bashkëkohore të tregut dhe mundësinë e zgjedhjes reale; kjo dmth që ka një konkurrencë të mjaftueshme dhe partnerë në treg, veçanërisht tregtarët janë të detyruar të japin informacion mbi çmimet dhe cilësitë përkatëse.

Informacioni dhe komunikimi i mjaftueshëm i mbështetur nga kuadri ligjor janë kyçi për të mbështetur vetëvendosjen e konsumatorëve në përzgjedhje. Ata duhet të vendosen në pozitën në të cilën ata të jenë në gjendje për të vlerësuar mallrat si dhe cilësitë përkatëse dhe çmimet respektive për këto mallra.

Konsumatorët gjithashtu duhet të kenë besim i cili rrjedh nga mbrojtja efektive dhe të jenë të

aftë të vetëvendosin në lidhje me qëndrimin e tyre ndaj mallrave në treg. Duhet të konsolidohet një kuadër ligjor solid për të forcuar të drejtat e konsumatorëve. Ky kuadër ligjor duhet të përmbajë veçoritë e trajtimit të risqeve, të kontrollit të mallrave të importuar, të obligimeve të operatorëve të biznesit, etiketimit dhe promovimit të mallrave, kontrollin e ushqimeve dhe autorizimin e laboratorëve të kontrollit, menaxhimit të krizave dhe situatave të emergjencës, duhet të mbrojtë nga kushtet jo korrekte të kontratave dhe gjithashtu duhet të organizojë organizmat qeveritare për mbrojtjen e konsumatorëve.

6. Të mbrojtë interesat ekonomike të konsumatorëve Shqiptarë në çështjet e çmimit, zgjedhjes, cilësisë, llojshmërisë, disponibilitetit dhe sigurisë.

Duhet të garantohet që rregullat e vendosur janë implementuar efektivisht, dukshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit, informimit, edukimit dhe dëshmipërblimit. Parakushte për këtë janë; një kuadër ligjor i thjeshtë, evidentim i përmirësuar, konsultim më i mirë dhe përfaqësim më i mirë i interesave të konsumatorëve. Një parakusht tjetër për këtë është një konkurrencë e mjaftueshme në tregjet e mallrave ushqimore. Konsumatorët gjithashtu duhet të jenë të mbrojtur nga praktikat jo të ndershme kontraktuale.

3. Të mbrojtë konsumatorët Shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet të cilat ata nuk mund t'i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale.

Një nivel i lartë mbrojtje ndaj këyure kërcënimeve është thelbësore për besueshmërinë e konsumatorëve. Konsumatorët bëhen gjithnjë e më tepër individë për të cilët si vlerësimet ashtu dhe gjykimet bëhen gjithnjë e më të vështira. Një strukturë organizative që përfshin standardet, paisjet e matjes dhe instrumentat duhet të ofrohen qoftë si sisteme kontrolli ashtu edhe si procedura të menaxhimit të riskut dhe të informacionit. OJF aktive duhet të ndihen të detyruara për të mbështetur konsumatorët në kuptimin e përfaqësuesit të konsumatorëve që kujdeset për të drejtat e tij respektive.

3.3 Prioritetet

Prioritet i lartë duhet t'u jepet që të tre këtyre objektivave.

4. Politikat / veprimet dhe masat e planifikuara

Programi qeveritar i jep një prioritet të lartë mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurisë ushqimore si një objektiv ekspllicit në të drejtën e tij. Strategjia e mbrojtjes së konsumatorëve dhe të sigurisë ushqimore e zhvillon më tej këtë objektiv dhe fuqizon bazën për marrjen e masave në favot të konsumatorëve. Siç tregohet dhe më poshtë, kjo strategji i pranon si ndrushimet ekonomike ashtu edhe ato shoqërore që kanë ndodhur si dhe natyrën e pandryshuar të drejtave të konsumatorëve. Ajo i përgjigjet pritshmërive në rritje të konsumatorëve.

Duke iu referuar objektivave të lartë përmendura parashikohen të implementohen në periudhën 2008 – 2013 politikat dhe masat që vijnë:

Të fuqizojë konsumatorët Shqiptarë: (1) zgjedhje reale e bazuar mbi një informacion të saktë, (2) transparencë e tregut, (3) vetëvendosje e fortë, (4) besim që rrjedh nga mbrojtja efektive.

1. Qeveria do të ndjekë fushatat informative për konsumatorët, bizneset, grupet e interes etj. Elementët kyç të këtyre fushatave janë: fokusimi në një çështje të vetme prioritare; përfshirje më e madhe e shoqatave të konsumatorëve, agjencive kombëtare, bizneseve dhe palëve të tjera të interesuara në përgatitjen dhe zhvillimin e fushatave; nëpërmjet vlerësimit; dhe me fushata që normalisht zgjasin më shumë se një vit. Projektet ndërkombëtare mund të mbështesë nisjen e këtyre aktiviteteve. Përmirësime cilësore në arsimim dhe parashikimin e informacionit nevoiten gjithashtu. Bashkëpunim ndërmjet ministrive dhe organizmave të tjera shtetërore do të luajnë një rol në rritje në të gjitha veprimet e propozuara. Për të kontribuar në promovimin e edukimit të konsumatorëve, qeveria në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe kombëtare do të mbështesë shkëmbimin e praktikave më të mira në integrimin e edukimit të konsumatorëve në sektorin e edukimit shkollor. Qeveria do të fokusohet në veçanti në prodhimin e materialeve mësimore, në trainimin e mësuesve dhe në ndërveprimin ndërmjet shkollave dhe mjediseve lokale, përfshirë ndërmarrjet lokale dhe përfaqësue të bizneseve.

Masat specifike që do të merren përfshijnë:

- Fushata të rritjes së ndërgjegjësimit për konsumatorët, bizneset dhe grupet e tjera të interesit.
- Publikime në temat me interes për ushqim të cilësisë të lartë dhe të sigurtë.
- Ofrimin e informacionit online.

- Konferenca, seminare, takime me ekspertë dhe stakeholderat.
- Fillimin e përfshirjes së temave të mbrojtjes së konsumatorëve në kurrikulat shkollore.
- Prodhimin e materialeve shkollore, trainimin e mësuesve dhe ndërveprimin ndërmjet shkollave dhe mjediseve lokale.

- Krijimin e networkut të OJF-vë të konsumatorëve dhe të shëndetit dhe stakeholderave të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë agjencinë kombëtare të ushqimit.

2. Konsultimet sistematike me konsumatorët, nëpërmjet shoqatave të tyre do të vazhdojë të ketë prioritet të lartë në fuqizimin e zërit të konsumatorëve. Qeveria do të studiojë se si të përfshijë konsumatorët dhe bizneset në process konsultimi të përbashkët dhe do të marrë në considerate dhe bizneset në process konsultimi të përbashkët dhe do të marrë në considerate çështjen nëse duhet një forum permanent konsultimi konsumator-biznes.

Një koordinim më i mirë i konsultimeve sektoriale ekzistuese të konsumatorëve do të jetë i rëndësishëm. Aty ku është e mundur, qeveria synon të mbështesë dialogun më profesional që çon në marrëveshje vetërregulluese ndërmjet konsumatorëve dhe bizneseve, përfshirë dhe sektorin e shitjes me pakicë. Sistemet e monitorimit të tregjeve konsumatore dhe të politikave konsumatore do të ngrihen.

Masat specifike që do të merren përmbajnë:

- Sistemet e monitorimit të tregjeve.
- Përmirësimin e komunikimit me konsumatorët.
- Promovimin e dialogut biznes-konsumator.
- Kurse trainimi për stafet e organizatave të konsumatorëve.
- Masa bashkepunimi me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Konsumatorët kanë përgjegjësinë të zhvillojnë interesat e tyre. Pra, të ndihmohet konsumatorët për të ndihmuar vetveten është një pjesë thelbësore e politikëbërjes. Mbështetja e të drejtës për informin, vetëorganizim dhe arsimim e konsumatorëve është thelbi i kësaj strategjie. Gama dhe kompleksiteti i produkteve dhe teknikave të marketingut, zhvillimi i shërbimeve gjithnjë e më komplekse dhe liberalizimi të gjitha së bashku nënkupton një rol më të madh të organizatave të konsumatorëve. Së pari, ato duhet të mbrojnë konsumatorët të krijojnë idenë e informacionit tepër të gjërë që është disponibël dhe së dyti ato do të kenë një rol vital në fuqizimin e zërit të konsumatorëve në vendimarrje.

Masat specifike që do të merren përfshijnë:

- Ngritjen dhe bërjen funksionale të pikave të informacionit.
- Të ofruarit e informacionit respektiv.
- Identifikimi i ushqimeve të sigurta.

- Etiketimi dhe çertifikimi në gjuhën shqipe në përputhje me ligjin për “Mbrojtjen e konsumatorëve” dhe atë “Për ushqimin”.

- Përmirësimin e komunikimit me konsumatorët.
- Mbështetja dhe fuqizim i shoqatave të konsumatorëve.

4. Qeveria do të implementojë dhe kontrollojë një kuadër ligjor të konsoliduar në lidhje me sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Ajo gjithashtu do të mbështesë shoqatat kombëtare të konsumatorëve dhe organizmat e tjera konsumatore për projekte specifike (përfshirë trainimet) të cilat përmirësojnë kapacitetet e tyre për të përfaqësuar, informuar dhe këshilluar konsumatorët. Mbështetja financiare e qeverisë për shoqatat e konsumatorëve do të synojë edhe rritjen e kapaciteteve të tyre për të ndërmarrë veprime kolektive ligjore dhe për të garantuar që ato zotërojnë ekspertizën e nevojshme.

Masat specifike që do të merren përfshijnë:

- Implementimin e ligjit “Për ushqimin”.
- Përmirësimin e rregullimeve ligjore për hqjenën e ushqimeve dhe të tjera.
- Promovim i mirëqënies së kafshëve.
- Mbështesë fermerët/përpunuesit e ushqimit/tregtarët e ushqimeve për të ndjekur praktikën më të mira bujqësore/praktikat më të mira të prodhimit/praktikat më të mira higjienike, veçanërisht për komoditetet me avantazhe krahasuese dhe potenciale eksporti
- Përdorimi i burimeve financiare të planit të zhvillimit rural për investime respektive
- Promovim i produkteve bujqësore Shqiptare në panairët ndërkombëtare

- Promovim dhe fuqizim i shoqatave të konsumatorëve.

Të rrisë mirëqënien e konsumatorëve Shqiptarë në kuptimin e çmimit, zgjedhjes, cilësisë, llojshmërisë, disponibilitetit dhe sigurisë.

Qeveria duhet të adoptojë rregullime të cilat rrisin mirëqënien e konsumatorëve. Kujdesi për një transparence të mjaftueshme mbi çmimet, etiketat, për të garantuar standardet e cilësisë dhe të sigurisë. Përveç të tjerave monitorimi i zhvillimit të mirëqënies së konsumatorëve duhet të bazohet mbi një kuadër statistikor të qartë.

Masat specifike që do të merren përfshijnë:

- Sistemet e monitorimit për tregjet konsumatore.
- Etiketim dhe çertifikim në gjuhën.
- Ofrimi i informacionit online.
- Fushata të rritjes të shkallës së ndërgjegjësimit dhe promocion përsa i përket standardeve ndërkombëtare për garantimin e cilësisë së ushqimeve, veçanërisht në përputhje me kërkesat e BE-së.
- Mbrojtje nga praktikat jo korrekte tregtare në përputhje me ligjin për “Mbrojtjen e konsumatorëve”.
- Mbledhja e statistikave specifike për të hartuar politika për konsumatorin të bazuara njohuritë duhen.
- Kryerja e vërtetimeve dhe matjes së indikatorëve të kënaqësisë së konsumatorëve.

Të mbrojnë konsumatorët Shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet të cilat ata nuk mund t’i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale.

Përveç një kuadri ligjor solid dhe mekanizmave shtetërore të kontrollit, shoqatat e konsumatorëve kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e interesave të konsumatorëve dhe në mbrojtjen e tyre efektive nga risqet dhe kërcënimet serioze të cilat ata nuk mund t’i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale, sepse shoqatat mund të përqëndrohen mbi çështjen në një mënyrë që konsumatori i zakonshëm nuk mund ta bëjë. Mekanizmat shtetërore të kontrollit duhen forcuar dhe të mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme dhe ndihma financiare nevojitet për t’i mundësuar shoqatave të përfaqësojnë konsumatorët në mënyrë efektive, ndërsa ruajnë pavarësinë e tyre nga autoritetet shtetërore. Megjithatë çështjet me të cilat përballen konsumatorët bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara nga pikpamja teknike, është thelbësore të garantohet që shoqatat zotërojnë ekspertizën e pershtatëshme. Pra ato duhet të përfshihen vazhdimisht në konsultime gjatë procesit të vendimmarrjes. Ndihma financiare nga qeveria do të lidhet me një angazhim të shoqatave për të bashkëpunuar ngushtë me njëra tjetrën, por dhe me organizmat shtetërore. Mbështetja do të fokusohet në ekspertizën teknike nga specialistët e shoqatave. Krahas kësaj nga ana e saj qeveria duhet të ofrojë kuadrin metodologjik dhe strukturën organizative për të garantuar gjurmimin e hershëm, menaxhimin dhe komunikimin e riskut. Qeveria gjithashtu do të përpiqet të garantojë që komitetet e saj këshillimore të luajnë një rol aktiv në promovimin e dialogut ndërmjet stakeholderave.

Masat specifike që do të merren përfshijnë:

- Fuqizimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të inspektorateve shtetërore dhe laboratorëve, me theks të veçantë tek produktet e importit.
 - Kontroll i sigurisë ushqimore për të shmangur përbërësit e padëshëruar të ushqimit.
 - Promovim dhe fuqizim i shoqatave të konsumatorëve.
 - Thjeshtim i procedurave institucionale për kontrollin dhe sigurinë ushqimore në nivel kombëtar.
 - Sistemi i monitorimit dhe trajtimit të ankesave të konsumatorëve.
 - Promovim i zhvillimit dhe harmonizim i metodologjive të vlerësimit dhe menaxhimit të riskut.
 - Ngritja e mekanizmave që kanë të bëjnë me gjurmimin e hershëm të risqeve dhe veprimet ndaj risqeve të identifikuar rishtas (RASFF për ushqimin dhe ushqimin për blegtorinë; RAPEX për produktet jo ushqimore).
 - Strategji për të përmirësuar komunikimin e riskut.
 - Trajnim në menaxhimin e riskut.
 - Mbështetje për këshillimin shkencor dhe vlerësimin e riskut, përfshirë detyrat e komiteteve shkencore të pavarura.
 - Akreditimi i laboratoreve.
5. Implementatimi, monitorimi dhe vlerësimi

5.1 Implementimi

5.1.1 Autoritetet përgjegjëse

Në përputhje me ligjin Shqiptar Nr. 9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve” dhe ligjin e ri “Për Ushqimin” organizmi organizativ përgjegjës për këtë strategji është

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Shqipëri

Sheshi “Skënderbej”, nr. 2, Tiranë

5.1.2 Detyrat

Sektorët përkatës të MBUMK-së, janë përgjegjës për implementimin cilësor të politikave dhe monitorimin e tyre.

Njësitë e ndërrarura nga MBUMK janë përgjegjëse për implementimin administrativ të politikave. Përgjegjësitë dhe detyrat janë si vijon:

Njësitë vartëse		Përgjegjësitë / detyrat	Baza ligjore
12 Drejtoritë rajonale	Inspektorat i për sigurinë ushqimore	Kontroll (implementim i ligjit, gjurmueshmëri dhe cilësi ushqimore, kushtet sanitare, kampionet e ushqimit, etiketimi, kushtet e magazinimit, kushtet teknike). Lejet/licensat për përpunim ushqimi, përdorimin e aditiveve dhe të materialeve të paketimit. Inspektimi dhe kontrolli në PKK (kontroll fizik, sanitar dhe veterinar dhe rregjistrim i eksporteve, importeve dhe tranzitit të produkteve).	Ligji nr.7941, datë 37.5.1995 “Për ushqimin”
	Inspektorat i për shëndetin e kafshëve	Kontroll (performance për mirëqënien, shëndetin dhe riprodhimin e kafshëve, kushtet sanitare-veterinare, të kafshëve, fermave të mbarështimit të tyre, produkteve me origjinë shtazore, materialet lëndë e parë, ushqimit për blegtorinë, ujë, të korrave, tregtisë të medikamenteve veterinarë, situatë epizootike e sëmundjeve zooze, rregjistrime për qëndrat e prodhimit dhe të përpunimit). Inspektimi dhe kontrolli në PKK (kushtet sanitare-veterinare, kampionet e produkteve, rregjistrimin e import/eksporteve). Mbikëqyrje (dizinfektim dhe kontroll për masat higjieno-sanitare e kushtet e mjeteve të transportit).	Ligji nr.9308, datë 4.11.2004 për “Shërbimin dhe inspektoratin veterinar”
	Inspektorat i për mbrojtjen e bimëve	Kontrolli (Implementimi i Ligjit “Per mbrojtjen e bimeve”, ne nivel rajonal, situata fitosanitare ne rajon, implementimi dhe monitorimi i programeve per parazitët karantinore ne rajon, mbledhja dhe analizimi i informacionit ne nivel rajonal per; a) probleme fitosanitare te bimeve dhe te produkteve te bimeve; b) probleme	Ligji nr.9362, datë 24.3.2005 “Per shërbimin e mbrojtjes se bimeve”

		fitosanitare te bimeve dhe te produkteve te bimeve per eksport; c) shitja dhe perdorimi i PMB (Produktet te Mbrojtjes se Bimeve), kontroll i pastertise fitosanitare te materialeve mbjelles ne nivel rajonal). Leje/licenca (certifikate fitosanitare per bimet dhe produktet bimore te prodhuara ne rajon dhe te destinuara per eksport, ri-eksport dhe levizje te tjera brenda vendit. Regjistrim i te gjitha subjekteve qe operojne ne import, eksport, prodhim, grumbullim dhe shitje me shumice te bimeve, produkteve bimore dhe materialeve te tjera, per te cilat eshte i nevojshem inspektimi fitosanitar) Inspektimi dhe kontrolli ne PKK per cdo sasi malli qe hyn ne territorin e Republikes se Shqiperise, i kategorizuar si PMB, bime, produkt bimor ose te tjera qe mund te jene objekt i parazitave karantinore, kontroll i dokumentacionit te mallit, origjina e mallit, inspektim vizual fitosanitar i mallit. Regjistrimi i mallrave te importuara, eksportuara ose tranzituara, pergatitje e raport-kontrolleve fitosanitare. Marrja e kampioneve per t'u derguar ne laboratoret rajonale.	
--	--	---	--

Në përputhje me ligjin “Për ushqimin” dhe ligjin “për Mbrojtjen e Konsumatorëve” do të ngrihet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nën vartësinë e MBUMK-së. Organet e këtij autoriteti do të menaxhohen nga bordi drejtues (me përfaqësues nga të gjitha minsitritë përkatëse të linjes), nga drejtori dhe stafi i tij, nga një bord këshillimor (me përfaqësues nga të gjitha minsitritë përkatëse të linjes dhe nga organizata të tjera), nga një komitet shkencor dhe panelet shkencore, inspektoratet dhe laboratorët respektive.

Mbivendosje e kompetencave të ministrive të linjës përse i përket çështjeve të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorëve, kryesisht mund të evidentohen tek METE, MBUMK, MSH. Kjo mbivendosje kompetencash korrigjohet dhe thjeshtohet me anë të strategjisë ndërsektoriale nën leadershipin e këtyre tre ministrive.

5.2 Përcaktimi i buxhetit

Buxheti i alokuar për këto politika kap shumë rreth 4 milion €uro. Shpërndarja e këtij buxheti ndër vite (2008 deri 2013) dhe sipas politikave është paraqitur në aneksin përkatës. Pjesa dominuese e këtij buxheti do të alokohet politikave të transparencës së tregut, veçanërisht sistemeve të monitorimit të tregjeve konsumatore (rreth 2 milion €uro) dhe për përmirësimin e komunikimit me konsumatorët (rreth 0.5 milion €uro). Një pjesë tjetër e rëndësishme e buxhetit (rreth 0.5 milion €uro) do të shpenzohet për fuqizimin e kapaciteteve të strukturave të kontrollit dhe inspektimit.

5.3 Monitorimi dhe vlerësimi

Për vlerësimin e arritjeve të strategjisë së sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit hartuar nga MBUMK duhet ngritur një sistem monitorimi dhe vlerësimi. Do të formulohen indikatorë të nivelit të lartë për rezultatet për të mundur potenciale për një monitorim dhe vlerësim sistematik.

5.3.1 Monitorimi

Institucionet respektive administrative janë përgjegjëse për mbikqyrjen e cilësisë të implementimit të strategjisë mbi bazën e indikatorëve financiarë dhe të impaktit. Për këto detyra duhet të ngrihet një sistem i monitorimit. Raporte vjetore duhet t'i paraqiten zyrës së Kryeministrit dhe duhet të miratohen paraprakisht nga kjo Ministri.

5.3.2 Vlerësimi

Vlerësimi duhet të jetë një proces i permanent gjatë gjithë kohës që parashikon kjo strategji. Ekspertë të pavarur duhet që në mënyrë permanente të vlerësojnë cilesinë, eficiencën dhe impaktin e strategjisë së implementuar. Duhet parashikuar rishikime afatmesme (Mid-term) dhe Ex-post.

Indikatorët duhet të lidhen ngushtë me politikat, veprimet dhe masat dhe të përfshijnë indikatorët e outputit, rezultateve dhe të impaktit. Indikatorët duhet të formulohen në lidhje me pjesët e buxhetit që i përcaktohet çdo veprimi/mase. Këta lloj Indikatorësh janë sygjeruar dhe paraqitur në pjesën hyrëse të strategjisë ndërsektoriale. Përsa i përket çështjeve të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurisë ushqimore duhen marrë në considerate indikatorët si më poshtë:

- Numri i fushatave, kurseve të trainimit, seminareve etj si dhe numri i pjesëmarrësve.
- Numri i akseseve tek informacioni online mbi mbrojtjen e konsumatorëve dhe sigurinë ushqimore.
- % e kurrikulave shkollore që trajtojnë çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve dhe të sigurisë ushqimore.
- Zhvillimi i indeksit të çmimit të onsumatorëve për ushqimin dhe ushqimet për blegtorinë.
- Zhvillimi i buxhetit / numrit të stafit të OJF-ve.
- Numri i ankesave të konsumatorëve përsa i përket sigurisë dhe cilësisë ushqimore.
- Pjesa në eksporte e produkteve ushqimore dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Numri i pikave të informimit.
- Numri i certifikatave të cilësisë në përpunimin e ushqimeve dhe bizneset e sitjes me pakicë të produkteve ushqimore.
- Pjesëmarrja e kompanive Shqiptare të ushqimit dhe ushqimit për blegtorinë ne panaiet ndërkombetare.

6. Perspektivat

Perspektiva e kësaj strategjie brenda horizontit kohor të synuar dhe me tej në të ardhmen do të jetë të bëjë sektorin Shqiptar të ushqimit dhe nivelin e mbrojtjes së konsumatorëve të përgatitur mirë për anëtarësimin në BE. Të përgatisë tërë zinxhirin agro-ushqimor në Shqipëri për gjurmueshmërinë e plotë të të gjitha llojeve të ushqimeve dhe atyre për blegtorinë. Sektori, veçanërisht pjesa për eksport e prodhimit duhet të jetë në përputhje të plotë me rregullimet e OBT-së. E fundit por jo më pak e rëndësishmja, pjesa e produkteve bujqësore dhe të përpunuara duhet të rritet vazhdimisht.

PJESA III

MBROJTJA E KONSUMATOREVE DHE MBIKËQYRJA E TREGUT PËR PRODUKTET INDUSTRIALE

1. Hyrje

Në realitetin shqiptar, koncepti “konsumator” po gjen përdorim gjithnjë e më dendur. Në legjislacionin tone, ai e ka gjetur specifikim dhe reference në Ligjin nr. 9135, datë 11.09.2003, “Për Mbrojtjen e Konsumatoreve” (me poshtë ligji për mbrojtjen e konsumatoreve).

Zhvillimi i reformave social-ekonomike të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare dhe të pasqyruara në Programin 2005 – 2009 të saj, që po zbatohet në këto periudha intensive të veprimtarisë institucionale, lidhen ngushtë se pari, me harmonizimin e legjislacionit tone me atë të Bashkimit Europian; së dyti, me domosdoshmerinë e forcimit të kapaciteteve administrative, në mënyrë që të jenë të afta dhe efikase për të zbatuar standardet e reja; së treti, me studimin e gjendjes për evidentimin e atyre segmenteve të tregut, të cilat nuk janë të mbuluara me kontroll dhe marrjen e inisiativave ligjore të koordinuara për fuqizimin institucional të veprimeve kompetente dhe, së katërti, forcimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile në procesin e mbrojtjes së konsumatoreve.

Ndryshimet social-ekonomike, hapja e tregut dhe levizja e lire e mallrave kanë sjellë marrëdhënie të reja, lidhur me mallrat dhe shërbimet që i ofrohen konsumatorit, të cilat reflektohen drejtpërdrejt në sigurinë e jetës dhe shëndetit. Në periudhën e dekadës së fundit, ka patur zhvillime e faktore të rinj ndikues në marrëdhëniet e konsumatorit shqiptar me tregun. Në kompleksitetin e këtyre faktoreve, me kryesori në realitetin tone është Traktati i Amsterdimit i vitit 1997, i cili sanksionoi kritere të reja e me të përparuar vlerësimin të mbrojtjes së interesave të konsumatoreve. Nderkohe që, dëshira e brendshme për integrim, filloi të kristalizohej me marrëveshje konkrete si : anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), me Marrëveshjet e Tregtisë së Lire (MTL) me vendet e Rajonit e me gjere dhe, së fundmi, bashkëpunimi institucional i strukturave të Bashkimit Europian me Shtetin Shqiptar e Institucionet përfaqësuese të tij, në fusha të ndryshme, në kuader të negociatave për

nenshkrimin e Marreveshjes se Stabilizim Asocimit (MSA) ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Bashkimit European. Kjo hapje e tregut dhe ballafaqimi i drejtperdrejte i konsumatorit shqiptar me kete realitet, solli nevojen e reflektimeve te pershtatshme, ne drejtim te hartimit te politikave rregulluese afatgjata ne mbrojtje te interesave te konsumatorit shqiptar.

Ligji per mbrojtjen e konsumatoreve, pasqyron lidhjen konceptuale me faktoret e siperpermendur dhe marredheniet e reja te krijuara ne fushen e sigurise se jetes dhe te shendetit te konsumatorit, si dhe te faktit qe nepermjet tij, mbrojtja e interesave eshte ligjore, insitucionale, gjithepershires e bashkekohore ne kendveshtrimin e direktivave Evropiane.

Ligji per mbrojtjen e konsumatoreve, vendos bazat ligjore dhe institucionale per nje zhvillim sistematik ne drejtim te mbrojtjes te te drejtave te konsumatoreve dhe te veprimit te strukturave perkatese, per te siguruar implementimin e ketyre te drejtave.

Ndonese zhvillimet ekonomike, sociale e politike te viteve te fundit ne Shqiperi, kane sjelle ndryshime pozitive ne fushen e mbrojtjes se konsumatoreve, vecanerisht ne lidhje me legjislacionin mbetet per te bere me shume ne te ardhmen. Rregulla mbrojtese shtese duhet te adoptohen, vecanerisht ne fushen e sigurise se produktit, informimit te konsumatoreve dhe edukimit te tyre, te cilat, duhet te promovohen me shume ne te ardhmen; gjithashtu me shume perpjekje duhet te behet ne menyre qe te rritet perfaqesimi i interesave te konsumatoreve ne shoqerine civile. Çeshtjes se zbatimit te legjislacionit ne mbrojtje te konsumatorit duhet ti jepet nje prioritet i vecante: mekanizmat efektiv te demshperblimit per konsumatorin duhet te zhvillohen me tej dhe nje sistem i pershtatshem i mbikëqyrjes se tregut duhet te ngrihet.

Qeverisja e mire, eficensa dhe transparenca jane shkaqe shtytese per zhvillim efektiv te mbrojtjes se konsumatorit dhe mbikëqyrjes se tregut ne Shqiperi. Ky proces duhet te jete sistematik, detyrat dhe pergjegjesite e ministrive te linjes dhe autoriteteve te tjera duhet te jene te qarta dhe transparente, objektiva dhe afatet te percaktuara dhe te kontrolluara rregullisht, si dhe te identifikohen qarte burimet e nevojshme, mjetet implementuese dhe kontrollat e herepashershme. Nevojitet nje strategji e planifikuar si nga ana e mbeshtetjes ligjore ashtu edhe nga ana e ngritjes se kapaciteteve institucionale. Arsyet e mesiperme e shtyn Keshillin Kordinativ te vendose per hartimin e nje strategjie ne mbrojtje te konsumatoreve, e cila do te konturoje politiken shteterore ne fushen e mbrojtjes se konsumatorit per vitet qe vijne.

Drejtoria e Mbikëqyrjes se Tregut (me poshte DMT), ne Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes (me poshte METE), koordinon zhvillimin e kesaj politike. Theksi i duhet vene rendesise se mbikëqyrjes se tregut ne kete strategji, sidomos persa i perket produkteve te pasigurta te hedhura ne treg. Prandaj u propozua te kombinoreshin strategjia e mbrojtjes se konsumatorit dhe strategjia e mbikëqyrjes se tregut ne nje te vetme dhe te zhvillohej nje Strategji per Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut (me poshte Strategjia).

Draft-strategjia per mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut paraqitet per diskutime te metejshme.

Strategjia parashikon adoptimin e masave dhe iniciativave ne mbrojtje te konsumatorit dhe mbikëqyrjes se tregut ne Shqiperi per nje periudhe 7 vjecare (2007-2013). Ndersa reflekton kushtet sociale, ekonomike dhe ligjore ne Shqiperi, kjo strategji harmonizohet me strategjite e Komunitetit Evropian ne fushen e politikave konsumatore. Gjithashtu jane marre ne konsiderate eksperiencat nga strategjite kombetare te disa vendeve anetare te BE-se.

Draft-strategjia është menduar te mbuloje nje spekter te gjere te te drejtave te konsumatoreve, perfshire çeshtje te sigurise se mallrave dhe sherbimeve, mbikëqyrjen e tregut, aspektet ekonomike dhe ligjore ne lidhje me pozicionin e konsumatorit ne treg, informimin dhe edukimin e konsumatoreve, mekanizmat e demshperblimit te konsumatoreve, inkurajimin e shoqatave te konsumatoreve dhe kontributin e tyre sebashku me aktore te tjere ne zhvillimin dhe implementimin e strategjise ne mbrojtje te konsumatoreve, si dhe te jape propozime konkrete ne lidhje me strukturen dhe objektivat per arritjen e zbatimit te detyrave qe shtrun kjo strategji.

2. Qellimi

Strategjia mbulon çeshtjet qe lidhen me mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut.

Konsumator sipas percaktimit te Ligjit te vitit 2003 "Per mbrojtjen e Konsumatorit", eshte çdo person i cili blen apo perdor te mallra apo sherbime per te permbushur nevojat e tij personale, per qellime qe nuk lidhen me tregti, biznes apo ushtrim profesioni. Politika per mbrojtjen e konsumatorit perfshin nje game te gjere çështjesh, te tilla si: siguria e konsumatorit, informimi i konsumatorit,

edukimin e konsumatorit, mbrojtjen e interesave ekonomike, demshperblimin per ankesat te konsumatoreve si dhe perfaqesimin e tyre. Kjo mbrojtje behet per çdo mall apo sherbim te ofruar konsumatorit ose per tu perdorur nga ai, apo qe ka gjasa te arrije ne tregun e konsumatorit.

Mbikëqyrja e Tregut (qe ketej e tutje MT) eshte detyre e autoriteteve shteterore, te cilat duhet te verifikojne nese produkti apo sherbimi i vendosur ne treg perputhet me legjislacionin e zbatuar mbi to. Mbikëqyrja efektive e tregut siguron nje nivel te njejte mbrojtjeje per qytetaret ne gjithë vendin dhe gjithashtu u jep mundesi te njehta operatoreve ekonomik.

Mbikeqyrja e tregut eshte monitorim dhe kontroll, nese produkti apo sherbimi i vendosur ne treg perputhet me legjislacionin perkates, si dhe eshte gjithashtu ndermarrja e veprimeve parandaluese dhe korrigjuese kundrejt produkteve apo sherbimeve qe nuk jane konform këtij legjislacioni. Kjo perfshin si veprimin reagues (kontrollin e tregut dhe sanksionet per shkeljen e ligjit) ashtu dhe trajtimin parandalues (zhvillimin e mjeteve parandaluese te rrezikut nepermjet informimit, keshillimit dhe bashkepunimit).

Ne fushen Europiane, koncepti i mbikëqyrjes se tregut fillimisht hyri nga mesi i viteve 80-te, ne permbajtjen e direktivave te perafrimit te ri (New Approach Directives) per te rregulluar produktet teknike. Modeli i këtij përafrimi konsistonte ne harmonizimin e ligjeve te Shteteve Anetare per disa lloj produktesh, i cili duhej te kufizohej ne percaktimin e kerkesave thelbësore te produktit. Me tej, organizmat standartizuese u mandatuan per te adoptuar përshkrime te detajuara per keto produkte ne formen e standardeve vullnetare. Ne menyre qe te perfitohej nga qarkullimi i lire i mallrave ne tregun e brendshem Evropian, prodhuesi duhej te provonte qe produkti i tij ishte ne përputhje me kerkesat thelbësore dhe ai mund ta bente kete nepermjet procedurave te ndryshme te vleresimit te konformitetit, instrumentave te markimit dhe deklarimit, te cilat jane percaktuar ne çdo Direktive te Perfarimit te Ri.

Mbikeqyrja e tregut eshte nje aktivitet i bazuar ne idene se industria eshte pergjegjese te permbushe kerkesat ndaj produktit; sistemi europian bazohet ne besimin ndaj industrise. Mbikeqyrja e tregut duhet te ndjeke nese industria i zbaton keto kerkesa.

Koncepti i mbikëqyrjes se tregut tashme eshte shtire pertej Direktivave te Perafrimit te Ri dhe perfshin te gjitha produktet e hedhura ne treg, gje qe eshte sanksionuar me Direktiven e vitit 1992 dhe me tej ne Direktiven e vitit 2001, mbi detyrimin e pergjithshem per sigurine e produktit. Disa prej Shteteve Anetare kane aplikuar dispozitat e kesaj direktive edhe per fushen e sherbimeve.

Mbikeqyrja e tregut percakton te gjitha iniciativat dhe masat e llojeve te ndryshme te cilat synojne te sigurojne se vetem produkte dhe sherbime te sigurta jane hedhur apo qarkullojne ne treg. Kjo perfshin nje game te gjere masash, te cilat percaktojne bazen ligjore te aktiviteteteve te mbikëqyrjes se tregut, vendosjen e nje kuadri te pershtatshem institucional per mbikëqyrjen e tregut, dhenien e kompetencave dhe funksioneve te duhura autoriteteve te mbikëqyrjes se tregut, zhvillimin e procedurave te bashkepunimit dhe shkembimit te informacionit.

Duke qene se mbrojtja e konsumatorit kundrejt produkteve dhe sherbimeve te pasigurta eshte nje pjese thelbësore e politikës se konsumatoreve, mbikeqyrja e tregut dhe mbrojtja e konsumatorit jane te lidhura ngushte.

Strategjia ka si qellim te zbatohet tek te gjitha produktet dhe sherbimet e ofruara konsumatoreve apo qe synohen te perdoren prej tij. Vetem pak produkte dhe sherbime nuk do te jene pjese e fushes se kesaj strategjie, p.sh.: produkte dhe sherbime qe synohen vetem per perdorim industrial, biznes apo profesional.

Mallrat specifike per konsumatore si: ushqimet dhe produktet farmaceutike jane subjekt i kerkesave specifike te parashikuara ne legjislacionin shqiptar. Strategjia do te zbatohet ne parim per keto sektore te rregulluar, por vetem per çështjet dhe rreziqe apo kategori te rrezikut, te cilat nuk mbulohen nga kerkesa specifike. Persa i takon produkteve ushqimore ne veçanti pritet qe autoritetet pergjegjese te hartojne dhe te paraqesin per diskutim nje strategji te vecante mbi cilesine dhe sigurine e ushqimit ne përputhje me përafrimet Evropiane dhe me kete Strategji.

3. Objektivat

Objektivat kryesore politike te kesaj Strategjie jane:

- T'u garantoje konsumatoreve ne treg nje nivel te larte mbrojtjeje ne gjithë vendin;
- Te harmonizojë ligjet dhe praktikat e vendit tone me legjislacionin e BE-se ne fushen e mbrojtjes se konsumatorit dhe mbikëqyrjes se tregut;
- Te garantoje vendosjen apo qarkullimin ne treg vetem te produkteve dhe sherbime te sigurta;
- Te siguroje zbatimin ne praktike te legjislacionit mbi konsumaret dhe mbikëqyrjen e

tregut;

- Te vendose ne te gjithë vendin një sistem operacional dhe eficient të mbikëqyrjes së tregut;

T'i bëj operatorët ekonomikë me të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre sociale përkundrejt konsumatorëve;

- Te rrisë ndergjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre;

- Te garantojë pjesëmarrjen reale të përfaqësuesve të organizatave të konsumatorëve, apo interesave të tjera të konsumatorëve, në proceset vendim-marrëse në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjes së tregut.

Objektivat e sipërpermendura janë në përputhje me objektivat e vendosura për mbrojtjen e konsumatorit në Strategjinë Europiane për Konsumatorët 2002 – 2006. Konkretisht:

- Nivel i lartë për mbrojtjen e konsumatorit;

- Zbatim efektiv i rregullave për mbrojtjen e konsumatorit;

- Përfshirja e organizatave të konsumatorëve në politikën e BE-së.

Gjithashtu këto objektivat janë në linjë dhe me Programin e konsumatorëve të BE-së për vitet 2007 – 2013 (të miratuar më 18 dhjetor 2006). Konkretisht:

- Garantimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, veçanërisht nëpërmjet përmirësimit të informacionit mbi të dhënat e lidhura me konsumatorët, një konsultim me të mirë, dhe një përfaqësim me të mirë të interesave të konsumatorëve;

- Garantimi i një zbatim efektiv të rregullave për mbrojtjen e konsumatorëve, veçanërisht nëpërmjet bashkëpunimit midis autoriteteve dhe organizatave përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fushën e konsumatorit, informimit, edukimit dhe zgjidhjes së mosmarrveshjeve të ankesave të konsumatorëve

Objektivat e Strategjisë i janë pershtatur situatës, strukturës dhe nivelit të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri.

4. Parimet bazë

Dias parime bazë dhe të përgjithshme do të drejtojnë legjislacionin dhe veprimet e metejshme në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut.

1. **Integrimi:** faktorët që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve duhet të integrohen me politika të tjera shtetërore, të tilla si: konkurrenca, tregu i brendshëm, siguria ushqimore, dhe shërbimet e interesit të përgjithshëm; si konkluzion – strategjia në mbrojtje të konsumatorit duhet të pranojë elemente të këtyre politikave të tjera, të tilla si, heqjen e barrierave të panevojshme në tregti dhe detyrimet e lidhura me nevojën për më tepër mbrojtje të mjedisit;

2. **Shumëllojshmëria e aktoreve:** ndërsa mbrojtja e konsumatorit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e strukturave publike shtetërore, roli i organizatave konsumatore jo-qeveritare duhet të promovohet dhe operatorëve ekonomikë duhet t'u kërkojë të luajnë një rol më aktiv në mbrojtje të konsumatorit dhe/ose të garantojnë sigurinë në treg;

3. **Koordinimi:** natyra e përhapur apo qëllimi i gjërë i kërkesave në mbrojtje të konsumatorit kërkon një koordinim të kujdesshëm i të gjitha iniciativave të ndermarra në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut;

4. **Koherenca dhe eficientia e kostove:** paketa e ligjeve dhe rregullave të cilat parashikojnë mbrojtjen e konsumatorit dhe kuadrin institucional në këtë fushë duhet të jenë sa më koherente; gjithashtu autoritetet përgjegjëse për politikë-bërjen në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të përcaktohen qartë dhe të menjaherë sa më shumë të jete e mundur mbivendosja e kompetencave;

5. **Proporcionaliteti:** masat e marra me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në treg duhet të jenë në përputhje me objektivat që duhet të arrihen; një rregull i tillë duhet të zbatohet për kontrollet në treg dhe kundravajtjet ndaj shkeljeve të dispozitave ligjore të mbrojtjes së konsumatorit;

6. **Qeverisja e mirë:** kërkon që veprimet politike dhe administrative përkundrejt mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut të ndermerren në mënyrë të pavarur, jo-diskriminuese, të paanshme dhe transparente.

5. Aktivitetet e Planifikuara

Strategjia parashikohet të mbulojë periudhën 2007-2013. Kjo periudhë do të jetë e njëjte me periudhën e Programit Europian për Konsumatorët të adoptuar së fundmi, nga e cila do të marrë eksperiencë edhe kjo strategji. Gjithashtu pritet që gjatë kësaj periudhe të firmoset dhe Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit midis BE-së dhe RSH-së.

Ne vitin 2013, te gjitha objektivat e listuara sipas pikes 3 duhet te jene realizuar. Ne veçanti, Shqipëria do te kete ne zbatim, ne konformitet te plote me EU Acquis, legjislacionin per mbrojtjen e konsumatoreve si dhe institucionet qe lidhen me te.

Midis te gjitha aktiviteteve te planifikuara, disa prej tyre janë më prioritare se te tjera, dhe disa te tjera mund te kerkojne masa paraprake. Jane identifikuar aktivitetet afat-shkurtra (5.1) dhe afat-gjata (5.2), te cilat do te zbatohen respektivisht per 4 vjet (2007 - 2010) dhe 3 vjet (2011 - 2013).

5.1 Prioritetet/Aktivitetet afat-shkurtra (2007-2010)

Dhjetë (10) aktivitete kryesore do te kontribuojne ne arritjen e objektiveve te Strategjise gjate fazes se pare.

5.1.1 Konsolidimi i bazes legjislative

a) Permiresimi i ligjit per mbrojtjen e konsumatoreve.

Ligji per mbrojtjen e konsumatoreve (Ligji nr 9135, date 11.9.2003) vendos disa pergjegjesi serioze per prodhuesin, shitesin dhe ofruesin e shërbimit. Keto pergjegjesi i perkasin mbrojtjes se te drejtave te konsumatorit ne pergjithësi (neni 5 i ligjit), siguria e produkteve dhe shërbimeve, etiketimi dhe dhenia e informacionit konsumatoreve dhe shume te tjera, mund te permbledhen si mbrojtje e interesave ekonomike te konsumatorit.

Sipas Ligjit per mbrojtjen e konsumatoreve, jane vendosur te drejtat baze te konsumatoreve dhe kuadri institucional per mbikëqyrjen e tregut.

Ligji per mbrojtjen e konsumatoreve dhe disa nene te Kodit Civil jane pjese te rendesishme te legjislacionit ne Shqipëri, te cilet mbulojne drejtperdrejte dhe ne menyre te plote çështjen e mbrojtjes se konsumatoreve. Nene specifike ne kodin civil jane ata qe i perkasin pergjegjesise se prodhuesit per defekte ne produktin e tij. Ligji shpall ekzistencen e te drejtave baze te konsumatorit, percakton te drejtat respektive dhe detyrimet e konsumatoreve dhe operatoreve ekonomik ne marrëdhëniet e tyre me tregun, vendos kuadrin ligjor per politikat ne mbrojtje te konsumatorit, thekson rendesine e organizatave jo-qeveritare qe perfaqesojne interesat e konsumatorit, percakton autoritetin qe do te jete kompetent per mbikëqyrjen e zbatimit te neneve te ligjit dhe jep sanksione ne rast shkelje te neneve te ketij ligji.

Ky ligj për kohen qe u hartua, paraqiti një hap te rëndësishëm ne përfrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian ne fushën e mbrojtjes se konsumatorit, perderisa çështjet e prekura ne ligj jane pjese e legjislacionit te BE-se ne kete fushë.

Ne kuadër te përfrimit te mëtejshëm me legjislacionin evropian, si detyrim qe rrjedh nga zbatimi i MSA (Neni 76), si dhe për te siguruar një zbatim sa me efektiv te këtij ligji, u ndërmor iniciativa ligjore për hartimin e një projektligji te ri.

Hartimi i këtij ligji te ri synon: se pari, ndarjen e aspekteve te mbrojtjes se konsumatoreve nga ato te sigurse se produkteve dhe mbikëqyrjes se tregut dhe se dyti, futjen ne legjislacion ose detajimin me tej te çështjeve te veçanta, te tilla si kredite konsumatore, paketat e udhëtimit etj te trajtuara ne direktivat evropiane te fushes se mbrojtjes se konsumatoreve.

Me specifikisht ne draft ligjin e ri do te trajtohen çështjet: siguria e pergjithshme e produktit dhe shërbimit (me referim ne ligjin horizontal *“Për sigurinë e pergjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit te produkteve joushqimore”*), marketingu i produkteve te cilat paraqiten ndryshe nga c’jane dhe demtojne shendetin apo sigurine e konsumatorit, informimi konsumatoreve, etiketimi i produktit, treguesit e çmimit, reklamata mashtruese, çorientuese dhe krahasese, uljet e cmimeve, shitjet jashte qendrave te biznesit, shitjet ne distance, shitjet elektronike, kushtet e padrejta ne kontrata, detyrimi per te dhene garancite, ofrimi i shërbimit te energjise, ujit dhe telekomunikacionit, kontratat turistike dhe kredite konsumatore. Disa prej ketyre çështjeve, te tilla si: shitjet jashte qendrave te biznesit dhe shitjet ne distance, marketingu dhe shitja ne distance e shërbimeve financiare, kontratat per paketat turistike dhe kredite konsumatore duhet te miratohen me Vendim te Keshillit te Ministrave per te detajuar te drejtat dhe detyrimet e paleve ne te tilla marrëdhënie.

b) Ligji per sigurine e pergjithshme te produktit, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit.

Ligji nr.9779, datë 16.7.2007 *“Per sigurine e pergjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit te produkteve jo-ushqimore”* i miratuar se fundmi, eshte nje pjese tjeter shume e rendesishme per mbrojtjen e konsumatoreve ne Shqipëri, perderisa prek çështjen prioritare te sigurse. Ky ligj harmonizon direktiven e vitit 2001 mbi sigurine e pergjithshme te produktit dhe disa prej

akteve te tjera komunitare ne lidhje me produktet qe mbulohen nga i quajture rregullim i “Perqasjes se Re”.

Ky akt eshte baza kryesore per veprim ligjor ne sferen e vleresimit te konformitetit dhe te mbikeqyrjes se tregut. Ai percakton kompetencat e strukturave dhe inspektoreve te mbikeqyrjes se tregut per te kryer monitorim, kontroll dhe inspektim si dhe te urdherojne apo te ndermarrin veprime kundrejt produkteve qe nuk jane ne perputhje.

c) Hartimi i legjislacionit per produktet ne sektore tevecante

Ligji per sigurine e pergjithshme te produktit, kerkesat thelbese dhe vleresimin e konformitetit do te lejoje qe cdo direktive e vecante e Perqasjes se Re (New Approach directive) te implementohet ne legjislacionin shqiptar ne formen e Vendimit te Keshillit te Ministrave.

Bazuar ne vleresimin e legjislacionit shqiptar nen asistencen teknike te Projektit CARDS 2003 dhe ne perputhje me Planin Kombetar te zbatimit te MSA, duhet te percaktohet rrada e akteve nenligjore per produktet te cilat do te adoptohen.

d) Permiresimi i legjislacionit qe lidhet me mbikeqyrjen e tregu

Per te siguruar funksionimin e mbikeqyrjes se tregut eshte e rendesishme qe legjislacioni i cili lidhet me mbikeqyrjen e tregut te amendohet, hartohet dhe pershtatet. Ky eshte rasti i standartizimit, akreditimit dhe metrologjise. Kjo pune me karakter ligjor do te rendise konceptet, detyrimet, mjetet dhe institucionet me parimet Europiane dhe praktiket me te mira te mbikeqyrjes se tregut.

5.1.2 Ngritja e nje sistemi institucional te pershtatshem

a) Krijimi i nje strukture te vetme per mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikeqyrjen e tregut

Ne qershor 2001, u krijua nje drejtori e vecante per te trajtuar ceshtjet e mbrojtjes se konsumatoreve, Drejtoria e Mbrojtjes se Konsumatorit. Ligji per Mbrojtjen e Konsumatoreve i vitit 2003 e percakton kete drejtori si strukturen kryesore pergjegjese per zhvillimin, organizimin, bashkerendimin e veprimtarive qe lidhen me mbrojtjen e konsumatoreve dhe mbikeqyrjen e tregut ne Shqiperi.

Si pjese e reformes se administrates publike, Ministria e Ekonomise dhe Ministria e Industrise dhe Energetikes u bashkuan ne Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energetikes (METE). Ne METE, si pjese e Drejtorise se Pergjithshme Rregullatore u krijua Drejtoria e Mbikeqyrjes se Tregut, e cila ka ne strukture te saj keta sektore te lidhur me ceshtjet e mbrojtjes se konsumatoreve dhe mbikeqyrjes se tregut:

- Sektori i Mbrojtjes se Konsumatorit;
- Sektori i Mbikeqyrjes dhe Koordinimit;
- Sektori i Standardeve dhe Rregullave Teknike

Ky ndryshim institucional ka nje impakt te rendesishem ne lidhje me rolin e strukture te ngarkuar per mbrojtjen e konsumatorit;

Bashkeveprimi midis mbrojtjes se konsumatorit dhe mbikeqyrjes se tregut konfirmohet qarte dhe eshte zgjeruar dimension i punes qe duhet bere, duke perfshire gjithashtu edhe kerkesat e reja per burime dhe trajnime;

Ne lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, sigurise se produktit dhe mbikeqyrjes se tregut, drejtorise i jane dhene kompetenca horizontale dhe roli koordinues me ministrine e linjes eshte me thelbesor.

Per nje theksim me te forte te bashkepunimit te ngushte ndermjet politikave se mbrojtjes se konsumatoreve dhe mbikeqyrjes se tregut, jepet rekomandimi per ndryshimin e emertimit te drejtorise nga - Drejtori e Mbikeqyrjes se Tregut ne - Drejtori te Mbrojtjes se Konsumatoreve dhe Mbikeqyrjes se Tregut (DMKMT)

b) Krijimi i nje strukture te vetme per mbikeqyrjen e aktiviteteve te mbrojtjes se konsumatorit dhe mbikeqyrjes se tregut

Nje nga prioritetet e kesaj Strategjise eshte zbatimi efektiv i ligjit per mbrojtjen e konsumatorit, ligjit per Sigurine e pergjithshme te produkteve, kerkesat thelbese dhe vleresimin e konformitetit dhe VKM – ve ne zbatim te tyre. Situata ne Shqiperi ne lidhje me zbatimin dhe implementimin e politikave, si dhe zbatimin i ligjeve ne praktike mbetet akoma ne nivel te ulet. Ndersa kontrolli, megjithese jo sistematik, per disa produkte zbatohet mire, por per sigurine e produkteve dhe mbrojtjen e konsumatoreve eshte akoma i ulet.

Dispozita te reja dhe me te detajuara jane futur ne keto dy ligje me qellim sigurimin e nje

zbatimi sa me efektive te ketyre ligjeve. Megjithate, eshte thelbësore qe aktivitetet e mbikëqyrjes se tregut te fuqizohen nga kendveshtrimi institucional. Ngritja e kapaciteteve dhe efica per aktivitetet e mbikëqyrjes se tregut kerkojne vendosjen e nje strukture te vetme. Kjo do te sjelle nje pajtuesmeri te plote me praktikat europiane dhe me nenin 6 te direktives per sigurine e pergjithshme te produktit te vitit 2001.

Ngritja e nje strukture te identifikuar qarte te mbikëqyrjes se tregut do te fuqizojë sistemin e mbikëqyrjes se tregut ne Shqiperi. Kjo do ta beje sistemin me koherent dhe me kosto efica. Pranimi i rolit te struktures mbikëqyrese sjell shmangien e konfliktit te kompetencave midis strukturave ekzistuese publike te mbikëqyrjes se tregut, te cilat veprojne ne fusha te ndryshme, si dhe do te siguroje qe, kontrolli i tregut te veproje ne sektoret ku strukturat mbikëqyrese mungojne. Ky eshte nje kusht paraprak thelbësor per koordinimin e aktiviteteve te mbikëqyrjes se tregut si brenda Shqiperise ashtu edhe me strukturat homologe te mbikëqyrjes se tregut ne vende te tjera.

Ligjet e pergatitura mbi mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut percaktojne nje njesi te tille te vetme: draft-ligjit per sigurine e produktit dhe draft-ligji per mbrojtjen e konsumatorit percaktojne Drejtorine e Mbikëqyrjes se Tregut nen Drejtorine e Pergjithshme Rregullatore ne METE.

Per sa me siper, kjo eshte dhena e nje kompetence te pergjithshme per te gjitha mallrat dhe sherbimet, te cilet perfishihen ne fushen e zbatimit te ligjit per sigurine e produkteve dhe ligjit per mbrojtjen e konsumatorit. Konkretisht: perfishihen produktet e konsumatoreve, produktet jo konsumatore ose industriale, produktet teknike ose te Përqasjes se Re, dhe gjithashtu mjetet dhe pajisjet e punes, por do te perjashtohen produktet farmaceutike dhe ushqimore.

c) Ngritja e Komitetit per zgjidhjen e ankesave te konsumatoreve

Ashtu sic u permend edhe me lart situata ne Shqiperi ne lidhje me zbatimin dhe implementimin e politikave, si dhe zbatimi i ligjeve ne praktike mbetet akoma ne nivel te ulet. Per permiresimin e nje suate te tille, si dhe per zgjidhjen sa me te shpejte dhe efektive te mosmarreveshjeve midis konsumatoreve dhe tregtareve rekomandohet ngritja e nje “Komiteti per Zgjidhjen e Ankesave te Konsumatorit”. Ky komitet do te trajtojë dhe zgjidh ankesat midis konsumatoreve dhe tregtareve, nese palet nuk kane qene te afta per te zgjidhur me marreveshje ankesat dhe vlere e mallit apo sherbimit te diskutuar do te kaloje masen e llogaritur ne monedhen shqiptare, shuma e se ciles do te percaktohet ne draft ligjin per mbrojtjen e konsumatoreve. Komiteti nuk do te merret me trajtimin e ceshtjeve qe kane sjelle si pasoje vdekjen, demtime fizike apo shendetesore. Mosmarreveshje te tilla do te jene objekt shqyrtimi ne gjykate. Njekohesisht, nuk do ti nenshtrohen procesit te shqyrtimit ankesat ne lidhje me siguracionet, transferimin e te drejtave te sendeve te paluajtshme, ose ankesat, zgjidhja e te cilave eshte e parashikuar ne ndonje akt te vecante.

“Komiteti per Zgjidhjen e Ankesave te Konsumatoreve” nen Ministrine qe mbulon tregtine dhe do te perbehet nga perfaqesues te METE-s (2 persona), MBUMK (1 person) dhe MSH (1 person) dhe tre njohes te mire te legjislacionit per mbrojtjen e konsumatorit, te pavarur. Sekretariati i Komitetit do t'i ngarkohet Drejtorise se Mbikëqyrjes se Tregut.

d) Ngritja e Keshillit Konsultativ per Konsumatoret.

Implementimi efektiv i politikës se mbrojtjes se konsumatorit dhe mbikëqyrjes se tregut kerkon qe iniciativat ligjore dhe aktivitetet ne kete fushe te jene te koordinuara ndermjet institucioneve shtetore, por gjithashtu kerkon dhe nje bashkëpunim te ngushte me grupet e interesit nga sektori privat.

Qeveria duhet te interesohet per perfshirjen e shoqerise civile ne hartimin dhe implementimin e politikës se konsumatorit dhe ne zhvillimin e bashkëpunimit midis shoqatave te konsumatorit. Pritet qe shoqatat e konsumatorit japin kontributin e tyre ne implementim e politikës se konsumatorit, bazuar ne kontaktet e tyre te drejtperdrejta me konsumatoret dhe ne njohurite e tyre per nevojat e konsumatoreve. Shoqatat e konsumatoreve jane gjithashtu dhe nje kanal shume i pershtatshem per te transmetuar tek konsumatoret informacionin mbi legjislacionin e ri, zhvillimet e reja ne treg dhe per edukimin e tyre ne lidhje me te drejtat dhe detyrimet e tyre.

Mbeshtetja e zhvillimit te shoqatave te konsumatoreve ne te gjithë vendin dhe bashkëpunimi i ngushte me to, qe duhet te shoqeroje procesin e politik-berjes, jane ndermjet rekomandimeve te BE-se, per qeverite e vendeve te cilat aplikojne per te hyre ne Bashkimin Evropian.

Autoritetet shqiptare kane konfirmuar vullnetin e tyre per te ndjekur dhe zbatuar keto rekomandime ne ligjin ekzistues “Per Mbrojtjen e Konsumatorit”. Kjo dëshmohet tek te drejtat e shoqatave te konsumatorit per shkembim informacioni me institucionet shtetore ne nivel qendror dhe

lokal, si dhe dhenien e opinionëve të tyre mbi projektligjet, rregulloret dhe çështje të tjera që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve.

Ne kuadrin institucional aktual, Keshilli Bashkerëndues për Mbrojtjen e Konsumatorëve është ngritur në zbatim të urdherit të Kryeministrit Nr. 75, datë 17.03.2004 “Mbi miratimin e perberjes së ‘‘Keshilli koordinues për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut’’. Keshilli perbehet nga 17 anetare, të cilët janë përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera administrative, shoqatave të konsumatorëve shqiptarë dhe organizata biznesi të ndryshme. Ministri përgjegjës për tregtine kryeson Keshillin. Presidenti i Shoqatës së konsumatorëve shqiptarë emrohet nga ligji si zv/kryetar i Keshilli Bashkerëndues.

Procesi i konsultimit me grupet e interesit përfshirë shoqatat e pavarura të konsumatorit duhet të çohet dhe me tej. Rekomandohet që ky keshill të ketë me tëper karakter konsultativ në kuptimin e një pjesëmarrje dominuese nga shoqatat e konsumatorëve, organizatat e biznesit dhe shoqëria civile. Keshilli do të drejtohet nga Ministri përgjegjës për fushën e tregtisë ose një person i deleguar prej tij, dhe nga dy nënkryetarë, respektivisht nga shoqatat e konsumatorëve dhe fusha e biznesit. Sekretariati i Keshillit do t’i ngarkohet Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut.

Duhet të jetë një detyrim për strukturat administrative dhe qeverinë, që të paraqesë për konsultim në Keshillin Konsultativ të Konsumatorit, politikat dhe strategjitë kombëtare në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut si dhe projektet e ligjeve dhe akteve nënligjore, të cilat lidhen me politikën e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut.

Është gjithashtu e rëndësishme të nënvizohet fakti që Keshilli i jepet e drejta të vendosë për përgatitjen me iniciativën e tij të studimeve, raporteve ose dhenien e opinionëve për çdo çështje që lidhet me mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut.

Projektligji i propozuar për Mbrojtjen e Konsumatorëve, siguron ngritjen e këtij organizmi të ri në kuadrin institucional për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut në Shqipëri.

e) Organizimi i sistemit institucional rajonal

Administrata shtetërore duhet të vendosë mbi infrastrukturën e mbikëqyrjes së tregut (p.sh. shpërndarjen funksionale dhe/ose gjeografike të përgjegjësive), por duhet të sigurohet që mbikëqyrja të jetë efiçente dhe të mbulojë gjithë territorin.

f) Investimi në rritjen e kapaciteteve

Ngritja e një kuadri institucional për hartimin dhe implementimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut nënkupton dhenien e burimeve sinjifikative për Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të reja që do të rrjedhin nga aplikimi i ligjeve të reja si dhe nga implementimi i kësaj Strategjie.

Burimet e nevojshme do të jenë si njerezore ashtu dhe financiare:

1. Rritja e kapaciteteve administrative në sektorin e mbrojtjes së konsumatorëve, sektorin e mbikëqyrjes dhe koordinimit, si dhe në sektorin e rregullave teknike: nga 8 punonjës aktualisht, në 15 punonjës; Kjo rritje justifikohet me numrin e madh të detyrimeve të reja shtese për të realizuar në kuadër të kësaj Strategjie dhe legjisllacionit të ri të adoptuar. Nder me kryesoret përmendim:

- ndjekja e zhvillimeve legjisllative të BE-së;
- transpozimi i akteve komunitare të BE (EU acquis) në ligjin shqiptar;
- konsolidimi i bazës ligjore kombëtare për veprim;
- përgatitja e legjisllacionit sektorial të produkteve;
- menaxhimi i sistemit të trajtimit të ankesave të konsumatorit kombëtar, Sekretariat i Komitetit për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorit;
- Sekretariati i Keshillit Konsultativ;
- bashkëpunimi me OJF-të (përfshirë procesin e tenderimit për mbështetjen financiare të tyre),
- menaxhimi i shkëmbimit të sistemeve të informacionit;
- zhvillimi i aktiviteteve proaktive të mbikëqyrjes së tregut (informimi, trajnimi, fushata publike etj.);
- forcimi i bashkëpunimit me struktura të tjera shtetërore;
- rritje sinjifikative e fushës së aktiviteteve të mbikëqyrjes;
- zhvillimi i bashkëpunimit administrativ rajonal dhe ndërkombëtar;
- bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me strukturën e mbikëqyrjes së tregut nën

METE;

- koordinimi i politikave dhe aktiviteteve me institucionet e infrastruktures se cilesise.

5.1.3 Vendosja e nje sistemi funksional te mbikëqyrjes se tregut

Ne Shqiperi, strukturat, mjetet dhe instrumentat e mbikëqyrjes se tregut, duhet te ngrihen dhe te behen te funksionale ne përputhje me parimet dhe praktiket e BE-se.

Eshte pergatitur paraprakisht nje draft-model, i cili sugjeron kuadrin dhe udhezimet per krijimin gradual te nje sistemi te tille te Mbikëqyrjes se Tregut ne Shqiperi (shiko Aneksin 1). Ai perfshin pune te rendesishme ne drejtim te legjislacionit, reforma institucionale si dhe rritje kapacitetesh. Kontrolli para hedhjes ne treg dhe ai pas hedhjes ne treg duhet te jene subjekt i nje perqasje te re.

Perpara se produkti te vendoset ne treg, ka struktura te ndryshme te perfshira me qellimin e garantimit te sigurise dhe cilesise se produktit ne treg. Keto jane struktura shtetore ose private. Megjithese ka patur disa arritje, per shembull ne lidhje me metrologjine dhe standartizimin, mbetet akoma shume per te bere. Nje tjeter prioritet eshte zhvillimi i procedurave te pershtatshme te vleresimit te konformitetit dhe sistemit te akreditimit. Ka shume pak, per te mos thene asnje, organe te vleresimit te konformitetit te autorizuar per te operuar si pale e trete e pavarur ne procesin e vleresimit te konformitetit ne vend. Struktura te tilla testimi dhe çertifikimi (te quajtura ne BE organe te notifikuara) jane vendimtare per funksionimin e duhur te fazes para-hedhjes ne treg te produktit.

Ne menyre intensive duhet te kerkohen projekte dypalëshe dhe te BE-se per asistence teknike, per te mbeshtetur zbatimin progresive te praktikave te mira, efektive dhe te pershtatshme te Mbikëqyrjes se Tregut, ne Shqiperi.

Gjate fazes se pare te zbatimit te kesaj Strategjie, draft modeli i propozuar i per Shqiperine duhet te kompletohet dhe te detajohet, si dhe jane te nevojshme te ndërmerren hapat e para ne reformat legjislative dhe institucionale. Kohezgjatja e implementimit te draftit te sistemit te Mbikëqyrjes se Tregut vlerësohet te jete nga 5 deri 8 vjet, duke u përputhur keshtu plotesisht me implementimin e kesaj Strategjie, por sigurisht varet nga burimet e mundshme njerezore, financiare dhe teknike te disponueshme.

5.1.4 Trajnimi i te gjithë aktoreve mbi çështjet e mbrojtjes se konsumatorit dhe mbikëqyrjes se tregut

Nevojat per trajnime jane te konsiderueshme dhe ato duhet te drejtohen tek te gjithë aktoret e perfshire ose qe ka mundesi te perfshihen ne zhvillimin e mbrojtjes se konsumatorit dhe mbikëqyrjes se tregut ne Shqiperi: DMT, ministrite e linjes, strukturat e mbikëqyrjes se tregut, shoqatat e biznesit, organizatat e konsumatorit, gjyqtaret dhe akademiket.

Duhet pergatitur nje plan trajnimesh dhe seancat e para te trajnimit duhet te organizohen gjate fazes se pare te implementimit te kësaj Strategjie.

Lista treguese e çështjeve prioritare:

- Aftesite e zhvillimit te Strategjise;
- Mjetet e vleresimit te ndikimit;
- Ligji dhe Strategjia e mbrojtjes se konsumatorit ne Shqiperi dhe BE;
- Sistemet, strategjite dhe praktiket e Mbikëqyrjes se Tregut ne Shqiperi dhe BE;
- Kapacitetet menaxhuese;
- Aftesite e komunikimit dhe te mbrojtjes;
- Proçedurat e koordinimit;
- Proçedurat e tenderimit;
- Trajtimi i ankesave te konsumatoreve;
- Instrumentet e Mbikëqyrjes se Tregut
- Metodatat dhe procedurat e vleresimit te konformitetit;
- Metodatat dhe mjetet e analizes se rrezikut;
- Marka dhe çertifikimi i produktit;
- Sanksionet administrative dhe procedurat e ndreqjes;
- Bashkepunimi me OJF-te;
- Bashkepunimi me gjyqësorin.

5.1.5 Zhvillimi i sistemit te informacionit

a) Per produktet e pasigurta: ngritja e nje sistemi kombetar te dhenash mbi risqet dhe aksidentet e lidhura me produktin.

Ne menyre qe behet nje vleresim i sakte i rreziqeve te lidhura me produktin, Shqiperia duhet te zhvilloje nje baze te dhenash, qe do te mbledhe informacionin e marre mbi produktet e pasigurta qe qarkullojne ne treg dhe aksidentet e lidhura me to. Domethene, sistemi do te jete ne ndihme te struktures se mbikëqyrjes se tregut kur kjo e fundit duhet te marre vendime ne raste te situatave emergjente, psh. kur rreziku eshte aq serioz sa kerkon veprim te menjehershëm.

Sistemi do te perfshije identifikimin e burimeve te informacionit (strukturat rajonale te inspektimit, organizatat e konsumatorit, operatorët ekonomike), ngritjen e nje rrjeti komunikimi, instalimin e software-ve te duhura, hartimin e formateve raportuese dhe stafin menaxhues te caktuar per sistemin.

Lidhja me Sistemin e Shkembimi te Shpejte te Informacionit per Produktet e Rrezikshme te BE- se (RAPEX), do te jete nje nga arritjet e ketij aktiviteti dhe prandaj sistemi duhet te krijohet sipas specifikimeve te RAPEX - it.

Ne periudhen afatshkurter pritet qe te behet nje vleresim per specifikimet e nevojshme per krijimin e nje baze te informatizuar te dhenash ne Shqiperi, mbi rreziqet dhe aksidentet ne lidhje me produktin, dhe qe ky system te jete funksional ne Tirane.

b) Per ankesat e konsumatoreve: ngritja e nje sistemi kombetar per trajtimin e ankesave te konsumatorit.

Do te behet funksional nje sistem kombetar per trajtimin e ankesave te konsumatorit. Ky sistem do te ndihmoje konsumatorët qe te zgjidhin ankesat e tyre ne nje menyre me te thjeshte, me te shpejte dhe me me pak shpenzime sesa ne Gjyrate. Gjithashtu do te ndihmoje ne lehtesimin e vellimit te punes per gjykatesit.

Perfitime te tjera direkte jane rritja e besimit te konsumatorit ne sistemin mbrojtës te vendosur dhe njohuri me te mira te autoriteteve te zhvillimit te strategjise per pakenaqesite e konsumatoreve, dhe pritjet e tyre, per rrjedhim, pergjegjesi me e madhe e struktures se mbrojtjes se konsumatorit ndaj nevojave per veprim ose reforme.

Ngritja e nje sistemi te tille do te kerkoje gjithashtu software, pajisje, mjete komunikimi, hartimin e formateve model dhe kapacitetet menaxhuese specifike.

Ne periudhen afatshkurter, pritet qe sistemi te jete funksional ne Tirane.

5.1.6 Ngritja e nje rrjeti kombetar te qendrave te keshillimit per konsumatorët

Informimi i konsumatorit dhe keshillimi i konsumatorit jane elemente thelbësore te mbrojtjes se konsumatoreve dhe strategjise per mbrojtjen e konsumatoreve. Vetem nje konsumator i mireinformuar mund te mbaje nje qendrim kritik ndaj shumellojshmerise jo-transparente te produkteve dhe sherbimeve ne treg dhe mund te beje nje zgjedhje te informuar duke kontribuar ne kete menyre per permiresimin e cilesise se produkteve dhe sherbimeve.

Informimi dhe keshillimi qe i jepet konsumatorit duhet te jete i pavarur, i besueshem, i sakte, dhe i decentralizuar ne menyre qe te sigurohet arritje. Fushat e temave te keshillimit perfshijne te gjitha çështjet e konsumatorit, psh: keshillim ligjor dhe trajtim te ankesave te konsumatoreve, siguria dhe cilesia e produkteve dhe sherbimeve, artikuj ushqimore dhe ushqime, sherbime bankare dhe financiare, sigurimet, strehimin, eficiencen e energjise, etj. Sherbimet keshilluese mund te realizohen ne formen e keshillimit personal ne nje zyre keshillimi, ose nepermjet perdorimit te linjave telefonike, ose gjithnje e me shume dhe si sherbime online.

Parashikohet qe DMT te marre nje rol drejtues dhe mbikeqyres ne zhvillimin e nje rrjeti qendrash keshillimi per konsumatorët, ne bashkepunim te plote me bashkite dhe shoqatat e konsumatoreve.

Pjesemarrja e bashkive siguron organizimin vendor te sistemit, per rrjedhim secili konsumator mund te kete njohuri me te mira dhe me shume mundesi perdorimi. Bashkite mund te sigurojne zyra dhe forma te tjera mbeshtetjeje per Qendrat e Keshillimit per konsumatorët te ngritura ne bashkepunim me OJF-te. Duke qene se sherbimet e keshillimit te konsumatoreve jane pjese e qellimit te sherbimeve qe qeverite vendore/bashkite mendohet ti sigurojne qytetareve te tyre, atehere qeverite locale /bashkite supozohet qe te marrin pjese ne financimin e ketyre sherbimeve bashke me qeverine qendrore.

Ligji per mbrojtjen e konsumatorit (Neni 54.1, pika b) parashikon te drejten e shoqatave te konsumatorit te organizoje dhe te menaxhoje qendra udhezimi dhe keshillimi per konsumatorin. Ne menyre qe te permbushin detyrat e tyre informuese dhe keshillimore, organizatat e konsumatorit duhet te jene te pajisura me mjetet dhe stafin e duhur, dhe stafi i tyre duhet te trajnohet sistematikisht. Ne

kete kuptim, ato duhet te mbeshteten nga nje nivel i duhur i fondeve publike.

Aktualisht, shoqatat e konsumatorit sapo kane filluar te ngrene qendra te tilla keshillimi, me asistencen teknike dhe financiare te organizatave te konsumatorit te BE-se.

Qendra e pare e informimit dhe keshillimit te konsumatorit e Shoqates e Konsumatorit Shqiptar u ndertua me asistencen teknike te Qeverise Gjermane dhe u perurua me 15 Mars 2005 ne Tirane. Kjo qender siguron keshillim, informim, konsultim ne fusha te ndryshme, si financiare, strehim, ushqim, sherbime shendetesore, konsumi i energjise, etj.

Ne parim, qendra te tilla te informimit dhe keshillimit te konsumatorit, duhet te ngrihen ne cdo 12 prefekturat e Shqiperise, duke funksionuar si nje rrjet i menaxhuar nga shoqatat e konsumatorit me qellim qe te sigurohen te njejtat standarte cilesore per keshillimin dhe informimin e konsumatoreve net e gjithe vendin.

Duke qene se per ngritjen dhe venien ne pune te qendrave te keshillimit te konsumatorit, jane te nevojshme mjete financiare ne shuma relativisht te medha, synimi per ngritjen e qendrave te tilla do te realizohet ne menyre graduale.

Pervec qendres ne Tirane, gjate fazes se pare te implementimit te Strategjise, jane parashikuar te ngrihen edhe tre qendra te tjera keshillimi. Keto qendra jane parashikuar per prefekturat e Korçes, Fierit dhe Shkodres.

Gjate procesit te përzgjedhjes se vendit ku do te ngrihet qendra, nje rol mjaft te rendesishem luan gadishmeria e qeverise vendore per bashkefinancimin e kosos se qendres. Kriteret dhe procedurat per ngritjen dhe zhvillimin e aktivitetit te qendrave te keshillimit do te percaktohen me specifikisht me ane te nje vendimi te METE. Gjate periudhes se implementimit te kesaj Strategjie, zhvillimi i nje rrjeti kombetar qendrash keshillimi per konsumatorin ne Shqiperi ne perputhje me standartet e BE-se, do te kerkoje mbeshtetje me asistenc teknike te siguruar ne kuader te programeve dypalëshe dhe ato evropiane.

5.1.7 Zhvillimi i fushatave ndergjegjesuese dhe i programeve te edukimit ne çeshtjet e konsumatorit

Edukimi i konsumatorit, si nje pjese integrale e mbrojtjes se konsumatorit, eshte dhene ne rezolutat e Kombeve te Bashkuara dhe udhezimet e BE-se si nje e drejte baze e konsumatoreve per te fituar njohurit dhe aftesite e nevojshme per vepruar ne treg nje nje menyre te informuar dhe efikase. Edukimi i konsumatorit, eshte ne te njejten kohe nje element i rendesishem per zhvillimin e vetedijes demokratike dhe te shoqerise civile. Te dy keto aspekte te edukimit te konsumatorit jane te nje rendesie te madhe vecanerisht per vende ne tranzicion si Shqiperia.

Edukimi i konsumatorit orientohet drejt edukimit te femijeve, adoleshenteve dhe te rriturve ne pozicionin e tyre si konsumatore. Ai krijon karakterin emocional dhe njohes, i cili eshte thelbësor per perdorimin eficient te informacionit te konsumatorit dhe keshillimit te konsumatorit. Gjithashtu, ai ndihmon ne ndryshimin e qendrimeve, orientimeve te vleresimit dhe sjelljes ne menyre qe ti beje konsumatorin me te ndergjegjshem per te drejtat e tyre, por edhe per pergjegjesine e tyre sociale.

Eksperienca ne shtetet anetare te BE-se tregon se edukimi i konsumatorit zbatohet nepermjet programeve mesimore shkollore (kurrikula) si pjese e edukimit te pergjithshem. Si nje çeshtje qe nderthuret ne programet mesimore, ai pershtatet ne lendet si ekonomi, shkenca politike, edukim qytetar etj. Gjithnje e me shume edukimi lidhet me çeshtje te zhvillimit mbeshtetes, dhe pergjegjesine individuale drejt mbrojtjes se mjedisit dhe burimeve natyrale.

Edukimi i konsumatorit ne Shqiperi eshte perfshire si nje teme e detyrueshme ne kurrikulat per klasat 10-11 te shkolles se mesme, me qellimin kryesor per te pajisur nxenesit me informacion mbi legjislacionin per konsumatorin dhe te drejtat e konsumatorit.

Pritet:

- Futja e çeshtjeve te edukimit te konsumatorit ne lende te ndryshme si ekonomi, shkenca politike, biologji, gjeografi, etj;

- Dhenia e prioritetit ndaj grupeve te femijeve te kopshteve dhe nxenesve te shkollave fillore;

- Ndergjegjesimi me i mire ndaj temave te tilla si: vlera e parase, deshirat dhe stimujt per te konsumuar, praktikat e kredise dhe marketingut, roli i reklamave, kontratat, rreziku qe vjen nga mbi-borxhet, vleresimi i rreziqeve ne lidhje me produktin, siguria e lodrave, aspektet shendetesore dhe ekologjike e ujit te pijshem, faturat, treguesi i cmimeve, etiketimi i produktit, kursimi i energjise, ndikimi i konsumit ne ambient, etj.

- Trajnimi i mesuesve me qellim kualifikimi; te zhvillohen kurrikulat dhe te perpunohen

materialet mesimore dhe udhezime te reja metodologjike

Me qellim permbushjen e ketyre detyrave, DMT do te vendose nje bashkepunim te ngushte me shoqatat e konsumatoreve dhe me Ministrine e Arsimit dhe institucione te ngarkuara me zhvillimin e kurrikulave dhe trajnimit e mesuesve.

Perfshirja e edukimit te konsumatorit ne shkollat shqiptare eshte nje process afatgjate dhe kerkon, te pakten si fillim, ndihme nga vende me eksperience ne edukimin e konsumatorit. Asistenca teknike per zhvillimin dhe implementimin e edukimit te konsumatorit ne Shqiperi duhet te perfshihet ne programet dypalëshe dhe ato te BE-se.

Gjithashtu, DMT do te zhvilloje dhe mbeshtese format e edukimit te konsumatoreve jashte shkollave. Kjo do te perfshije nje sere aktivitetesh, midis te cilave permendim:

- Fushatat publike mbi te drejtat e mbrojtjes se konsumatorit ne pergjithesi, ose per çeshtje te veçanta te menduara si prioritare (psh. siguria e produkteve, kredia konsumatore);

- Publikimi i materialeve dhe librave edukues;

- Shperndarja e fletëpalosjeve;

- Seminare dhe programe trajnimi te trajnereve.

5.1.8 Dhenia e mbeshtetjes financiare per shoqatat e konsumatoreve

Shoqatat e pavarura te konsumatoreve luajne rol kryesor ne permiresimin e mbrojtjes se konsumatoreve dhe berjen efektive te mbikëqyrjes se tregut. Sic u theksua, Ligji per e Mbrojtjen e Konsumatoreve percakton se pergjegjesine kryesore ne fushen e mbrojtjes se konsumatoreve e ka shteti dhe njekohesisht garanton te drejtat dhe detyimet shoqatave te konsumatorit (Neni 54 i ligjit te propozuar).

Nevoja per perfshirjen e duhur te shoqatave te konsumatorit ne hartimin e politikës se konsumatorit eshte nje element kryesor ne te gjitha programet e veprimit per konsumatorin ne BE. Kjo nevojë eshte akoma me e ndjeshme ne vendet ne zhvillim, ku shoqatat e pavarura te konsumatorit nuk kane kryer rolin e tyre si pasoje e mungeses se burimeve dhe stafit profesional.

Shoqatat e konsumatorit jane partner te rendesishem ne mbikëqyrjen e tregut: identifikojne ankesat, percjellin ankesat ne organet administrative, mbeshtesin iniciativat administrative, pjesemarrjen ne fushatat e informimit, pergatitjen e fletëpalosjeve dhe materialeve edukuese etj.

Roli i tyre eshte i rendesishem ne hartimin, zhvillimin dhe kryerjen e aktiviteteve per edukimin e konsumatoreve, informimin e konsumatoreve dhe keshillimin, perfaqesimin e konsumatoreve, marrjen e ankesave ne menyre joformale dhe kryerjen e veprimeve ligjore ne emer te interesave te perbashketa te konsumatoreve.

Ligji i propozuar i Mbrojtjes se Konsumatoreve forcon rolin e shoqatave te konsumatoreve ne disa menyra:

- Percakton detyrimin e shtetit per ti dhene mbeshtetje financiare shoqatave te konsumatoreve nepermjet subvencioneve te shperndara pas procesit te tenderimit. (Art.54);

- E ben perfaqesimin e konsumatoreve me efektiv nepermjet ngritjes se Keshillit Konsultativ te Konsumatoreve (Art.52);

- Grupeve te konsumatoreve u jepet e drejta te kerkojne vendime gjyqesore kundrejt çdo veprimi apo praktike ne kundërshtim me ligjin dhe qe demton interesat kolektive te konsumatoreve (Art. 58).

Por, ne lidhje me financimin, aktualisht shoqatat nuk mbeshteten financiarisht nga shteti.. Nevojitet nje angazhim me i qarte nga ana e qeverise dhe bashkive per te dhene mbeshtetje financiare organizatave te konsumatorit, me qellim kryerjen e detyrave te tyre. Duhet te mbeshtese gjithashtu edhe forcimin e kapaciteteve te organizatave te konsumatoreve ne kuader te bashkepunimit nderkombetar, te programeve te ndihmes teknike dypalëshe dhe ato te BE-se. DMT duhet te ndermarre disa hapa dhe te hartojë harmonogramat, kushtet, pergjegjesite etj. Psh: grantet qeveritare vlejne si nje ndihme.

Pritet qe buxheti i METE te konfirmoje shperndarjen e perqindjes se duhur ose sasine e fondeve per perfaqesuesit ee shoqatave te konsumatoreve dhe brenda 4 viteve te ardhshme duhet te behen tendera qe ti krijojne mundesine shoqatave te konsumatoreve te kontribojne ne zbatimin e kësaj Strategjie.

5.1.9 Zhvillimi i sistemeve alternative per zgjidhjen e mosmarreveshjeve

DMT duhet ti kushtojë vemendje te veçante instrumentave, skemave dhe procedurave te demshperblimit (kompesimit) te konsumatoreve. Konsumatorët ne Shqiperi aktualisht e kane shume

veshtire te konstatojne zbatimin e te drejtave te tyre. Konsumatorët kane njohuri te pakta per te drejtat e tyre (sigurine, cilesine, shendetin, garancite) dhe strukturat publike per promovimin e ceshtjeve te mbrojtjes se konsumatorit kane qene te kufizuara.

Konsumatorët duhet ti drejtohen sistemit gjyqesor per te ngritur ankesat qe kane. Por per arsye te ndryshme kjo gje nuk po ndodh. Ndaj sugjerohet zhvillimi i nje sistemi per menytrat alterenative te zgjidhjes se mosmarrevshjeve per ankesat e konsumatoreve.

Brenda kater viteve te ardhshem, DMT do analizoje dhe krahasoje skemat per zgjidhjet alternative te mosmarrevshjeve qe zbatohen nga vendet anetare te BE-se, per te vleresuar mundesine e aplikimit te tyre ne Shqiperi. Vemendje e vecante do ti kushtohet sistemeve qe zbatohen ne Rumani dhe Bullgari.

5.1.10 Bashkepunimi rajonal dhe nderkombetar

Statusi aktual i Shqiperise ne marredheniet e saj drejt Bashkimit European nuk mundeson hyrjen e Shqiperise ne proceset formale te keshillimit te percaktimit dhe zbatimit te politikës Evropiane te konsumatorit dhe programet shumevjevare te veprimit.

Megjithate, zhvillimet e politikës dhe legjislacionit per konsumatorët ne BE influencojne ne mbrojtjen e konsumatoreve ne Shqiperi. Ndaj, jane me shume vlere kontaktet e shpeshta dhe te rregullta dhe projektet e bashkepunimit te strukturave qeveritare ose me organizmat e BE-se si nje mundesi e mbajtjes se kontakteve per zhvillimet e fundit ne nivel Evropian. Mjetet e informacionit (psh faqet e internetit, gazetate) e Komisionit European jane nje tjetër mundesi.

DMT dhe strukturat e mbikëqyrjes se tregut duhet te punojne ne menyre te drejteperdrejte me palet dhe strukturat perkatese, dhe kur eshte e mundur mbi bazen antaresie. Antaresime te tilla duhet te krijojne mundesine per pjesemarrje ne aktivitetet nderkombetare, shkembimin e eksperiences dhe pjesemarrjen ne trajnime.

Gjitashtu, eshte e rendesishme mbeshtetja e bashkepunimit dhe antaresimit te perfaqesuesve te shoqatave te konsumatorit ne strukturat Evropiane dhe nderkombetare (BEUC, ANEC, Consumers International, etc.).

Shqiperia eshte ne fazat e para te zhvillimit te sistemit te mbrojtjes se konsumatoreve dhe politikave te konsumatorit. Institucionet qeveritare ashtu dhe organizatat e konsumatorit do kene nevojën e ndihmes teknike Evropiane dhe nderkombetareve per ngritjen e kapaciteteve te tyre ne mbrojtjen e konsumatoreve dhe mbikëqyrjen e tregut.

Vleresimi i nevojave ne fushen e mbrojtjes se konsumatoreve, sikurse dhe perfshirja e kesaj fushe ne programet e ndihmes teknike per Shqiperine eshte nje prioritet.

Per kete qellim:

1. Vleresimi i nevojës afatgjate per ndihme teknike per ngritjen e kapaciteteve institucionale te qeverise dhe dhe institucioneve jo-qeveritare duhet realizuar perpara fundit te vitit 2008;

2. Zbatimi i Strategjise do shoqerohet me ndihme teknike afatshkurter per disa ceshtje, si:

- a) Legjislacioni i mbrojtjes se konsumatorit
- b) Keshillimi per konsumatorët
- c) Trajtimi i ankesave te konsumatoreve
- d) Edukimi i konsumatoreve

3. Gjate periudhes se zbatimit te Strategjise, projektet e reja do te kene si synim mbeshtetjen zhvillimit te metejshe me mbrojtjes se konsumatoreve permes:

- a) Marrevshjeve dypaleshe
- b) Programi CARDS 2006

c) Propozimet per binjakezime te DMT (METE) me ministritë qe mbulojne problemet e konsumatoreve nepermjet mjeteve te Delegacionit Evropian.

5.2 Aktivitet afat-gjata (2011-2013)

5.2.1 Objektivat

Sic u theksua dhe me lart, objektivat e pergjithshme te kesaj Strategjie jane garantimi i nje niveli te larte te mbrojtjes se konsumatoreve ne treg si dhe ngritja ne vend e nje sistemi te mbikëqyrjes se tregut funksional dhe eficient.

Gjate fazes se pare te zbatimit te Strategjise nga 2007 deri ne 2010, iniciativat jane ndermarre me qellim:

- Perafrimin e ligjit te mbrojtjes se konsumatoreve me legjislacionin e BE-se (shih 5.1.1.);
- Hartimin e nje legjislacioni te ri per sigurine e produkteve, vleresimin e konformitetit dhe

mbikqyrjen e tregut ne Shqiperi (shih 5.1.1.);

- Krijimin e nje kuadri ligjor per mbrojtjen e konsumatoreve dhe politiken e mbikqyrjes se tregut ne Shqiperi (shih 5.1.2.);

- Sigurimin e pjesemarrjes se perfaqesuesve te organizatave jofitimpruese te konsumatoreve dhe grupeve te tjera te interesit ne procesin e vendimarrjes per fushen e mbrojtjes se konsumatoreve dhe mbikeqyrjes se tregut (shih 5.1.2.);

- Percaktimin e nje strategjie te plote te mbikeqyrjes se tregut dhe ngritjen e nje sistemi funksional e eficient te mbikqyrjes se tregut ne vend (shih 5.1.3.);

- Fillimin e procesit te trajnimit te te gjithë aktoreve per ceshtjet e mbrojtjes se konsumatoreve dhe mbikqyrjes se tregut, me qellim rritjen e kapaciteteve te strukturave politikeberese dhe inspektoreve, rritjen e informimit te konsumatoreve, ne lidhje me te drejtat dhe detyrimet e tyre dhe ndergjegjesimin e operatoreve ekonomike ne lidhje me pergjegjesite e tyre sociale kundrejt konsumatoreve (shih 5.1.4.)

- Shtimin e informacionit te mbledhur per pasigurine e produkteve dhe ankesat e konsumatoreve (shih 5.1.5.)

- Zhvillimin e sherbimit te keshillimit te konsumatoreve (shih 5.1.6.)

- Shtimin e programeve te edukimit te konsumatorit ne shkolla dhe informimin e konsumatoreve rreth te drejtave te tyre (shih 5.1.7.)

- Mundesimin e mbeshtetjes financiare per shoqatat e konsumatoreve (shih 5.1.8.)

- Vendosjen e bazave te bashkepunimit nderkombetar (shih 5.1.9.).

Ne vitin 2013, te gjitha objektivat e permenduara me lart duhet te jene arritur. Ne menyre te vecante, Shqiperia duhet te kete legjislacionin per konsumatorin dhe mbikqyrjen e tregut, si dhe te kete te ngritura institucionet perkatese, ne përputhje te plote me legjislacionin e BE-se.

5.2.2 Vleresimi afatmesem

Nga mesi i 2010, Qeveria Shqiptare do te hartojë nje raport per te vleresuar situaten e mbrojtjes se konsumatoreve dhe mbikqyrjes se tregut ne vend.

Raporti do te permbaje:

- Vleresimin e arritjeve pergjate fazes se pare te zbatimit te kesaj Strategjie Kombetare;

- Perditesimin e nevojave legjislative dhe institucionale per harmonizimin plotesisht te politikave te mbrojtjes se konsumatoreve dhe praktikave te mbikqyrjes se tregut me legjislacionin e BE-se, deri ne 2013;

- Propozimin dhe plotesimin e listes se aktiviteteve qe duhet te realizohen pergjate fazes se dyte te zbatimit te Strategjise.

5.2.3 Aktivitet e planifikuara

Raporti i vleresimit i perfunduar ne 2010 do propozojë nje axhende te detajuar per fazen e dyte te implementimit te kesaj Strategjie.

Te gjitha aktivitetet e filluara ne 2007 duhet te jene te perfunduara. Konkretisht:

- Perditesimi i legjislacionit te mbrojtjes se konsumatoreve dhe mbikeqyrjes se tregut;

- Adoptimi i direktivave te BE-se qe nuk jane perfshire ende ne legjislacionin Shqiptar (psh direktiva e re per kredine e konsumatorit);

- Adoptimi i ligjeve per produktet teknike (New Approach) qe nuk jane ende pjese e legjislacionit shqiptar.

- Arritja e perputhshmerise se plote me legjislacionin e BE-se dhe praktikat me te mira Europiane ne fushen e mbrojtjes se konsumatoreve dhe mbikqyrjes se tregut.

- Institucionet dhe procedurat e mbikqyrjes se tregut ne funksionim.

- Instrumentat e mbikqyrjes se tregut (vleresimi i konformitetit, vleresimi i rreziqeve, vendosja e markes CE, etj) realisht te disponueshme.

- Shtrirjen e iniciative tashme te ndermarra me qellim:

- Edukimin e konsumatoreve;

- Ngritjen e rrjetit te qendrave te keshillimit te konsumatoreve;

- Dhe ngritjen e nje sistemi per zgjidhjen e mosmarrveshjeve

- Perfshirja e elementeve te politikës se konsumatorëve ne politikat e fushave te tjera si psh mbrojtja e mjedisit (nxitja e prodhimit te qendrueshem dhe menyres se konsumit), siguria ushqimore dhe sherbimet e interesit te pergjithshem (psh furnizimi me uje te pijshem, energji elektrike, telekomunikacion, transport publik).

- Qenia e Shqiperise nje pale aktive ne institucionet Europiane dhe nderkombetare te mbrojtjes se konsumatoreve: Sistemi i Shkembimi te Shpejte te Informacionit per Produktet e Rrezikshme per produktet jo-ushqimore te konsumatoreve (RAPEX), Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit per Mbikqyrjen e Tregut (ICSMS), Qendra e Administrimit te Burimeve te Informacionit dhe Komunikimit (CIRCA), Grupi i Bashkëpunimit Administrativ AdCos, etj.

ANEKS 1: DRAFT MODELI I MBIQEYRJES SE TREGUT PER PRODUKTET INDUSTRIALE

I. PARATHENIE

Mbikqyrja e Tregut (me tej MT) është detyre per strukturat e vendit te cilat duhet te kontrollojnë nëse produktet e vendosura në treg janë në përputhje me legjislacionin. Mbikqyrja efektive e tregut siguron nje nivel të barasvlershëm mbrojtjeje për konsumatorët në vend (ose në një kontekst më të gjërë rajonal, p.sh me vendet fqinje) dhe gjithashtu mundesi te barabarta për operatorët ekonomik.

Mbikqyrja e Tregut është 1) monitorimi dhe kontrolli, nëse produktet e vendosura në treg përputhen me legjislacionin përkatës dhe 2) ndërmarrja e veprimeve kundrejt produkteve te cilët janë ne mospërputhje me legjislacionin.

Sistemi Europian është bazuar në besueshmërinë e industrise dhe mbikqyrja e tregut eshte aktivitet i bazuar ne idenë, se industria është përgjegjëse për përputhshmërinë e produkteve me kërkesat përkatëse; Mbikqyrja e Tregut duhet të ndjekë nëse industria është duke i ndjekur këto kërkesa. Të arrish që “shoqëria” të pranojë dicka të tillë dhe në përgjithësi të ndjekë rregulla të tilla, kërkohe mbështetje politike e vazhdueshme.

1. Modelimi i detyrave

Alternativa te ndryshme jane dhene per organizimin e struktures se Mbikqyrjes se Tregut dhe jane prezantuar paleve te interesuara per diskutim (ministrive te linjes, shoqatave te konsumatorit, shoqerise civile, organizatave te biznesit, etj). Pas procesit te konsultimit eshte perzgjedhur Modeli per Mbikqyrjen e Tregut (shih aneksin 1), i cili eshte konsideruar, si modeli me i pershtatshem per kushtet e Shqiperise.

Shënime për sektorin ushqimor: Shumë rregulla të lidhura me çështjet e MT të shprehura në këtë draft model janë në përgjithësi të vlefshme edhe për fushën ushqimore. Kompetencat e struktures per mbrojtjen e konsumatoreve te vendosura në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatoreve” jane, gjithashtu edhe për fushën ushqimore, si një njësi e përgjithshme. Megjithatë, sektori i ushqimit kërkon procedura dhe skema specifike në lidhje me kryerjen e mbikqyrjes së tregut. Si pasojë, në draft model nuk është trajtuar fusha e mbikqyrjes së tregut për ushqimet dhe produktet e agricultures, duke patur parasysh se kjo fushe eshte nen mbeshtetjen teknike te CARDS 2006 qe synin ngritjen e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Deri tani dokumenta të ndryshëm janë përpiluar dhe në to situata aktuale në Shqipëri është përshkruar në detaje. (shiko Aneks); megjithatë ne mund të procedojmë direkt me çështjen e hartimit të modelit të mbikqyrjes së tregut për Shqipërinë (më tej “draft modeli”). Por për të kuptuar mirë këtë material është e nevojshme për tu njohur me vlerësimin e situatës aktuale dhe gjithashtu me kërkesat e BE-së per mbikqyrjen e tregut, të përshkruar në dokumentat e përmendur shumë shkurt më poshtë.

Ne jemi përpjekur të propozojmë një model të tillë, që kur të kompletohet dhe zbatohet do të jetë në përputhje me kërkesat e BE-së dhe sa më shumë të jetë e mundur efektiv dhe ekonomik. Modeli dhe vecanërisht skema e strukturës ekzekutive mund të modifikohet gjatë procesit të zhvillimit dhe zbatimit, por në raste të tilla autoritetet përgjegjëse vendimarrëse duhet gjithmonë të konsiderojnë përputhjen e objektivave me kërkesat e BE-së.

Perzgjedhja e modelit te mbikqyrjes se tregut do te kete nevojë per ndryshime ne kuadrin ligjor, e cila do te realizohet nepermjet rishikimit te ligjit nr.9135, dt.11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si ligjeve te produkteve specifike. Megjithatë, qëllimi i këtij materiali është mbështetja për fillimin e menjëhershëm të kryerjes së aktiviteteve të MT. Për të arritur gradualisht objektivat e kësaj faze dhe mënyrën e kryerjes së MT-së në këtë periudhë “tranzicioni” janë propozuar disa hapa. Lista e detyrave të inkuorporuar në këtë draft model duhet të kuptohet vetëm si një listë treguese, për të mbështetur fillimin e veprimeve të strukturave përkatëse (ministrive te linjes, DMT,

strukturat publike te kontrollit te tregut). Ne qofte se Keshilli consultative nen ministrine qe mbulon tregtine mund te zhvilloje plane veprimi me te detajuara. Gjithsesi, do te ishte e nevojshme vijueshmeria e Projekteve te tjera Europiane ne ndihme te progresit.

Përmbledhje e elementëve kryesor të mbikqyrjes së tregut (lista treguese)

- Legjislacioni kombëtar i harmonizuar plotësisht me direktivat e produkteve specifike dhe me acquis, duke përfshirë dhe sigurinë e përgjithshme të produkteve.

- Zbatimi i legjislacionit është përgjegjësi e strukturave publike. Për këtë, administrata shtetërore duhet të ngrejë struktura përgjegjëse për monitorimin e përputhshmërisë së produkteve të hedhura në treg me ligjet specifike.

- Struktura e Mbikqyrjes së Tregut duhet të jetë e pavarur dhe të veprojë në një rrugë të paanshme dhe jo diskriminuese.

- Në lidhje me infrastrukturën e mbikqyrjes së tregut vendosë administrata shtetërore (p.sh. funksionimi ose shpërndarja gjeografike e përgjegjësive), por duhet të jetë e sigurt që modeli i cili është zgjedhur do të jetë eficient dhe do të mbulojë tërë vendin.

- Strukturat e mbikqyrjes së tregut duhet të kenë burimet dhe fuqinë e nevojshme p.sh. të kryejnë inspektime në fushë dhe të marrin mostra, të vendosin gjoba të mjaftueshme dhe të argumentuara, etj. Shkrutimisht të kenë burimet dhe fuqitë ligjore për zbatimin e ligjeve individuale.

- Strukturat e mbikqyrjes duhet të kenë një numër të mjaftueshëm stafi të kualifikuar me kompetencat teknike dhe të aftë për të aplikuar teste specifike për produktin dhe për identifikimin e zonës së rrezikut. Lehtësira të përshtatshme testimi duhet të jenë në përdorim nga strukturat e mbikqyrjes dhe biznesi.

- Strukturat e mbikqyrjes duhet të ndermarrin veprime të cilat janë në përpjestim me rrezikun e vlerësuar të përfshirë për përdorim nga konsumatori dhe mospërputhjet.

- Strukturat e standartizimit dhe të akreditimit janë ekzistente të pavarura, si dhe të ndergjegjishme për rolin dhe përgjegjësitë e tyre.

- Strukturat e vlerësimit të konformitetit janë të zhvilluara mire, të përgatitura për të ofruar shërbime si në fushën rregullatore ashtu edhe në sferën vullnetare.

- Konsumatorët janë të ndergjegjishëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe influencojnë në politik-berje nepermjet organizatave të tyre.

II. PËRSHKRIMI I DRAFT MODELIT

1. Struktura për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Këshilli Konsultativ

Draftmodeli mbështetet në rolin e fortë koordinativ të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut. Kjo vendosje bëhet mbi bazën e ligjit aktual “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”. Pas riorganizimit të ministrive (veçanërisht shkrirja e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës = METE) dhe riorganizimit të brëndshëm të METE-s, Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut operon nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregulatore. Në Drejtorinë e Mbikqyrjes së Tregut ka një sektor të Mbrojtjes së Konsumatorëve, Sektorin për Koordinimin dhe Mbikqyrjen, si dhe Sektorin për Standartet dhe Sigurimin Teknik.

Cfarë është e rëndësishme DMT duhet të autorizohet të ketë përgjegjësi më të mëdha ekzekutive sesa tani. Kompetencat e përgjithshme në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve janë dhe duhet të jenë në DMT. Sëbashku me ministrinë e linjës, autoritetet dhe aktore të tjera, ajo përgatit politikën kombëtare në mbrojtje të konsumatorëve dhe është përgjegjëse për menaxhimin e implementimit të saj. Ajo duhet të luajë një rol të fuqishëm në koordinimin e aktiviteteve të mbikqyrjes së tregut në vend.

Roli i Këshillit Konsultativ nën ministrinë që mbulon tregtinë (tani METE) do të jetë keshillimor dhe do të ketë në përberje përfaqësues nga shoqatat e konsumatorëve, organizatat e biznesit dhe shoqëria civile (të cilët do të përbejnë shumicën e këtij keshilli), si dhe përfaqësues të ministrive të linjës.

2. Struktura e Mbikqyrjes së Tregut. Draft-modeli.

Ashtu siç është përmendur edhe më lart, disa alternative janë diskutuar gjatë procesit të diskutimit me ministritë e linjës, organizatat e biznesit dhe shoqatat e konsumatorëve, shoqëria civile dhe inspektorët. Si rezultat i këtij procesi u përzgjedh Modeli i Mbikqyrjes së Tregut në Shqipëri, i cili është zhvilluar dhe paraqitur në këtë dokument.

Sipas këtij Modeli të gjitha përgjegjësitë për mbikqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore (produktet konsumatore dhe produktet jo-konsumatore), që janë nën përgjegjësi të METE-s të

përqëndrohen nën një inspektoriat (Inspektorati i Tregut/ Inspektorati i Përgjithshëm për produktet e konsumatorit, produktet jo-konsumatore).

Inspektorati mund të jetë një trup ekzekutiv i centralizuar me dege neper rajone, secila dege me inspektoret si punonjes.

Bashkëpunimi i ndërsjellë, bashkëveprimi dhe kërkimi i energjive për aktivitetet e autoriteteve të MT përshkruhet në poshtë. Në këtë fazë, ne theksojmë vetëm rolin vendimtar të Autoritetit Doganor në sistem. Të gjitha trupat e përfshira duhet të bashkëpunojnë ngushtë me doganat dhe anasjelltas.

3. Legjislacioni

Vendosja e një infrastrukture të përshtatshme dhe implementimi i draft-modelit kërkojnë zhvillimin dhe propozimin në vitet pasardhëse të masave ligjore komplekse. Masat mund të prekin rregullat e mëposhtme (lista):

- ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Kodin Civil;
- akte ligjore të ndryshme, që lidhen me hedhjen në treg të produkteve, të tilla si: Standartizimi, Vlerësimi i Konformitetit (vecanërisht fusha e vlerësimit të konformitetit në vend është në fazën fillestare)
- aktet ligjore mbi produktet (grupimi progresiv me direktivat evropiane, veçanërisht përafrimi i Ri)
- rregullore të ministrive (ato mund të propozohen si kalimtare – masa të përkohshme ku të jenë me natyrë të detyrueshme vetëm për institucionet e vartësisë për të ndihmuar në implementimin e modelit)
- procedura jo të detyrueshme pune (udhëzues), disa janë përgatitur dhe të tjera duhet të zhvillohen gradualisht

III. IMPLEMENTIMI GRADUAL I MODELIT

1. Kohëzgjatja

Procesi për arritjen e fazës finale të draft-modelit do të marrë “kohë”, në varësi të mbështetjes politike dhe investimeve për të siguruar burimet e duhura, e të mjaftueshme (humane, teknike, operacionale, etj). Ne mendojmë se faza finale mund të arrihet nga 5 deri 8 vjet, duke patur parasysh se përpjekja do të jetë maksimale. Duhet marrë parasysh që zhvillimi i mbikqyrjes së tregut është një proces pambarim duke konsideruar se në cdo moment kemi një situatë të re në përputhje edhe me eksperiencat e zhvillimet e vendeve evropiane (psh: legjislative).

Si fazë finale të modelit, do të kuptojmë një fazë të tillë ku të gjitha strukturat kryesore të MT-se do të jenë ngritur tërësisht në bazë të kompletimit të kuadrit ligjor, kompetencat dhe përgjegjësitë do të jenë qartësuar në legjislacion, degët do të jenë vendosur në rajone dhe do të kryejnë punën e tyre sic përshkruhet nën këtë raport. Nuk do të thotë në cdo rast se ata duhet të kenë të gjithë kompetencat dhe burimet/kapacitetet teknike në atë moment që të mbulojnë të gjithë sektorët (shih Aneks 3) që do të kenë nën varësi, sepse ky mund të jetë një “hap i madh”.

2. Politika Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorëve

Mbikqyrja e tregut duhet të jetë pjesë perberese e Politikës Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Implementimi i këtij draft-modeli është çështje ndër-ministrorë dhe duhet të mbështetet fort politikisht. Për të arritur fazën finale, sic përshkruhet në këtë dokument shumë masa dhe vendime duhet të merren në nivele të ndryshme. Pikat e takimit të detyrave të ndryshme, grupeve të punës dhe afateve duhet të kontrollohen në nivel qeveritar. Kjo është arsyeja, pse draft-modeli dhe implementimi i sistemit të Mbikqyrjes së Tregut duhet të përfshihen si detyra në strategjinë për konsumatorin dhe të behen të detyrueshme për administratën shqiptare.

Strategjia Kombëtare ”Për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut” do të jetë për periudhën 2007-2013. DMT duhet të raportojë cdo vit në Këshillin Konsultativ mbi progresin e implementimit të modelit, propozimin e masave të tjera të nevojshme, etj. Sigurisht, çështjet urgjente duhet të zgjidhen menjëherë në nivelin perkates.

Detyra 1.

Zhvillimi i një Strategjie Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut (2007-2013); prezantimi i saj në Këshillin Konsultativ dhe më pas në Qeveri.

DMT

Detyra 2

Raporte progresive në Këshillin Konsultativ, Progresi i Implementimit të Strategjise Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut, përfshi modelin MT DMT, i përvitshëm.

3. Mbështetja politike

E rëndësishme është të kuptohet, që mbikqyrja e tregut është një aktivitet i cili bazohet në idenë se industria është përgjegjëse për përputhjen e produktit me kërkesat thelbësore dhe se sistemi evropian bazohet në besimin ndaj industrisë. Prandaj mbikqyrja e tregut duhet të marrë masa, që industria t'i ndjek këto kërkesa.

Fokusi i mbikqyrjes së tregut nuk është vetëm kontrolli i sigurisë ndaj produktit nga autoritetet shtetërore por gjithashtu edhe ndaj përgjegjësisë së biznesit psh shpërndarëse/furnizuesve u kërkohej të kryejnë masat e tyre përfshi testimin dhe kontrollin rreth produkteve që ata hedhin në treg dhe në këtë mënyrë t'i japin atyre avantazhin konkurrues.

Për ta bërë shoqërinë të pranojë një koncept të tillë dhe veçanërisht të ndjek rregulla të tilla kërkohej një mbështetje e vazhdueshme politike. Për me teper, autoritetet duhet të zhvillojnë një dialog të vazhdueshëm me operatorët ekonomikë dhe organizatat e biznesit për të qënë efektiv në zbatimin e këtyre përgjegjësisë.

4. Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikqyrjen e tregut

Mbikqyrja e tregut duhet të mbulojë në mënyrë efektive gjithë gamën e produkteve (përfshi edhe shërbimet) veçanërisht ato që paraqesin rrezikshmëri të lartë dhe mund të dëmtojnë konsumatorët psh dëmtimet, shëndeti dhe jeta, cilësia, ato që çënojnë interesat ekonomikë, etj; ose kur ndërhyrja është thelbësore për kushte të barabarta dhe të ndryshme për bizneset (marka tregtare), ose kur faktorët mjedisor mund të kenë interesa të fortë (taksa të ndryshme për karburantët, ekologjia, etj).

Ndërkohë ekspertet theksojnë se objektivi është që legjislacioni kombëtar duhet të përputhet plotësisht me direktivat evropiane të produkteve (direktivat individuale). DMT duhet të përfshihet në mënyrë aktive në proceset ligjore si palë e interesuar dhe aty ku e shikon të pershtatshme të përgatisë vetë draft-ligje mbi produktet. Legjislacioni kombëtar sektorial duhet të ndajë shumë qartë cilat inspektoriate do të marrin rolin e mbikqyrjes së tregut. Më tej, këto inspektoriate duhet të marrin burime dhe fuqi (zyrtare) për të vepruar kur produktet mosperputhes do të gjenden/kapen në tregun shqiptar.

Detyra 3

Te ndjeke me kujdes objektivat e planifikuara nga qeveria sipas planit kombëtar të përafrimit me acquis. Te jete pjesëmarres në diskutimet brenda e jashtë-ministore mbi draftin, duke u përqëndruar në faktet që qartësojnë përgjegjësitë e autoriteteve të mbikqyrjes së tregut të vendosura në çdo ligj që i korrespondon modelit.

SPMK, vazhdimisht

Detyra 4

Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e konsumatorit do të komplotohet nëpërmjet amendimit të ligjit në fjalë. Analiza të detajuara dhe të bazuara në fakte mbi këtë çështje janë bërë nën Programin CARDS 2003. Çështja është diskutuar gjithashtu edhe më tej në këtë dokument.

Ministria që mbulon tregtinë, DMT

Amendimi i ligjit mbi mbrojtjen e konsumatorëve 2007.

Detyra 5

Sipas planit të përafrimit të legjislacionit me acquis, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është e ngarkuar të zhvillojë projektvendimin mbi kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave.

DMT

Detyra 6

Sipas planit të përafrimit të legjislacionit me acquis, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është e ngarkuar të zhvillojë projektvendimin mbi kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të Eneve të thjeshta nën presion. Gjithashtu do të përgatitet dhe komentari përkatës.

DMT

Detyra 7

Sipas planit të përafrimit të legjislacionit me acquis, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është e ngarkuar të zhvillojë projektvendimin mbi kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të Paisjeve nën presion. Gjithashtu do të përgatitet dhe komentari përkatës.

DMT

Nuk është e lehtë për stafet (e ministrive, autoriteteve të MT, atyre të para-kontrollit të tregut) të kuptojnë menjëherë të gjithë kompleksitetin e parimeve evropiane si dhe harmonizimin e ligjeve kombëtare me ato BE-se dhe implementimin e tyre. Kjo çështje është trajtuar në pjesën e cila flet mbi trajnimet e këtyre stafëve (shih më poshtë). DMT duhet të zhvillojë procedurë pune dhe udhëzime, të cilat duhet të ndihmojnë efektivisht inspektorët përkatës në zbatimin e ligjit.

5. Infrastruktura e Mbikqyrjes së Tregut

Modeli i strukturës së mbikqyrjes së tregut është përshkruar në Aneks 1. Këtu theksohet roli i trupave koordinues-monitorues, të cilët duhet të kenë rol më të fortë ekzekutiv sesa kanë aktualisht.

DMT duhet vazhdimisht të vëzhgojë situatën mbi kryerjen e mbikqyrjes së tregut në vend, veçanërisht:

- Listën e aktorëve të përfshirë (autoritetet e mbikqyrjes së tregut) dhe fushën e aktiviteteve të tyre;
- Orientimet bazë të sistemit (horizontal/sectorial/kombëtar/rajonar/lokal);
- Fuqinë (kontrollin e ndërmarrjeve, sistemin e inspektimit, marrjen e mostrave, gjrobat, etj);
- Mënyrën e përfshirjes në sistemin/et kombëtar të informacionit dhe bashkëpunimin kombëtar/ndërkombëtar, etj.

DMT duhet të jetë aktive dhe të ndihmojë autoritetet e MT-se të zgjidhin situatat, në rastet kur:

- Fusha të reja duhet të mbulohen;
- Nevoja të reja organizative (veçanërisht – sistemi sipas draft-modelit duhet të mbulojë çdo sektor të ri në të ardhmen);
- Nevoja për ndryshime të bazës ligjore;
- Nevoja për ndryshime në strukturë;
- Prioritetet, etj.

Roli i ardhshëm i DMT për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve jashtë gjyqësorit duhet të fillojë.

6. Mjedisi teknik

Mjedisi teknik i inspektoriateve është padyshim një çështje tjetër kryesore, e lidhur sidomos me aspektin financiar. Inspektoriatet dhe degët e tyre duhet të jenë të pajisura me teknologji bashkëkohore (PC, IT, etj). Burimet financiare duhet të jenë të konsiderueshme për të mbuluar kostot për udhëtime, etj (përfshi motorizimin e degeve rajonale, etj) Marrëdhëniet e vendosura dhe varesia me buxhetin e shtetit duhet të zgjidhet në lidhje me pagesat, honoraret, gjrobat, disa të ardhura dytesore, etj.

Problemi i veçantë është se ka pak (për të mos thënë që nuk ka) paisje testuese. Mesa duket, shumica e inspektimeve në vitet që do të vijnë, do të jenë kontrollet administrative (deklarata e konformitetit, etiketimi, dokumentat teknike, deklaratimet doganore etj). Por megjithatë, duhen gjendur mundësitë për të zgjidhur problemin, se ku dhe si do të testohen mostrat e produkteve të cilat janë të dyshimta si të rrezikshme.

Përpjekjet e ministrisë, DMT dhe autoritetet e tjera të mbikqyrjes së tregut duhet të përqendrohen në:

- Përdorimin (ndonese rrallë) të paleve të treta testuese: Instituteve kerkimore, laboratoreve të inspektoriatit sanitar etj. – nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit, kontratave ad – hoc, etj. Të mbështetet kryesisht ngritja dhe dizajnimi i strukturave të vlerësimit të konformitetit dhe të përdoren për testim.

- Përfshirjen në një inspektoriat të vetëm/multi sectorial/të çdo subjekti të cilët tashmë zoterojnë paisje testuese (një inspektoriat sectorial, institute kerkimor) dhe të fillojnë zhvillimin e historikut të tyre teknik e testues si dhe lehtësirat që do vijnë prej tyre.

- Konsiderimin e një zgjidhje sistematike por shumë të kushtueshme: Investimin kryesor në zhvillimin e një “shtëpie laboratorike qendrore dhe testimi teknik”, e cila duhet të zhvillohet gradualisht në dhjetra laboratore dhe zyra certifikimi e testimi, secila prej të cilave do të bëjë përpjekje për të arritur statusin e akreditimit, dhe në teresi të mbulojë testimet dhe vlerësimin e konformitetit të sektoreve të ndryshëm industrial (paisjet elektrike, makinerite, produktet kimike, kozmetike, produktet industriale ndricuese - lodrat, tekstilet, keputet etj). “Shtëpia” duhet të sigurojë shërbime testimi dhe vlerësimi të konformitetit në lidhje me para hedhjen në treg dhe pas hedhjes në treg, sigurinë në punë

etj. Nje investim i tille mund te behet vetem me nje mbeshtetje te gjere te shtetit, programeve te BE-se, ndoshta marreveshjeve bilaterale (US) dhe mbeshtetjes se biznesit.

IV. Metodologjia, Praktikrat dhe operimi i Strukturave te mbikqyrjes se tregut

1. Metodologjia dhe planifikimi

Strukturat e kontrollit te tregut duhet te zhvillojne plane dhe metoda pune te mbeshtetura nga DMT dhe ministrit e tjera te linjes, duke konsideruar modelin e perzgjedhur te meposhtem:

Natyrisht implementimi i modelit dhe i arritjes se “objektivave te kesaj faze” do te jete nje rruge e gjate, vecanerisht nese do te mbuloje shume sektore te ndryshem. Planifikimi dhe zgjedhjet e prioriteteve duhet te bazohen ne eksperiencen e fituar gradualisht (produktet qe ndodhen ne tregun shqiptar dhe problemet qe ata shfaqin duhet te jene ceshtjet e para qe strukturat e MT duhet te konsiderojne). C’ka nenkupton se pika e nisjes duhet te jete vleresimi i nevojave te mbikqyrjes se tregut ne nivel kombetare. Per shembull, ne qofte se disa produkte shkaktojne shume probleme (aksidente/ rreziqe), burimet duhet te fokusohen ne ndertimin e nje sistemi per mbikqyrjen e tregut per produkte te tilla. Me tej, ne Shqiperi nje grup i vecante konsumatoresh mund te jete me shume i rrezikuar se te tjeret, si femijet dhe te moshuarit. Demografiket jane nje element tjetër shtese qe duhet marre parasysh kur vendosen prioritete per te ardhmen ne mbikqyrje.

DMT duhet te jete aktive dhe te luaj me sukses rolin e saj nder sektorial dhe te pergjithshem, si dhe te adoptoje e propozoje masa te cilat do te cojne ne percaktimin e prioriteteve kombetare. Çdo strukture e mbikqyrjes se tregut do te procedoje me te njejtin model brenda fushes se tij te pergjegjesive.

Detyra 8

DMT do te zhvilloje se bashku me strukturat e tjera ekzistuese te mbikqyrjes se tregut dhe OJF-te plane pune per bashkepunim me strukturat perkatese (zyrat e statistikave, Ministrine e Shendetesise , etj), te cilat jane ne gjendje te vleresojne cilat produkte shkaktojne me shume probleme dhe aksidente etj. Vecanerisht, kur perdoren ne kohen e lire, ne shtepi etj Nje raport duhet te zhvillohet mbi rezultatet (zhvillimi i nje plani; rezultatet e planit).

DMT, autoritetet ekzistuese te MT-se, OJF per mbrojtjen e konsumatoreve; 2008

Cdo autoritet i MT-se duhet te zhvilloje punen e saj ne baze te nje plani sistematik; planet baze te sektoreve jane zakonisht nje vjecare (megjithate, per disa veprime monitoruese do te jete e nevojshme zhvillimi i planeve shumevjecare). Plane te vecanta, perfshire metodologjine duhet te zhvillohen per cdo fusheveprimi (kontroll, monitorim), duke mbuluar ndermjet te tjerave format e kontrollit qe duhen perdorur, vleresimin e nevojave, kerkesat ligjore qe duhen kontrolluar, procedurat e vleresimit te rrezikshmerise, afatin, zgjedhjen e zones, zgjedhjen e tregtareve, planifikimet e biznesit, etj. Koordinimi i aktiviteve me strukturat e tjera te MT eshte mjaft i rendesishem.

Planifikimi i aktiviteve te inspektimit duhet te konsideroje perdorimin e:

- Kontrolle te befasishme, te planifikuara dhe te rastesishme;
- Kontrolle ne te gjithe zinxhirin furnizues;
- Metodave direkte dhe indirekte;
- Testime vizuale;
- Testime te mostrave;
- Kontrolle te dokumentave; etj

Metodologjia e kontrollit dhe veprimet duhet te planifikohen e zbatohen, ne baze te informacionit te mbledhur si dhe duke marre parasysh p.sh:

- Planet vjetore qe marrin parasysh eksperiencen e meparshme, aksidentet dhe te dhenat e analizuara te incidenteve, etj;
- Vleresimin e ketyre planeve vjetore;
- Vleresimin e rezultateve te testimeve te kryera;
- Kryerjen e vleresimit te rrezikshmerise se produkteve;
- Organizimin here pas here i seancave te degjimit apo shqyrtimit;
- Vendimet apo reagimet ne lidhje me zbulimin e produkteve te rrezikshme, duhet te merren shpejt, perfshire ketu edhe vendimet per heqjen nga tregu te tyre;
- Dhenien e informacionit ne lidhje me vendimet e marra per produktet e rrezikshme, konsumatoreve dhe strukturave perkatese;
- Regjistrimin dhe vleresimin e ankesave te konsumatoreve dhe konkurrenteve.

Detyra 9

Cdo strukture e MT-se duhet te zhvilloje raporte vjetore te pervitshme; Raportet vjetore do te mblidhen nga DMT per te gjithë sektoret perfshire dhe ushqimet, te cilet duhet te pergatisin informacione vjetore per Keshillin Konsultativ (ose per Qeverine) ne kuader te implementimit te Strategjise se Mbrojtjes se Konsumatoreve dhe Mbikqyrjes se Tregut, si dhe fazes se implementimit te Modelit te Mbikqyrjes se Tregut.

Te gjitha autoritetet e MT-se, DMT-ja çdo vit

Ankesat nga konsumatorët dhe konkurrentët duhet te njihen si burim informacioni per veprime te metejshme. Formati i ankesave te konsumatorit eshte tashme ne rrugen e pershtatjes per vendin tone dhe me pas do te shperndahet gjeresisht ne te gjitha strukturat, konsumatorët, shoqatat e tyre si dhe ne shoqatat e biznesit. Te gjitha autoritetet e MT-se duhet te sigurojne keshillim dhe te vleresojne eksperiencat. Informacioni i plote mblidhet ne DMT.

Detyra 10

DMT-ja duhet te mbledh dhe te pergatisë raportin permbledhes te pergjigjjeve te formularit te ankesave te konsumatorit dhe gjithashtu te mbledh informacion mbi ankesat edhe nga burime te tjera (OJF, strukturat e MT, bashkite, etj.) Ankesat duhet te vleresohen dhe ne perfundim te merren ose propozohen veprime dhe masa.

DMT, vjetore per here te pare ne 2008

2. Trajnim, edukim profesional

Zhvillimi i trajnimeve sistematike dhe edukimit profesional te stafit duhet te jete prioritet i cdo strukture te MT, mbeshtetur nga DMT -ja dhe ministritë e linjes me synim kryerjen dhe rritjen e kompetencave teknike dhe integritit profesional te personelit te tyre.

DMT duhet te asistojë dhe zhvillojë programe trajnimi lidhur me teorine dhe praktiken e mbrojtjes se konsumatoreve dhe fushave te tjera te lidhura me te, psh:

- Element kryesor i trajnimit dhe edukimit profesional te cdo inspektori duhet te jete njohja e thelle e Kodi te Procedurave Administrative;
- Trajnim per ligjin e mbrojtjes se konsumatorit, Kodin Civil, ligjet e sigurise se produkteve specifike, parimet e ligjeve te BE-se, marken e konformitetit, vleresimin e konformitetit (perfshire ligjet e produkteve) dhe direktivat evropiane;
- Zbatime praktike te politikës se konsumatorit;
- Monitorimi i sigurise se produkteve, vleresimi i rrezikshmerise dhe procedurat e vleresimit;
- Kryerja e praktikave te mbikqyrjes se tregut, perfshire, menyren e organizimit te inspektimeve te njekohshme te produkteve te zgjedhura, shkembim eksperience, metodat dhe organizimi i kontroleve ne treg etj;
- Kryerja e testeve te laboratorit;
- Dhenia e informacionit konsumatoreve dhe operatoreve te biznesit;
- Rritja e nivelit te ndergjegjesimit te konsumatorit;
- Zhvillim kombetar i sistemeve te standartizimit, vleresimit te konformitetit dhe akreditimit;

etj

Çdo strukture e MT duhet te zhvilloje programe sistematike te nendegëve (krahasimet me sisteme te tjera te mbikqyrjes se tregut ne vendet e tjera fqinje dhe ndermjet sektoreve).

Modeli mbeshtetet dhe kontrollohet nga DMT.

Detyra 11

Çdo strukture e MT duhet te zhvilloje skema sistematike te trajnimit dhe rritjes se kompetencave te stafit.

Pergjegjesite dhe mbeshtetja e administrates shteterore: DMT per sektoret jo ushqimor ne pergjithesi, ne lidhje me sektoret perkates te strukturave te MT te; Projekte te BE-se mund te ndihmojne ne zhvillimin e trajnimeve te tilla dhe skemave te edukimit profesional.

Detyre e vazhdueshme, kontrole vjetore nga DMT.

Detyra 12

Udhëzues mbi “Parimet kryesore te kryerjes se praktikave te MT” perfshire ketu njohjen e Kodit te Procedurave Administrative dhe zhvillimin e formuleve model per punen ne terren te inspektoreve (format model per protokollin e kontroleve, format model per gjrobat, etj). Udhëzuesi do te ofroje modele per strukturat e sapo krijuara dhe pa eksperience ne zhvillimin e dokumenteve te tilla.

DMT, ne bashkepunim me inspektoriatet aktive. Plan: 2008-2009

3. Praktika të tjera të Mbikqyrjes së Tregut

DMT mbledh vazhdimisht informacion rreth produkteve të konsumatoreve që shkaktojnë probleme në treg në mënyrë që të mbështesë punën e strukturave perkatese të mbikqyrjes së tregut dhe të vendosë prioritetet kombëtar brenda sektoreve të ndryshme. Për të arritur këtë:

- Vlerësojnë informacionin e plotë të raporteve vjetore të mbledhur nga të gjitha strukturat e MT;

- Përdorin sistemin e mbledhjes së ankesave dhe vlerësojnë të dhënat statistikore;

- Kërkojnë mundësi për të promovuar ose/dhe krijuar raporte mbi aksidentet në nivel kombëtar dhe sistemin e statistikave të aksidentit;

- Ja bëjnë të njohur sistemet e raportimit Komisionit Evropian (Procedurave të kushteve mbrojtëse dhe sistemit RAPEX, ose RASFF);

- Mbledhin sistematikisht informacion nga të gjitha strukturat e MT-së me ndihmën e formularit të të dhënave për strukturat e MT.

Perballimi me inspektime të nderlikuara në terren dhe të gjitha çështjet perkatese (duke ndjekur metodologjinë, planet, njohuri të thella të ligjeve, etj.) kërkojnë eksperiencë të gjatë dhe praktike; sigurisht do të ketë pak eksperte të tilla në Shqipëri, por ata duhet të përgatiten sistematikisht. Për të fituar aftësi praktike dhe eksperiencë, rekomandohen të zbatohen projekte pilot në fushat ku ekzistojnë ligjet e sigurisë së produkteve.

Detyra 13

Aty ku një pjesë e legjislacionit sektorial është transpozuar në mënyrën e duhur në legjislacionin kombëtar, ekziston mundësia dhe mbështetja, fillimisht në shkallë të ulët me projekte të mbikqyrjes së tregut së bashku me ministrinë/inspektoriatet të cilat kanë marrë një përgjegjësi sektoriale për mbikqyrjen e tregut. Materialet e zhvilluara nga Projektet CARDS mund të përdoren për të mbështetur kryerjen e tyre; Fazat e përgatitjes dhe vlerësimit të cdo veprimi mund të asistohen nga një ekspert nderkombëtar afatshkurter nën projektin që është në vazhdim ose projekte të tjera.

DMT me ministrinë perkatese dhe strukturat e MT-së

2008- një veprim

2009- dy veprime (të pakten)

Aspekti i rendesishëm i kryerjes së MT është pershtatshmëria e masave; megjithatë terheqja e produkteve nga tregu është një masë, e cila duhet të merret në rast të argumentuara. Për rast të tillë, strukturat Evropiane zhvillojnë procedurë për të ndihmuar biznesin të përballet me këto raste. Strukturat e MT-së dhe shoqatat profesionale (Bashkimi i dhomave të Tregtise) duhet të ndjekin dokumentat Evropiane; rekomandohet zhvillimi i këtyre procedurave sipas kushteve të Shqipërisë.

Detyra 14

Zhvillimi sipas kushteve të Shqipërisë i udhëzuesit për veprimet korrigjuese, përfshirë këtu edhe terheqjen nga tregu;

- duke ndihmuar biznesin të mbrojë konsumatorin nga produktet e pasigurta

DMT me asistencë teknike të projektit CARDS, viti 2008

V. Komunikimi, bashkëpunimi dhe asistencë teknike

1. Strukturat e lidhura për fazën para hedhjes në treg

Në fazën para hedhjes të produkteve në treg përfshihen disa struktura dhe subjekte me qëllim sigurimin e sigurisë dhe cilesisë së produkteve në treg dhe disa kushte të tjera. Në procedurat perkatese përfshihen bashkërisht struktura shtetërore, të pavaruar madje dhe struktura private. Shteti duhet të krijojë veçanërisht një mjedis ligjor efektiv dhe skema të cilat duhet të veprojnë efektivisht dhe në përputhje me parimet Evropiane, aty ku është e pershtatshme.

Struktura të tilla si, vlerësimi i konformitetit, standartet, metrologjia, akreditimi etj, të cilat janë pjesë e sistemit të MT-së kanë si objekt (direkt ose indirekt) konsumatorët. Si një sistem që krijon mjedisin për prodhuesit dhe tregtarët, ai duhet të garantojë sigurinë e produkteve të hedhura në treg dhe disa interesa ekonomike kryesore (pesha, masat) etj, përveç faktit që zakonisht (me përjashtim të ushqimeve) ai nuk përfshin kontrollin e detyrueshëm para hedhjes në treg si dhe aprovimin e produkteve nga ndonjë organ shtetëror.

Zhvillimi i metejshëm i skemave perkatese dhe i mbështetjes së organizatave është çështje e politikave dhe strategjive të tjera. DMT dhe të gjitha strukturat e tjera të MT duhet të bashkëpunojnë ngushtë me strukturat të tilla. Veçanërisht do të përmendim ato me poshtë:

Standartizimet janë identifikuar si metode e përcaktimit të cilesisë së pershtatshme dhe

gjithashtu specififikimet e sigurise te korespondojne me konceptin e “sigurise” se produkteve nen direktiven e sigurise se pergjithshme te produkteve dhe direktivave te perafimit te ri (kerkesat kryesore). Standartet jane perdorur cdo dite nga stafi i strukturave te MT-se dhe reagimi e bashkepunimi i ngushte eshte gjithashtu i nevojshem ne procesin e zhvillimit te standarteve kombetare, ne nivel European dhe nderkombetar.

Testimet dhe certifikimet (vleresimi i konformitetit) luajne rol kryesor ne procesin e hedhjes ne treg te produkteve. Skemat e markimeve detyruese dhe vullnetare dhe deklarata e konformitetit qe shoqerojne produktin eshte nje udhezues per strukturat e MT per vleresimin, se cfare kerkesash ligjore dhe joligjore duhet te plotesoje produkti ose si jane permbushur ato. Kuptimi i ketyre skemave eshte gjithashtu i rendesishem, bashkepunimi i ngushte dhe marrja e mendimeve jane te nevojshme. Per me teper, kapaciteti teknik i shumices se strukturave te MT ne Shqiperi ne lidhje me kapacitetet laboratorike dhe testuese eshte dhe do te jete per nje kohe te gjate i ulet. E rendesishme eshte perdorimi i mjeteve te vleresimit te konformitetit te disponueshme ne vend, gjithashtu edhe per nevojat e strukturave te MT. Interes kryesor ka mbeshtetja e zhvillimit te infrastruktures se vleresimit te konformitetit, sistemit te akreditimit, rritjes se kapaciteteve te strukturave te vleresimit te konformitetit, cilesia e tyre, etj.

2. Koordinimi i aktiviteve me dhe midis inspektoriateve, shkembimi i informacionit me te tjeret, sistemi i komunikimi dhe i marrjes se mendimit (feedback)

Shperndarja e informacionit eshte bazuar sa me shume qe ka qene e mundur ne perdorimin e IT. Ne cdo strukture te MT-se duhet te zhvillohen me transparence strukturat e raportimit brenda sherbimeve inspektuese, perfshire sistemin e zbatimit apo ndjekjes se raporteve. Cdo strukture e MT eshte pergjegjese per bashkepunimin me zbatuesit publik dhe autoritetet e policise, dhe per raportimin ne nivel kombetar brenda fushes se kompetencave perkatese. DMT duhet te mbaje pergjegjesi per raportimin ne nivel nderkombetar ne lidhje me mbikqyrjen e tregut. Gjithashtu, cdo autoritet MT duhet te shperndaje informacion te produktit ekzistues ne lidhje me problemet dhe rreziqet ne tregun Shqiptar. DMT vezhgon dhe mbeshtet kete proces dhe me kete ushtron presion mbi perpjekjet e ardhshme per krijimin e nje sistemi funksional per mbikqyrjen e tregut ne Shqiperi.

Autoritet e kontrollit te tregut pajisin DMT me raporte Vjetore, Raporte ne fushen e kontrolleve, kurdo qofshin mbaruar, Raporte monitorimi dhe planifikimi vjetor. Mbeshtetur ne kete informacion DMT harton raporte per Keshillin Konsultativ dhe/ose per Qeverine cdo vit, merr vendime dhe propozon masa strategjike ose masat e duhura per tu pershtatur ne nivele ministeriale dhe qeveritare.

Rastet e produkteve te rrezikshme ose te dyshuara si te rrezikshme duhet te raportohen ne DMT duke perfshire ne te masat dhe veprimet e marra. Kjo nuk do te thote se DMT miraton keto masa- keto jane kompetence e autoriteteve te MT. Sistem i vecante informacioni per produkte te tilla duhet krijuar. Duhet te pergatitet ne bashkepunim me Sistemin European (Rapex). Sistemi i shkembimit te informacionit per sektorin e ushqimeve eshte i ndertuar vecmas, nen Agjensine Kombetare te Ushqimit; por te gjitha raportet dhe planifikimi i mundesohen DMT.

DMT mund te krijojte sisteme sektoriale, kombetare te realizueshme per te mbledhur informacion per produkte, sistem ky, kompleks si RAPEX, e cila lidhet vetem me produktin e rrezikshem. Ky sistem i gjere mund te sherbeje per mbledhjen e informacionit dhe ankesave nga industria dhe konsumatori. Gjithashtu, ky informacion duhet te mblidhet brenda cdo ministrie/ inspektoriatit pergjegjes per produkte te caktuara dhe mund te jete i leverdisshem per zhvillimin e sistemit kombetar. Shkembimi i rregullt i informacionit brenda nje rrjeti mes strukturave publike per mbikqyrjen e tregut eshte me rendesi per ngritjen e nje strukture per funksionimin e drejte te nje mbikqyrje te tregut

Detyra 15

Zhvillimi i sistemit IT te informacionit. Duhet te perfshihet ne menyre te vecante informacioni per sistemin RAPEX. Detyra duhet te sakesohet me tej, duke marre parasysh eksperiencen e fituar dhe nevojat e deritanishme.

DMT, 2009-2011

Memorandumi i bashkepunimit duhet te perfundohet dhe nenshkruhet mes DMT dhe Inspektoriateve, Doganave, disa komunave dhe autoriteteve vendase per te mbeshtetur kete bashkepunim (keshillimin e konsumatorit, vleresimin e problemeve rajonale lidhur me mbrojtjen e konsumatorit, sigurine e mallrave, cilesine dhe vlefshmerine e sherbimeve etj.)

Theksojmë rolin e madh të Autoritetit të Doganave në sistem. Të gjitha grupet e përfshira duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Doganat dhe anasjelltas.

Informimi i industrisë dhe operatorëve ekonomikë është prioritet i autoriteteve të MT dhe ministrive të linjës së qeverisë në përgjithësi. Kontrolli i mallrave në treg është masa e fundit e aktiviteteve të mbikqyrjes dhe me kushtueshmja. Me shumë energji dhe kapacitet është i nevojshëm të kushtohet në masat parandaluese për të trajnuar dhe arsimuar profesionalisht bizneset që të rrisin kompetencat teknike të industrisë, që të mbështesin skemat e kontrollit të cilësive dhe menaxhimit, të rrisin njohuritë rreth rregullimeve kombëtare dhe, markes CE, etj.

DMT dhe strukturat e mbikqyrjes së tregut duhet të jete në kontakte të rregullta me shoqatat profesionale dhe me sipërmarrës të vecantë, menaxherë etj. Parimet e përafrimit Evropian të sistemit të MT në Shqipëri duhet të shtjellohen dhe të zbatohen në çdo rast, p.sh. në Panairët e Tregtisë. Fletëpalosjet të lidhura me biznesin mund të përgatiten, etj.

Informimi i konsumatorit është aktiviteti më i sofistikuar dhe i nderlikuar i skemave të mbrojtjes së konsumatorit. Edukimi dhe informimi i konsumatorit është mënyra më e mirë e të mesuarit. Konsumatorët e informuar mund të mbrojnë veten e tyre mirë, ç'ka ndihmon në zbatimin e ligjeve dhe mbikqyrjen e tregut. Fushata të vecanta mund të hartohen në nivel DMT që lidhen me ngritjen e sistemit të mbikqyrjes së tregut shqiptar. Mbeshtetur në përmbajtjen e tij, DMT mund të nisë punën me fushatë informimi dhe përmirësimin e njohurive kombëtare të kërkesave Evropiane (ndërsa legjislati kombëtar dhe vlerësimi i përshatjes së infrastrukturës do ndërtohet hap pas hapi).

3. Marrëdhëniet ndërkombëtare, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit

Asistenca teknike (BE dhe programet dypaleshe) është dhe do kërkojë të sigurohet me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e infrastrukturës, rritur kompetencat e autoriteteve të MT në të gjitha fushat përkatëse, për të ndjekur etapën etj.

Tjetër objektivi i rëndësishëm është rritja e aftësisë dhe gatishmërisë së autoriteteve të MT dhe DMT në mbledhjen dhe sigurimin e informacionit dhe të dhënave të besueshme për sistemet ndërkombëtare të shkëmbimit të informacionit. (RAPEX, RASFF – Sistemet e shkëmbimit të shpejtë të informacionit).

Mendohet dhe është shumë e rekomandueshme që projektet e reja Evropiane të mbështesin zbatimin e modelit. Autoritet shqiptarë janë të keshilluara të kërkojnë marrëdhënie bilaterale dhe asistencë teknike nga projektet Evropiane për këtë proces.

VI. KONKLUSIONE

Ekspertët e projektit në bashkëpunim të ngushtë me DMT janë përpjekur të propozojnë një model mbikqyrje tregu që kur të përfundojë dhe zbatohet të plotësojë kërkesat e Bashkimit Evropian dhe të mund të jete efektiv dhe ekonomik sa më shumë të jete e mundur. Janë disa mundësi të sugjeruara, zgjedhja finale duhet të bëhet nga autoritet shqiptarë.

Procesi i arritjes së etapës finale të modelit do kërkojë 5 deri në 8 vjet, kur të gjitha autoritetet e MT do jenë të ngritura përfundimisht në bazë të ligjit, kompetencat dhe përgjegjësitë do jenë të përcaktuara qartë në ligj, dhe do jenë të ngritura në rrethë dhe do kryejnë punën e tyre ashtu siç është përshkruar me këtë material.

Objektivi i këtij materiali, sidomos është të mbështesë fillimin e menjëhershëm të aktiviteteve të mbikqyrjes së tregut. Prandaj disa hapa janë propozuar këtu, për të arritur në mënyrë graduale etapën finale dhe se si të bëhet mbikqyrja e tregut në këtë periudhë tranzicioni. Është shumë e rëndësishme që DMT dhe strukturat ekzistuese të kontrollit të tregut të përpqen të ndjekin menjëherë rekomandimet e këtij materiali kur strukturat e reja të MT-së do të ngrihen.

Mendohet dhe është shumë e keshillueshme, që projektet e reja Evropiane të mund të mbështesin zbatimin e modelit të MT. Autoritet shqiptarë duhet të kërkojnë marrëdhënie dypaleshe dhe asistencë teknike për të ndihmuar procesin e zbatimit.

SHTOJCE 1

MODELI I SISTEMIT TË MBIKQYRJES SË TREGUT PËR SHQIPËRI

“Një Inspektoriat i Përgjithshëm për produktet e konsumatorëve dhe jo të tilla”.

Të gjitha përgjegjësitë për mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore (përfshirë produktet e konsumatorëve dhe jo të tilla), të cilat janë nën përgjegjësinë e METE-s do jenë të përqendruar në një inspektoriat të përgjithshëm. Ky sistem do të sigurojë:


1. Mbulim te qarte (transparent) per te gjitha fushat;
2. Centralizim te forte, shpenzime te vogla administrative, efektiv, sistem ekonomik ne vend te ekzistences se dhjetra inspektoriateve te vegjel, secili e specializuar per vetem nje sektor, vetem nje inspektoriat i pergjithshem do krijohet;
3. Lehtësi per koordinimin dhe shkembimin e informacionit;
4. Lehtësi ne kryerjen e mbikqyrjes se tregut te produkteve e cila mund te mbulohe nga disa ligje (psh pajisja shtepiake mikser eshte e mbuluar nga rregullime ne makineri, pajisje elektrike, pajtueshmeria elektro-magnetike etj.);

Ky inspektorat i pergjithshem, do te mbuloje gradualisht si rezultat i transpozimit te direktivave evropiane te New dhe Old Approach, te gjithe sektoret e tjere si: makinerite, lojrat, ashensorët, kimikatat etj, dhe shume te tjera. Integrimi i disa institucioneve te tjera plotesisht ose pjeserisht mund te merren parasysh; psh. Instituti i Industrise se Lehte.

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes rekomandohet te mbikeqyre Inspektoriatin e pergjithshem. Ne te njejten kohe, trajtimi i ankesave te konsumatorit dhe shkeljet e dispozitave te ligjit per mbrojtjen e konsumatorit do te kryehet nga DMT, i cili ka pergatitur te gjithe dokumentacionin e nevojshem per Komitetin vendimarrës per ankesat e konsumatorit.

Mbikeqyrja per materialet e ndertimit parashikohet te vazhdoje te mbetet pergjegjesi e Inspektoriait te Ndertimit nen Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Diagrama e modelit te struktures se synuar



B Organizimi rajonal

Struktura rajonale e inspektoriateve eshte nje aspekt tjetër vendimtar i funksionimit efektiv te autoriteteve te MT. Ne te njejten kohe, kosto e struktures duhet te jete sa me ekonomike.


Inspektorati si organ ekzekutiv

Inspektoriati do te jete nje organ EKZEKUTIV shume i centralizuar, me dege ne rajone, me inspektoret e vet si punonjes (ne dege); Ne ketë rast rekomandohet qe secili Inspektoriati te kete nga 4 dege neper rajone: nje ne prefektoren e Tiranës dhe 3 ne rajone, secila te mbuloje 3-4 prefektura.

Keto dege rajonale mund te kene disa zyra te tjera (nen-dege) ne pjesen tjeter te prefekturave (psh, ne disa bashki). Por kjo nuk eshte domosdoshmerisht e nevojshme. (Shenim: per me teper, ketu mund te perdoret puna “nga qendra”, si kerkese baze stafi duhet te jete “I profilizuar me fushen”, dhe ata mund te mos jene domosdoshmerisht ne kontakte ditore me zyren e deges).

Presupozohet se si fillim, deget mund te kene grupe prej 2-4 personash secila, megjithate numri mund te rritet ne menyre progresive brenda periudhes se arrijtes se nivelit te synuar. Inspektoriatet e Mbikqyrjes se Tregut kryesore mund qe te fillojne pune ne rajone me secili me te pakten 10 persona .

Diagrama e struktures se mundshme territoriale te nje inspektoriatit



**SHTOJCE 2: LISTA TREGUESE E SEKTOREVE TE NDRYSHEM QE DUHET
(GRADUALISHT!) TE KONTROLLOHET NGA INSPEKTORIATI I MT**

Sektoret	Inspektoriatet “Kryesore” te MT	Inspektoriata sektoriale Potenciale te vecanta
Siguria e produkteve te pergjithshme	X	
Makineri	X	
Ashensore	X	
Pajisje nenpresion	X	
Boliere	X	
Pajisje gazi	X	
Tension i Ulet	X	
Perputhshmeria elektromanjetike	X	
Eksplozive	X	
Kabell	X	
Eficenca e energjise	X	
Perhapja e zhurmave		MMPU/Inspektoriati i Mjedisit
Instrumenta te matjes		Drejtoria e pergjithshme e Metrologjise
Mjete matese jo automatike		Drejtoria e pergjithshme e Metrologjise
Lodra	X	
Pajisje Radio dhe telefonike		X
Pajisje te mbrojtjes personale	X	
Pajisjet clodhese	X	Ministria e PPTT
Pajisje mjekesore		X
Produkte ndertimi	X	Ministria e PPTT/Insp. Ndertimit
Paketim	X	
Eksplorative per perdorues civile	X	
Materialet ne kontakte me ushqimin		Ndoshta Autoriteti Kombetar i Ushqimit
Mjetet motorike, traktoret		Ministria e PPTT; MBUMK
Veshje / kepuce	X	
Imitimi i ushqimeve	X ?	
Metrologji	X ?	Drejtoria e pergjithshme e Metrologjise
Kimike detergjent	X	
kozmetike	X	
produkte te rrezikshme	X	
gaz	X	
Medikamentet		Qendra Kombetare e Kontrollit te Barnave
Sherbime	X	
Interesi ekonomik I konsumatoreve	X	
Ushqimi		Ndoshta Autoriteti Kombetar i Ushqimit

		(Inspektoriati i Ushqimit, Inspektoriati Veterinar, Inspektoriati Sanitar)
--	--	--

ANEKS 2

I. LISTA E DIREKTIVAVE EVROPIANE QE DO TE TRANSPOZOHEN NE AKTE NËNLIGJORE NE ZBATIM TE LIGJIT TE MBROJTJES SE KONSUMATORËVE

Viti 2008

1. Direktiva Evropiane 1997/7/ EC - Mbi respektimin e kontratave ne distance;
1. Direktiva Evropiane 90/314/EC- Mbi paketat e udhëtimit;
3. Direktiva Evropiane 85/577/EC- Respektimi i kontratave te negociuara larg qendrave te biznesi.;

Viti 2009

1. Direktiva Evropiane 94/47/EC – Mbi kontratat e përdorimit te sendeve te paluajtshme mbi bazën e afateve kohore;
2. Direktiva Evropiane 87/102/EEC- Mbi kreditë e konsumatorëve;
3. Direktiva Evropiane 98/7/EC/-Mbi kreditë e konsumatorëve;

Viti 2010

1. Direktiva Evropiane 98/27/EC - Mbi vendimet gjyqësore;
 2. Direktiva Evropiane 2002/65/EC - Mbi marketingun ne distance te shërbimeve financiare;
 3. Direktiva Evropiane 98/257/EC - Mbi mosmarrëveshjet jashtëgjyqësorit;
 4. Direktiva Evropiane 2005/29/EC - Mbi praktikat e pandershme tregtare.
- II. Lista e Direktivave Evropiane qe do transpozohen ne akte nënligjore për rregullat teknike ne zbatim te Ligjit “Për sigurinë e përgjithshme te produkteve, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit te produkteve”

A. PËRAFRIMI I RI

Viti 2007

1. Direktiva Europiane 88/378/EEC –Per sigurine e lodrave

Viti 2008

- | | |
|-----------------------------------|--|
| 1. Direktiva Europiane 87/404/EEC | - Per enet e thjeshta nen presion |
| 2. Direktiva Europiane 97/23/EC | - Per pajisjet nen presion |
| 3. Direktiva Europiane 73/23/EEC | – Për pajisjet e tensionit te ulet (Pajisjet |
| 2006/95/EC Elektrike) | |
| 4. Direktiva Europiane 89/336 | – Për përputhshmërinë elektromagnetike. |
| 5. Direktiva Europiane 94/9/EC | – Për pajisjet për atmosfera shpërthyes. |
| 6. Direktiva Europiane 94/62/EC | - Paketimi dhe paketimi i mbetjeve. |
| 7. Direktiva Europiane 96/57/EC | – Për eficienten për energji për pajisjet frigoriferike. |
| 8. Direktiva Europiane 2000/55/EC | –Për eficienten e energjisë për ndriçimin fluoreshent. |
| 9. Direktiva Europiane 92/75/EC | – Për etiketimin e pajisjeve elektroshtëpiake |
| 10. Direktiva Europiane 95/16/EC | – Për ashensorët. |

Viti 2009

- | | |
|-----------------------------------|---|
| 1. Direktiva Europiane 98/37/EC | – Për makineritë. |
| 2. Direktiva Evropiane 89/686/EEC | – Për pajisjet mbrojtëse vetjake |
| 3. Direktiva Evropiane 90/396/EEC | – Për pajisjet me gaz |
| 4. Direktiva Evropiane 92/42/EC | - Për kërkesat për eficiency për bojlerët e rinj qe punojnë me gaz te lënget. |

Viti 2010

- | | |
|-----------------------------------|--|
| 1. Direktiva Europiane 2000/9/EC | - Për pajisjet kabllore për transport njerëzish. |
| 2. Direktiva Europiane 1999/36/EC | - Për pajisjet e transportueshme nen |

presion.

3. Direktiva Europiane 2002/96/EC - Per mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike
B. PËRAFRIMI I VJETËR
Viti 2008
1. Direktiva Europiane 73/404/EEC,
73/405/EEC, 82/242/EEC,
82/243/EEC - Per detergjentet.
Viti 2009
1. Direktiva Europiane 68/89 - Për klasifikimin e drurit te papërpunuar
2. Direktiva Europiane 96/74/EEC,
97/73/EEC, 73/44/EEC - Për tekstilet
3. Direktiva Evropiane 94/11/EEC - Për këpucët
4. Direktiva Evropiane 64/493 - Për xhamin e kristalte

PJESA IV PRODUKTET FARMACEUTIKE

Situata aktuale ne sektorin farmaceutik

Sektori Farmaceutik ne Shqiperi eshte i privatizuar

Institucionet shtetore si Drejtoria farmaceutike ne Ministri te Shendetesise dhe Qendra Kombetare e Kontrollit te Barnave ne zbatim te politikave te zhvillimit te Qeverise, jane pergjegjese per sigurimin e ketije sherbimi per qytetaret.

Terheqja e barnave nga qytetaret Shqiptare, ne funksion te plolesimit te nevojave te tyre shendetesore, kryhet vetem ne farmaci.

Prezenca e barnave ne tregun farmaceutik, sigurohet ne pjesen me te madhe nga Importi si dhe pjesa tjeter nga Prodhimi vendas.

Funksionimi i sherbimit farmaceutik eshte i rregulluar nepermjet ligjit Nr. 9223, date 25.11.2004 "PER BARNAT DHE SHERBIMIN FARMACEUTIK",

Kontrolli i zbatimit te Ligjit ne lidhje me rregullat per fabrikimin, importin, eksportin, tregtimin, ruajtjen, shperndarjen, pershkrimin, perdorimin, kontrollin e cilesise dhe sigurise se efektit te deshiruuar te nje bari, si dhe inspektimin e veprimtarive ne fushen farmaceutike, eshte kompetence e Qendres Kombetare te Kontrollit te barnave (Q.K.K.B)

Q.K.K.B. eshte nje institucion i varur nga Ministria e Shendetesise.

Organizimi dhe funksionimi i sajë sigurohet nga sektoret e meposhtem

- 1 - Sektori i Regjistrimit
- 2 - Sektori i Analizave
- 3 - Sektori i Inspektimit
- 4 - Sektori i Ekonomi – Finances dhe Administrates

Sektori i Regjistrimit

Prane ketij sektori kryhet aplikimi dhe me pase regjistrimi i te gjithë barnave qe qarkullojne ne republiken e shqiperise.

Barnat regjistrohen me urdher te Ministrit te Shendetesise. Propozimi per regjistrim behet duke u bazuar ne vleresimin e specialisteve pas shqyrtimit te dosjeve, rezultatin e analizave laboratorike si dhe vleresimin e komisionit te nomenklatures se barnave.

Te gjithë barnat te cilet, plotesojne kriteret e parashikuara sipas ligjit dhe rregullores se miratuar pajisen me nje "Çertifikate Regjistrimi".Ky dokument identifikues i barit i cili eshte garant per cilesine dhe efektshmerine e barit te regjistruar, eshte i vlefshem per nje peridudhe 5 vjecare.

Sektori i Analizave

Prane ketij sektori kryhen analizat nepermjet ushtrimit te metodave bashkekohore Fiziko – Kimike dhe Mikrobiologjike per te gjithë mostrat e paraqitura per regjistrim prane Sektorit te Regjistrimit.

Prane sektorit te analizave, kryhen ne menyre te vazhdueshme nepermjet sondazheve analiza, per barnat e regjistruara dhe qe qarkullojne ne treg duke rritur ne garancine per cilesine dhe sigurine e

barnave qe qarkullojne ne tregun farmaceutik dhe perdoren nga qytetaret Shqiptare ne plotesim te nevojave te tyre shendetesore.

Sektori i Inspektimit

Nepermjet ketij sektori behet kontrolli i prodhimit vendas, importit, ruajtjes dhe shperndarjes se barnave.

Prane ketij sektori leshohet Leja e Importit te barnave (nje dokument zyrtar i vleshem per barnat qe do te importohen) ku respektivisht behet pershkrimi i detajuar per cdo bare te regjistruar, ne forme doze/paketim per cdo lot te shoqeruar, me daten e prodhimit dhe skadences .

Konform dokumentacionit original qe shoqeron barin respektivisht :

1 - Invoice (Fatura)

2 - Certificate Origjine

3 - Certificate Analize per cdo bar dhe per cdo lot te tij te leshuar nga Fabrika

4 - Packing List

dokumenta keto te rendesishme per verifikimin e origjines se barit sipas deklarimit ne dosjen e regjistrimit.

Inspektoret e QKKB, verifikojne me pergjegjesi medikamentet e zhdoganuara dhe sipas ligjit procedura vazhdon me dhenien e Lejes se perdorimit per barnat, per cdo lot si dhe me vendosjen e Pulles se Kontrollit te leshuar nga Q.K.K.B, nepermjet se ciles krahas sigurise per cilesine dhe origjinen e barit pasqyrohet edhe cmimi i shitjes se barit tek pacienti, duke shmangur edhe abuzimet e mundeshme.

Barnat per vete rendesine qe kane per jeten dhe shendetin e qytetareve trgtohen me cmime te kontrolluara nga shteti, sipas marzheve te tregtimit te miratuare me Vendim te Keshillit te Ministrave.

Procedurat e kontrollit dhe paisjes me leje perdorimi dhe pullen e kontrollit kryhen edhe per barnat e prodhuara nga fabrikuesit vendas.

Sektori i Ekonomi – Finances dhe Administrates

Eshte sektori mbeshtetes i ketij institucioni, nepermjet te cilit realizohen pagesat e punonjesve, mirembajtja dhe blerjet te ndyshme sipas dispozitave ligjore per nevojat e institucionit, pagesat e ndryshme per sherbimet qe kryhen prane QKKB, sipas tarifave te percaktuara paraprakisht

Vizioni, Prioritetet dhe Qellimet

Sektori farmaceutik per vete rendesine e sherbimit qe ofron ne sigurimin dhe permiresimin e jetes dhe shendetit te popullates, eshte ne prioritetet e Ministrise se Shendetesise.

Ne kuader te integritimit te shqiperise ne Bashkimin European eshte domosdoshme edhe ngritja e sherbimeve te ketij sektori ne nivelet e ofruara nga vendet e BE.

Prioritetet kryesore per periudhen 2007-2013 do te jene:

Prioritete baze do te jene Monitorimi i zbatimit te kriterave ligjore ne tre elementet kryesore te sistemit farmaceutik:

- Prodhimit te barnave nga fabrikuesit vendas
- Importit, ruajtjes dhe shperndarjes se barnave
- Sherbimit farmaceutik

Prodhimi i barnave nga fabrikuesit vendas

Te gjithe fabrikuesit e barnave ne Republiken e Shqiperise duhet te plotesojne standartet e prodhimit sipas “Praktikes se Prodhimit te Mire” GMP duke ju referuar direktivave te Keshillit te Europes dhe eksperiencave te aplikuar ne vendet e BE .

Importi, ruajtja dhe shperndarja e barnave

Duke qene se pjesa me e madhe e barna qe nevojiten per qytetaret per gjate periudhes 2007 - 2013 do te vazhdoje te sigurohet nga importi i tyre, Monitorimi nga institucionet shteterore i ketije procesi ne zbatimin e praktikave te ruajtjes se mire dhe te shperndarjes se mire te barnave.

Sherbimi farmaceutik

Farmacite jane subjektet ne te cilat qytetaret do te terheqin barnat e nevojshme, si dhe udhezimin per perdorimin e tyre sipas rekomandimit te mjekut. Ndaj menyra e hapjes, sherbimit dhe funksionimit duhet te jete sipas modeleve te farmacive te vendeve te BE.

Forcimi i institucioneve

Prioritetet e permendura me siper do te realizohen nen drejtimin Institucioneve shteterore si Drejtoria farmaceutike ne Ministri te Shendetesise dhe Qendra Kombetare e Kontrollit te Barnave te cilat ne zbatim te politikave te zhvillimit te Qeverise, jane pergjegjese per sigurimin e sherbimit

farmaceutik per qytetaret.

QKKB duhet te marre parametrat e Agjensive si motra ne vendet e BE. Reformimi i sektoreve ekzistues te regjistrimit, analizave dhe inspektimit, duhet te shkoje paralelisht me ngritjen e sektoreve te ri ne ekujvalence me Agjensite e vendeve te tjera si dhe ne zbatim edhe te direktivave te Keshillit te Europes.

Aktualisht do te synohet ne investim per shtimin e kapaciteteve fizike te ambjenteve te QKKB, per tju pershtatur ndryshimeve strukture.

Paisjen me aparatura laboratorike moderne dhe akreditimin e tyre

Specializimi dhe trajnimi i specialisteve ne vende te BE

Prioriteti kryesor ne kete drejtim do te jete ngritja e struktures se farmakovigjilences.

Farmakovigjilenca eshte teresia e proceseve qe kane te bejne me pranimin, informimin, perpunimin, dhe shperndarjen e cdo lloj informacioni nga cfardolloy burimi i cili ka te beje me efektet e padeshiruara te barnave.

Qellimi dhe funksioni i kesaje strukture eshte garantimi i shendetit te qytetareve duke rritur shkallen e sigurise per efektshmerine e barnave.

Funksioni i saj eshte:

1. Te nxise, inkurajoje dhe te mbeshtese mjekun, e familjes ose specialist, stomatologet, infermieret, farmacistet dhe punonjesit e shendetesise, qe te raportojne cdo informacion per efektet e padeshiruara te barnave qe ata perdorin ose pershkruajne .

2. Rritja e ndjeshmerise se popullates per rendesine e raportimit te efekteve te padeshiruara te barnave.

Politikat

Baza e realizimit te prioriteteve te mesiperme do te jete mbeshtetja ligjore nepermjet hartimit te nje ligji te ri per barnat dhe sherbimin farmaceutik.

Ky ligj do te kete mbeshtetjen tek eksperiencat e vendeve te BE si dhe ne direktivat e Keshillit te Europes.

Parashikimi ne amendamentet e ketij ligji ne menyre te detajuar dhe profesionale si dhe ne pershtatje me kushtet e vendit tone te proceseve te tilla si prodhimi i barnave, menyra e hedhjes ne treg, importimi, ruajtja dhe shperndarja e barnave nga farmacite do ta vendoste sektorin farmaceutik ne Shqiperi ne nivele te barazvlefshme me ato te vendeve te BE.

OBJEKTIVAT	AFATET KOHORE	INDIKATORET E MONITORIMIT
Per shtim ambienti prane Q.K.K.B. (Ngritja e struktures se Farmakovigjilences)	2008-2010	Numri i zyrave per shtim ambienti prane Q.K.K.B.
Punonjesit per strukturen e re si dhe shtim i numrit te punonjesve ne Drejtorine Farmaceutike dhe Q.K.K.B.	2008-2010	Numri Punonjesve per strukturen e re si dhe numri i specialisteve ne Drejtorine Farmaceutike dhe Q.K.K.B.
Pajisje kompjuterike	2008-2010	Numri i kompjuterave
Aparatura laboratorike	2008-2010	Numri i aparaturave laboratorike
Trajnime periodike dhe te alternueshme	2008-2010	Numri i punonjesve qe do te trajnohen per strukturen e Farmakovigjilences si dhe koha e trajnimit te tyre jashte vendit. Numri i specialisteve qe do te trajnohen si dhe koha e

		trajnimin te tyre jashte vendit
Informatizimi i sistemit	2008-2010	Numri i softeve te krijuar
Promocion per strukturen e ngritur te Farmakovigjilences: Formulare Tip; Fletepalosje; Njoftime te vazhdueshme dhe te shpeshta ne televizion, radio, publikime ne shtyp dhe media per informim dhe sensibilizim te opinionit publik. Konferenca dhe takime ne cdo rreth Me mjeke, infermiere, farmacist, stomatologe	2008-2010 2008-2010	Numri i Flete palosjeve; Numri i Formulareve Tip; Numri i njoftimeve; Numri i Konferencave si dhe numri i takimeve ne rrethe me mjeke, infermiere, farmacist, stomatologe
Shtimi i ambjenteve ne nivel Prefekturash ne funksion te strukture se Farmakovigjilences	2010-2013	Numri i ambjenteve
Punonjesit ne nivel Prefekturash ne funksion te strukture se Farmakovigjilences	2010-2013	Numri i punonjesve
Pajisje kompjuterike per punonjesit ne nivel Prefekturash ne funksion te strukture se Farmakovigjilences	2010-2013	Numri i kompjuterave
Trajnime periodike dhe te alternueshme	2010-2013	Numri i punonjesve qe do te trajnohen per strukturen e Farmakovigjilences si dhe koha e trajnimit te tyre

ANEKS 3 KUADRI LIGJOR, PROJEKTET ME TE FUNDIT DHE ATO NE VIJIM

- I. Kuadri ligjor
- Ligji nr.7941 date 31.05.1995 “Per Ushqimin”;
 - Ligji nr. 9308, dt. 4.11.2004 “Mbi sherbimin dhe inspektoriatin veterinar”;
 - Ligji nr. 8702, 01.12.2000 “Per identifikimin, kontrollin e kafsheve dhe regjistrimin e fermave shtazore”;
 - Ligji nr.9362, date 24.03.2005 “Per sherbimin e mbrojtjes se bimeve”;
 - Ligji nr. 7643, dt. 08.12. 1992, “Pe Inspektoriatin Sanitar Shteteror”, amenduar me ligjin nr. 7904, dt. 08.03.1995;
 - Ligji nr. 8464, dt. 11.03.1999 “Mbi standardizimin”;
 - Ligji nr. 9135, dt. 11.09.2003 “Per mbrojtjen e konsumatorit”;
 - Ligji nr. 7908, dt. 05.04.1995, “Per peshkimin dhe akuakulturen”;
 - Ligji nr. 8443, date 21.05.1999, “Per vreshtarine, veren dhe produktet e tjera qe rrjedhin nga rrushi”;
 - Ligji nr. 8944, date 19.09.2002, “Per prodhimin, emertimet dhe tregtimin e vajit te ullirit”;
 - Ligji nr. 9441, date 11.11.2005 “Per prodhimin, grumbullimin, perpunimin dhe tregtimin e qumeshtit dhe te produkteve me baze qumeshti”;
 - Ligji nr. 9779, date 16.07.2007 “Per sigurine e pergjithshme, kerkesat thelbësore, vleresimin e konformitetit te produkteve joushqimore”;
 - Ligji nr. 9595, date 27.07.2006 “Per ngritjen e Inspektoriatit Qendror Teknik”;

- Ligji Nr. 8450, dt.24.2.1999 “Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre”;
- Ligji Nr. 8734 dt.1.2.2001 “Per garantimin e sigurise se punes te paisjeve dhe te instalimeve elektrike;
- Ligji Nr.8739 dt.12.2.2001”Per garantimin e sigurise se puneve te paisjeve nen presion” ;
- Ligji nr. 9290, date 7.10.2004 "Per produktet e ndertimit";
- Ligji nr. 9780, date 17.7.2007 "Per inspektimin e ndertimit";
- Ligji nr. 8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i republikes se Shqiperise”, per mjetet motorrike;
- Ligji 9636 date 6.11.2006 ”Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit”;
- Ligji 9518 date 18.4.2006 ”Per mbrojtjen e te miturve nga perdorimi i alkoolit”;
- Ligji Nr 7761 date 19.10.1993 “Per Parandalimin dhe Luftimin e Semundjeve ngjites ne Shqiperi” (Neni 11 Ministria e Shendetesise organizon dhe drejton sherbimin sanitaro-antiepidemik ne Pikat e Kalimit Kufitar detar, ajror e tokesorper te siguruar parandalimin e hyrjes se semundjeve te rrezikeshme te Konventes, ne perputhje me normat e percaktuara ne Rregulloren Sanitare Nderkombetare;
- Ligji Nr 8528 23.9.1999 ”Per nxitjen dhe mbrojtjen e te ushqyerit me gji”;
- VKM 525 27.7.2006 ”Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 7643 date 2.12.1992, ”Per shendetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shteteror” (eshte perfshire ne te koncepti HACCP);
- Urdher i perbashket i Ministrise se Bujqesise dhe Ministrise Shendetesise nr.316 datë 16.11.2002 “Ne zbatim te urdherit te Kyeministrit Nr 280 dt. 14.10.2002 “per ngritjen e grupit nderministror te punes per vleresimin e veprimtarise per prodhimin e ujit te industrializuar dhe te treguesve higjieno – sanitare te tij”;
- Udhëzimi i perbashket me Ministrine e Shendetesise Nr 1 dt. 16.10.2002 “mbi Prodhimet qe tregetohen ne fushen e ushqimit Social”;
- 11 rregullore higjieno-sanitare te Ministrise se Shendetesise te cilat perbejne bazen legale ne fushen e sigurise ushqimore;
- Urdher i Ministrit te Shendetesise Nr. 157, dt. 09/04/2002, per mbeshtetjen e iniciatives per t’u bere “Sherbime shendetesore mike te femijes” qe perkrahin dhe mbeshtetin ushqyerjen me gji, dhe per te implementuar politiken e OBSH/UNICEF lidhur me 10 hapat per nje ushqyerje te sukseseshme me gji;
- Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 549 dt. 21/11/97 per” importimin e kripes se gjelles te jodizuar ” ;
- Draft Ligji “Per eliminimin e crregullimeve nga deficiencenca jodike ne Shqiperi, nepermjet jodizimit te kripes per perdorim human, shtazor dhe industrial.

II. PROJEKTET

- Projekti CARDS, 2005-2007, 3 milion Euro, “Per ngritjen e Autoritetit Kombetar te Ushqimit”;
- Projekti per kontrollin e gripit te shpendeve dhe pergatitjen per parandalimin e pandemise humane”, kohezgjatja 2006-2009, vlere rreth 6.1 milion USD, kredituar 5 milion USD nga BB, 800 mije USD nga Granti i Qeverise Japoneze, 300 mije USD kontributi i Qeverise Shqiptare, si dhe bashkepunime paralele nga USAID dhe OBSH, UNICEF e PNUD;
- Projekti “Forcimi i institucioneve te kontrollit te ushqimit ne Shqiperi”, donator Qeveria Italiane, implementim nepermjet FAO-s, 2 milion Euro, kohezgjatja 3 vjete;
- Programi CARDS 2003, Projekti “Mbështetje Sistemin e Mbikëqyrjes se Tregut, ne Shqipëri”;
- Programi CARDS 2006, Projekti “Mbështetje për Rregullat teknike, Mbikëqyrjen e Tregut, Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Metrologjinë ligjore ne Shqipëri”;
- TaieX, Projekti “Mision ekspertesh ne lidhje me adoptimin e Direktivave Evropiane te New Approach ne legjislacion kombëtar”;
- Eshte ne proces final Komponenti i I (Food Policies and Legislation) i Projektit te Paktit te Stabilitetit “Forcimi i Sherbimeve te Sigurise Ushqimore dhe Ushqyerjes ne vendet e Europes Jug-Lindore”;
- Eshte marre vendimi ndermjet shteteve te Rajonin ne takimin e katermbedhete te Rjetit te

Shendetesise per vendet e Europes Jug-Lindore (Dures, Nentor 2006), per fillimin e implementimit te Komponentit II “Vendosja e nje modeli te harmonizuar dhe integruar per Sistemet e Sigurise Ushqimore dhe Ushqyerjes” (ne faze implementimi);

- Eshte ne proces implementimi, Projekti i Paktit te Stabilitetit “Ndertimi i kapaciteteve ne fushen e Shendetit Publik per forcimin e Kontrollit te Duhanit ne vendet e Europes Jug-Lindore”;

- Projekt i perbashket binjakezimi me Italine “Per monitorimin e situates dhe Luftimin e Deficiences Jodike ne Shqiperi” (Ne kuader te projektit eshte pergatitur draft Ligji “Per eliminimin e deficiences Jodike ne Shqiperi”).

ANEKS 4 REFERENCAT

Komisioni i Bashkimit European (2007): Komunikatë drejtuar Këshillit, Parlamentit dhe Komitetit European për Çështjet ekonomike dhe sociale mbi – Strategjinë e Politikës së BE-së për Konsumatorët 2007-2013 – “Fuqizimi i konsumatorëve, rritje e mirëqënies së tyre, mbrojtja e tyre efektive”. Bruksel, 13.03.2007;

Strategjia Evropiane e Politikës së Konsumatorëve BE 2002-2006;

FAO/ OBSH (2006): FAO/ OBSH Udhëzime për qeveritë mbi aplikimin e HACCP në bizneset e vegjël / pak të zhvilluar të ushqimit. Revista 86 e FAO Ushqimi dhe të Ushqyerit;

FAO (2005): Udhëzime vullnetare për të mbështetur realizimin progresiv të së drejtës për ushqim adekuat në kontekstin e sigurimit të ushqimit në nivel kombëtar. Miratuar nga sesioni i 127-të i këshillit të FAO, Nëntor 2004. Romë;

FAO/ OBSH (2003): Garantimi i Sigurisë dhe Cilësisë Ushqimore – Udhëzime për forcimin e sistemeve kombëtare të kontrollit;

FAO/ OBSH (1963): Codex Alimentarius;

Strukturat administrative kryesore të ngarkuara me implementimin e Acquis, Komisioni European, 2004;

Komunikate e Komisionit të 7 Maj 2003 për Këshillin dhe Parlamentin European në zgjerimin për implementimin e Direktivave të Perafrimit të Ri;

Guida mbi implementimin e Direktivave bazuar në Perafrimin e Ri dhe të Vjetër, Komisioni European, 2000;

Republika e Shqipërisë (2007): Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin e planifikimit të integruar. Handbook for Ministers;

Republika e Shqipërisë – Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit: Vjetari statistikor 2006;

Republika e Shqipërisë – Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (2007): Strategjia e Zhvillimi Rural;

Republika e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shëndetit të Kujdesit Parësor (2005): Analiza e Situatës së Ushqimit dhe të Ushqyerit në Shqipëri;

Republika e Shqipërisë – Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (2006): Bujqësi dhe Industria ushqimore Shqiptare në shifra;

Republika e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shëndetit të Kujdesit Parësor (2005): Analiza e Situatës së Ushqimit dhe të Ushqyerit në Shqipëri;

Republika e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë (2005): Mbi rregjistrimin e medikamenteve në Republikën e Shqipërisë;

Republika e Shqipërisë (2003): Ligji nr.9135, datë 11.9.2003 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve”;

Republika e Shqipërisë (2007): Ligji nr. _____, datë _____ “Për ushqimin” (Projekt)

Republika e Shqipërisë (2004): Ligji nr.9308, datë 4.1.2004 mbi “Shërbimin dhe inspektoratin veterinar”;

Kombet e Bashkuara – Organizata Botërore e Shëndetësisë (2005): Rregullore Ndërkombëtare mbi Shëndetin;

Kombet e Bashkuara – Organizata Botërore e Shëndetësisë (2002): Strategjia Globale mbi Sigurinë Ushqimore;

SEED – Zhvillimi i ndërmarrjeve në Europën Juglindore (2005): Vëzhgim mbi ndërmarrjet Shqiptare të prodhimit / përpunimit të ushqimit dhe pijeve;

Kombet e Bashkuara – Organizata Botërore e Shëndetësisë (2005): Rregullore Ndërkombëtare mbi Shëndetin;

Kombet e Bashkuara – Organizata Botërore e Shëndetësisë (2002): Strategjia Globale mbi Sigurinë Ushqimore;

Raporti mbi politikën e mbrojtjes së konsumatorëve të Qeverisë Federale të 2004.

ANEKSI 5

PLANI I VEPRIMIT DHE KOSTOT INDIKATIVE TE STRATEGJISE NDERSEKTORIALE TE MBROJTJES SE KONSUMATOREVE DHE MBIKQYRJES SE TREGUT (PRODUKTET JO-USHQIMORE)							
NR	Objektivat	Masat Zbatuese	Institucioni Pergjegjes	Kosto (Mije leke)			
				2007	2008	2009	2010
AKTIVITETET AFAT-SHKURTRA (2007-2010)							
1	Konsolidimi i bazës legjislative	1.1. Permiresimi i ligjit për mbrojtjen e Konsumatorëve	METE/DMT	1300			
		1.2. Hartimi i ligjit "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore, vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore"	METE/DMT	4100			
		1.3. Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve (shiko Aneks 2)	METE/DMT		1800	1800	2400
		1.4. Hartimi i legjislacionit për produktet në sektorë të veçantë sipas direktivave të Përafërimit të Ri dhe të Vjetër. (shiko aneks 2)	METE/DMT	2300	5800	5800	2100
		1.5. Permiresimi i legjislacionit i lidhur me mbikëqyrjen e tregut	Institucionet e varësishë (DPS, DPMK, DA)				
2	Ngritja e një sistemi institucional të përshtatshëm	2.1. Krijimi i një strukture të vetme për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut	METE/DMT				
		2.2. Krijimi i një autoriteti të vetëm për mbikëqyrjen e aktiviteteve të mbrojtjes së konsumatorëve dhe të mbikëqyrjes së tregut		X			
		2.3. Ngritja e Komitetit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve	METE		300	300	300
		2.4. Ngritja e një Këshilli Konsultativ të Konsumatorëve	METE		X		
		2.5. Organizimi i sistemit institucional rajonal	METE			X	X
		2.6. Investime në rrjetin e kapaciteteve	METE	660	1980	1320	660

		5.3. Informimi i industrisë dhe operatorëve ekonomikë, trajnimi profesional i bizneseve	METE		7000	19000	17000
		5.4. Informimi i konsumatorëve nëpërmjet organizimit apo mbështetjes së fushatave të informimit.	METE		5000	13000	7000
		6.1. Hartimi i kriterëve dhe procedurave për ngritjen dhe zhvillimin e aktivitetit të qendrave të këshillimit	METE		500		
		6.2. Mbështetja për ngritjen e qendrave të këshillimit në tre prefektura.	METE		1800	2400	3000
		6.3. Sigurimi i asistencës teknike (programe dypalëshe dhe ato evropiane) për zhvillimin e këtij rrjeti	METE				
6	Ngritja e një rrjeti kombëtar të qendrave të këshillimit të konsumatorëve				X	X	X
		7.1. Futja e çështjeve të edukimit të konsumatorit në lende të ndryshme si ekonomi, shkenca politike, biologji, gjeografi, etj.	MASH		X	X	X
		7.2. Dhënia e prioritetit ndaj grupeve të fëmijëve të kopshteve dhe nxënësve të shkollave fillore.			X	X	X
		7.3. Trajnimi i mësuesve me qëllim kualifikimi, zhvillimi i kurrikulave si dhe përpunimi i materialeve mësimore dhe udhëzimeve të reja metodologjike.	MASH		1300	1300	1300
		7.4. Vendosja e një bashkëpunimi të ngushtë me shoqatat e konsumatorëve dhe Ministrinë e Arsimit dhe institucione të ngarkuara me zhvillimin e kurrikulave dhe trajnimin e mësuesve.					
		7.5. Asistencë teknike për zhvillimin dhe implementimin e edukimit të konsumatorit në Shqipëri duhet të përfshihet në programet dypalëshe dhe ato të BE-se.	METE, MASH, SHK METE, MASH		X	X	X
		7.6. Zhvillimi dhe mbështetja e formave të edukimit të konsumatorëve jashtë shkollave.	METE		600	600	600
		8.1. Dhënie e mbështetjes financiare shoqatave të konsumatorëve, nëpërmjet një procesi transparent tenderimi.	METE		1900	1900	1900
		8.2. Mbështetja për forcimin e kapaciteteve të organizatave të konsumatorëve në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, të programeve dypalëshe dhe ato të BE-se	METE				
8	Mbështetja financiare për organizatat e konsumatorëve				X	X	X

**PLANI I VEPRIMIT DHE KOSTOT INDIKATIVE TE STRATEGJISE NDERSEKTORIALE TE MBROJTJES SE KONSUMATOREVE DHE MBIKQYRJES SE TREGUT
(PRODUKTET USHQIMORE)**

Nr	OBJEKTIVAT	Veprimet/Masat e planifikuara	Institucioni Pergjegjes	SIPAS VITEVE (milion leke)						
				2008	2009	2010	2011	2012	2013	SUM
1	Zgjedhje reale bazuar ne informacion te kujdeshem,	Fushata te ndergjegjesimit per konsumatore, bizneset dhe grupe te tjera te interesit.	MBUMK	244.976	245.098	245.22	245.342	245.464	245.586	1471.686
		Publikime per cheshtjet e interesit per cilesi te larte dhe siguri ushqimore.	MBUMK	1.22	1.22	1.22	1.22	1.22	1.22	7.32
		Ofrim i informacionit online.	MBUMK	0.366	0.244	0.244	0.122	0.244	0.244	1.464
		Konferenca, seminara, takime ekspertesh dhe stakeholderave.	MBUMK	1.22	0.488	0.488	0.488	0.488	0.488	3.66
		Nxitja e pershirjes se temave te mbrojtjes se konsumatoreve ne kurrikulat shkollore.	MBUMK	0.61	0.61	0.61	0.61	0.61	0.61	3.66
		Prodhimi i matrialeve mesimore, trainim i mesuesve dhe nderveprimi ndermjet shkollave dhe mjedisit te tyre lokal.	MBUMK	0	0.122	0.122	0.122	0.122	0.122	0.61
		Networku i OJF-ve te mbrojtjes se konsumatoreve dhe te shendetit dhe stakeholderave te tjere ne nivel kombetar dhe nderkombetar, pershire autoritetin kombetar te ushqimit	MBUMK	0	0.244	0.244	0.244	0.244	0.244	1.22
		TOTALI I OBJEKTIVIT TE PARE		248.392	248.026	248.148	248.148	248.392	248.514	1489.62
2	Transparence e tregut	Sistemet e monitorimit te tregjeve konsumatore.	MBUMK	6.466	3.538	3.538	3.416	3.538	3.538	24.034
		Perrmiresim i komunikimit me konsumatore.	MBUMK	48.8	39.04	39.04	39.04	39.04	39.04	244
		Promovim i dialogut konsumator-biznes.	MBUMK	12.2	9.76	9.76	9.76	9.76	9.76	61
		Kurse trainimi pr stafin e organizatave te konsumatoreve.	MBUMK	1.22	2.44	2.44	1.22	2.44	2.44	12.2
		Masa per bashkepunimin me organizatat kombetare dhe nderkombetare.	MBUMK	1.22	1.22	1.22	0.61	1.22	0.61	6.1
		TOTALI I OBJEKTIVIT TE DYTE		69.906	55.998	55.998	54.046	55.998	55.388	347.334
3	Vetevendosje e forte	Ngritja e pikave te informimit .	MBUMK	64.66	53.68	53.68	51.24	53.07	53.07	329.4
		ofrim sistematik i inofmacionit ne pikat e informimit.	MBUMK	2.44	1.83	2.44	1.83	1.83	1.83	12.2
		Identifikim i ushqimit t sigurt.	MBUMK	1.22	0.61	1.22	1.22	1.22	0.61	6.1
		Etiketimi dhe certifikim ne gjuhen Shqipe.	MBUMK	2.44	1.83	1.83	2.44	2.44	1.22	12.2
		Perrmiresim i komunikimit me konsumatore.	MBUMK	0	0	0	0	0	0	0
		Promovim dhe fuqizim i shogatave te konsumatoreve.	MBUMK	0	0	0	0	0	0	0
		TOTALI I OBJEKTIVIT TE TRETE		70.76	57.95	59.17	56.73	58.56	56.73	359.9
4	Besim qe rrjedh nga mbrojtja efektive.	Fuqizim i kapaciteteve te strukturave te kontrollit dhe te inspektimit.	MBUMK	9.76	7.93	11.59	11.59	7.93	6.1	54.9
		Perrmiresim i legjislacionit te ushqimit dhe rregulloree te tjera.	MBUMK	18.3	12.2	12.2	6.1	6.1	6.1	61
		Promovim i mireqenies se kafsheve.	MBUMK	1.22	1.22	1.22	1.22	0	1.22	6.1
		Mbeshtet fermeret / perpunuesit / tregtaret ushqimore per te respektuar perkatesisht praktikat e mira bujqesore/te prodhimit dhe te hijenes, vecanerisht per produktet me avantazhe krahasuese dhe me potenciale eksporti.	MBUMK	0.244	0.244	0.244	0.244	0.244	0	1.22
		Shfrytezim i burimeve financiare nga RDP per investime respektive.	MBUMK	1.22	1.22	1.22	0.61	0.61	1.22	6.1
		Promvim i produkteve bujqesore Shqiptare ne panaietet nderkombetare.	MBUMK	0	0	0	0	0	0	0
		Promovim dhe fuqizim i shogatave te konsumatoreve.	MBUMK	1.83	1.22	0.61	1.22	1.22	1.22	7.32
		TOTALI I OBJEKTIVIT TE KATERT		32.574	24.034	27.084	20.984	16.104	15.86	136.64
		TOTALI I 4 OBJEKTIVAVE		421.632	386.008	390.4	379.908	379.054	376.492	2333.494

	ANEKSI 5	PLANI I VEPRIMIT DHE KOSTOT INDIKATIVE TE STRATEGJISE NDERSEKTORIALE TE MBROJTJES SE KONSUMATOREVE DHE MBIQYRJES SE TREGUT (PRODUKTET FARMACEUTIKE)		
Nr	Veprimet/Masat e planifikuara	Institucioni Pergjegjes	SIPAS VITEVE (mije leke)	
			2008 - 2010	2010 - 2013
1	Investime	QKKB	1.200	5.000
2	Burime njerezore	QKKB	7.000	9.000
3	Pajisje kompjuterike	QKKB	800	
4	Pajisje kompjuterike dhe zyra			18.000
5	Aparatura laboratorike	QKKB	5.000	
6	Trajnime per specialistet	QKKB	10.000	10.000
7	Informatizimi i sitemit	QKKB	600	
8	Flete palosje, Formulare	QKKB	10.000	
9	Njoftime ne TV	QKKB	200	
10	Konferenca(takime)	QKKB	5.000	
			39.800	
	Totali		39.800	42.000

1.200	9.600
7.000	56.000
800	6.400
5.000	40.000
10.000	80.000
600	4.800
10.000	80.000
200	1.600
5.000	40.000
39.800	318.400
318.400	